

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË



LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

1878-1881

Fjalime dhe referate

TIRANË, 1978

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPÉRISË
INSTITUTI I HISTORISË

949.65
675

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

1878-1881

Fjalime dhe referate
mbajtur me rastin
e njëqindvjetorit të saj



22/35

TIRANË, 1978

Në këtë vëllim botohen kryeartikulli i gazetës «Zëri i popullit» i datës 5 mars 1978, fjalimet e mbajtura në aktivitetet që u organizuan me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në varrimin e eshtrave të Abdyl e Naim Frashërit, në mbledhjen solemne, si dhe referatet e mbajtura në Konferencën Kombëtare të Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

NJËQINDVJETORI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT — NJË DATË E SHËNUAR E HISTORISË SË LAVDISHME TË POPULLIT SHQIPTAR

Mbarë populli shqiptar do të festojë këtë vit një nga ngjarjet më të shquara të historisë së tij shekullore. Më 10 qershor mbushen 100 vjet nga dita kur u themelua organi-zata kombëtare «Lidhja Shqiptare» me qendër në Prizren. Në vitet e stuhishme të krizës së madhe lindore, Lidhja Shqip-tare u vu në krye të të gjithë popullit dhe luftoi me armë në dorë për të drejtat e kombit shqiptar, për mbrojtjen e tro-jeve të Atdheut dhe bashkimin e tij në shtetin e vet kombëtar, të drejta që ishin shkelur brutalisht nga sunduesit osmanë, nga synimet imperialiste të fuqive të mëdha dhe nga planet aneksioniste të monarkive shoviniste ballkanike fqinje.

Në të gjithë vendin tonë janë duke u përgatitur një varg aksionesh politiko-shoqërore dhe kulturore-shkencore për ta përkujtuar e për ta bërë edhe më të njojur në masat puno-njëse këtë ngjarje me rëndësi të veçantë historike, e cila shënoi një etapë më të lartë në lëvizjen kombëtare shqiptare drejt pavarësisë. Me këtë rast do të bëhen mbledhje përkujti-more në Tiranë dhe në një varg qytetesh që kanë qenë vatra të rëndësishme të aktivitetit të Lidhjes, si në Kukës, Peshkopi, Gjirokastër, Shkodër, Korçë, Frashër, konferanca e sesione shkencore, botime shkencore e letrare, koncerte, eksposita, filma që do të trajtojnë Lidhjen në aspektet e ndryshme të saj.

Partia dhe shoku Enver Hoxha i kanë bërë një vlerësim të lartë Rilindjes në përgjithësi, Lidhjes së Prizrenit dhe periudhës së viteve 1878-1881 në veçanti. Ata e kanë përcaktuar këtë si një periudhë luftërash e përpjekjesh me shumë rëndësi përfatë e popullit tonë, si një periudhë që karakterizohet nga kryengritje të paprera, nga një luftë e ven-dosur përfi liri, pavarësi, demokraci dhe arsim.

Në studimin e krijimit dhe të veprimtarisë së Lidhjes

Shqiptare ne udhëhiqemi, si gjithmonë, nga mësimet marksisë-leniniste, nga materializmi historik. Sot, pas 100 vjetësh, të armatosur me mësimet e Partisë e të shokut Enver dhe duke u mbështetur në studimet e shumanshme që janë bërë deri tani në vendin tonë, është bërë e mundur të hidhet një drithë më e qartë mbi vendin, rolin dhe rëndësinë kombëtare e ndërkombëtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Lidhja e Prizrenit është produkt i drejtëpërdrejtë i luftës së popullit shqiptar, i kushteve historike e shoqërore në të cilat ai mdodhej në kohën e krijimit të saj. Ajo nuk ishte, dhe nuk mund të ishte, një lëvizje prapa së cilës qëndronin fuqi të huaja, siç janë orvatur e orvaten ta paraqitin atë historianë borgjezë e revizionistë. Veprimtaria e Lidhjes, ndeshjet e saj në plan të brendshëm e ndërkombëtar ishin rezultat i kushteve objektive në të cilat jetonte populli ynë, i gjithë zhvillimit të tij historik, i përpjekjeve aktive të një kombi të formuar që lufton përmbrrojtjen e interesave të veta jetike, politike e ekonomike. Lidhja Shqiptare e themeluar në Prizren ishte vazhdim i luftërave shekullore të popullit tonë përliri e pavarësi, përtokën dhe gjuhën, përnderin dhe traditat e tij. Ajo ishte vazhdim i luftërave heroike, të cilat kishin bërë që kombi shqiptar të mos shuhej nga stuhitë e pamëshirshme të shkujve, por të ngrihej përmbi to me flamurin e kryengritjes në dorë, me kryet lart e i papërkulur.

Lëvizja popullore kundër pushtimit të huaj që çoi në formimin e Lidhjes së Prizrenit, që përgatitur nga lëvizjet e gjera masive të viteve 30-70 të shekullit të 19-të, të cilat ishin shpërthim i pakënaqësise së grumbulluar prej kohësh si rezultat i shtypjes kombëtare, i shfrytëzimit ekonomik dhe i abuzimeve të administratës centraliste burokratike të vendosur nga Porta e Lartë në periudhën e Tanzimatit. Kësaj palkënaqësie iu shtua edhe ajo që vinte nga symimet gjithnjë e më grabitqare të monarkive shoviniste fqinje, të Malit të Zi, të Serbisë, të Bullgarisë, etj. kundrejt trojeve shqiptare dhe nga politika këmbëngulëse antishqiptare e Portës së Lartë, që i mohonte kombit tonë edhe aspiratat më elementare të tij.

Mbi bazën e lëvizjeve popullore, u bënë përpjekje për t'u dhënë atyre programin politik kombëtar dhe për t'i organizuar ato në të gjitha trevat e Shqipërisë. Kriza që shpërtheu më 1875 me kryengritjet e para në Ballkan dhe që u zgjerua në një krizë të përgjithshme lindore, i gjeti një varg krahinash të Atdheut tonë në revoltë me armë në dorë. Kryengritjet shqip-

tare ishin pjesë e pandarë e luftërave antiosmane të popujve të Ballkanit. Por ndërhyrja e Fuqive të Mëdha për të shfrytëzuar në favor të politikës e të planeve të tyre grabitqare krizën që shpërtheu nga kryengritjet e popujve të shtypur si edhe orvatjet e monarkive ballkanike për ta kthyer luftën e drejtë popullore për çlirim kombëtar në një luftë për ekspansion të shfrenuar, i dhanë kësaj krize një drejtim tjetër, sidomos në kundërshtim me interesat e popullit shqiptar. Në këto kushte, populli ynë, në luftën për çlirim kombëtar, si kurdoherë u mbështet në forcat e veta.

Hyrja e ushtrive të huaja në trojet shqiptare, deklarimi i hapur i qëllimeve ekspansioniste, politika grabitqare dhe e dëbimit të popullsive shqiptare nga tokat amtare, që ndoqën sidomos qeveritë e Serbisë e Malit të Zi, nënshkrimi i Traktatit të Shën-Stefanit, që i konte kufijtë e Bullgarisë, së mbështetur nga Rusia cariste, thellë në tokat shqiptare, përfshirë Tetovën, Gostivarin, Kërçovën, Dibrën, Strugën, Korçën, etj., vinin në rrezik jo më zona të veçanta kufitare, por tërësinë e trojeve shqiptare. Këto veprime u dhanë një shtytje të re të fuqishme lëvizjeve popullore për mbrojtjen e të drejtave e të interesave më të larta kombëtare dhe përpjekjeve për një organizim të njësuar. Më 1877 krijohet për këtë qëllim në Stamboll «Komiteti Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare», i cili bashkonte në gjirin e vet figurat më të ndritura të popullit shqiptar – vëllezërit Abdyl e Sami Frashëri, Pashko Vasën e Jani Vreton, Zija Prishtinën, Hasan Tahsimin etj.

Për të udhëhequr lëvizjen masive që kishte shpërthye në vise të ndryshme të vendit dhe për të zbatuar detyrat që impononte momenti historik, me kujdesin e Komitetit të Stambollit, u formua «Lidhja Shqiptare» me qendër në Prizren, e përbërë nga përfaqësues të krahinave të ndryshme të Shqipërisë e të shtresave të ndryshme të popullsisë, e cila formuloi programin politik të lëvizjes kombëtare shqiptare dhe ngriti në gjithë vendin organizmat e saj drejtuese politike e ushtarake dhe formacionet e armatosura për realizimin e këtij programi.

Lidhja ngriti për herë të parë zërin, në emër të të gjithë kombit shqiptar, pa dallim ndarjesh krahinore e fetare, për mbrojtjen e tokave shqiptare, duke deklaruar përpara gjithë botës se askush nuk kishte të drejtë të vinte dorë mbi tokat e banuara prej shqiptarëve e që historikisht u përkintnin aty-

re, se askush nuk kishte të drejtë t'i bënte ato monedhë këmbimi, se zot i vetëm i tyre ishte populli shqiptar.

Qysh në aktet dhe memorandumet e saj të para dhe gjatë gjithë veprimtarisë së vet, Lidhja luftoi për realizimin e qëllimeve themelore të lëvizjes kombëtare: për njohjen e kombit shqiptar si një e të pandarë dhe respektimin kundrejt tij të parimit të kombësisë në të gjitha drejtimet, për ruajtjen e paprekshmërisë e të terësisë së trojeve kombëtare shqiptare dhe për bashkimin e tokave të Shqipërisë në një njësi të vëmete me administratë shqiptare. Këto ishin tri hallka të pashme nga njëra-tjetra: terësia dhe njësia tokësore ishte një kusht themelor për njësinë kombëtare dhe bashkimi kombëtar duhej të realizohej në kuadrin e një shteti kombëtar.

Kur Fuqitë e Mëdha kaluan në zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, pa marrë parasysh kërkesat e ligjshme të shqiptarëve, Lidhja mori më duart e veta fatin e kombit shqiptar dhe luftoi për t'i dalë atij zot.

Nëpërmjet një rrjeti të dendur komitetesh e degësh, Komiteti Qendror në Prizren u lidh me të gjitha krahinat e vendit për të drejtuar masat populllore që ishin ngritur në këmbë përpara rrezikut të copëtimit të Atdheut. Vatra të fuqishme të kësaj lëvizjeje u bënë sidomos ato krahina që ishin objekt i planeve ekspansioniste të monarkive shoviniste ballkanike: Kosova, Dibra, Shkodra me Malësitë e Veriut, Gjirokastra etj. U krijua kështu një front i gjërë, në të cilin u bashkuau të gjitha forcat patriotike të kombit për të mbrojtur interesat themelore kombëtare dhe ekonomiko-shoqërore të cilat viheshin në rrezik nga copëtimi i vendit që synonin qeveritë shoviniste ballkanike dhe politika antishqiptare e Perandorisë Osmane. Ishin sidomos patriotizmi i masave të gjera populllore dhe lufta e tyre këmbëngulëse kundër administratës osmane që i dhanë Lidhjes forca të pashtershme në luftën për mbrojtjen e terësisë tokësore dhe për autonominë e Shqipërisë.

Në mendimin dhe veprimtarinë e Lidhjes me autonominë kuptohej krijimi i një njësie të vëmete territoriale administrative autonome shqiptare, me administratë civile dhe ushtarake shqiptare, me gjuhë shqipe e me kryeqendrën e vet. Ky ishte një hap i rëndësishëm përpara për bashkimin politik të popullit shqiptar. Kjo njësi territoriale administrative autonome shqiptare do të shërbente si pikënisje për krijimin e një shteti me një përbajtje ekonomike-shoqërore të përparuar, me karakter demokratik, i cili, në kushte të favorshme, do të

kalonte në një shtet kombëtar shqiptar të pavarur. Në kuadrim e kësaj njësie administrative autonome, Lidhja përfshinte territoret e katër vilajeteve të atëhershme, ku shqiptarët përbënin një tërësi kompakte dhe shumicën e popullsisë.

Luftha e vendosur e Lidhjes për mbrojtjen e territoreve shqiptare të kërcënua, si Plava e Gucia, Hoti e Gruda, Ulqini etj., ishte dëshmi e një ndërgjegjeje tanimë të formuar kombëtare dhe të një strategjie të qartë politike e ushtarake. Fakt është se kjo luftë nuk i lejoi Fuqitë e Mëdha dhe shtetet fqinje të realizonin plotësisht vendimet antishqiptare të Kongresit ndërkombëtar të Berlinit dhe i detyroi ato të njihnin rëndësinë e faktorit shqiptar për mbylljen e krizës ballkanike. Por në kushtet kur Fuqitë e Mëdha nuk ishin të interesuara për të llikuiduar tërësisht sundimin osman në Ballkan, lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes nuk mundi të arrinte fitoren përfundimtare. Ajo u shtyp egërsisht në fazën e fundit të saj si rjedhim i vepnimit të bashkëruar të Fuqive të Mëdha, të Turqisë e të shteteve ballkanike, dhe një pjesë e madhe e viseve shqiptare u shkëputën nga trualli kombëtar.

Ruga e Lidhjes, për vetë rrëthanat e brendshme e të jashtme, qe një rrugë e ndërlikuar, por me gjithë zigzaket, ajo karakterizohet nga rritja e zhvillimi konsekuent i saj, nga rritja e luftës kundër pushtuesve të huaj në të gjitha viset shqiptare.

Në këtë luftë të vështirë shumëfrontesh u dalluan si udhëheqës politikë dhe ushtarakë figurat e shquara të Abdyl Frashërit dhe Sulejman Vokshit (Gjakovë), vepruan aktivistët e Lidhjes Iliaz Pashë Dibra e Shuaip Spahiu (Prizren), Omer Prizreni e Mustafa Tetova, Daut Boriçi, Filip Çeka, Selim Çoba (Shkodër), Mihal Harito e Petro Meksi (Gjirokastër), Dhimitër Kolea (Berat), Thimi Mitko dhe Eftim Brandi (Korçë), Mehmet Ali Vrioni (Fier), Haxhi Zeka (Pejë), Odhise Kasneci (Himarë) etj., u dalluan luftëtarët popullorë si Mic Sokoli e Ali Ibra (Tropojë), Isuf Sokoli (Shkodër), Mehmet Beci e Mehmet Gjyli (Ulqin), Jakup Ferri (Guci), Ramadan Zaskoci (Lumë) e shumë të tjera nga krahinat më të ndryshme të Shqipërisë.

Nëpërmjet një lufte të brendshme midis krahut përparimtar e konservator të saj, Lidhja kaloi gradualisht në pozita më të përparuara. Organet e saj zëvendësuam administratën osmane në një varg krahinash dhe ushtruan funksione pushtetore në plan të brendshëm e ndërkombëtar, ajo ngriti reparte

ushtarakë, organizoi gjykata vendëse etj. dhe ushtroi pushtetin e vet mbi territorret shqiptare të qiruara, duke zbatuar parimet e shpallura prej saj mbi respektimin e të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga feja e kom-bësia. Nën drejtimin e saj, masat dhanë prova të disiplinimit të ndërgjegjshëm dhe të aftësive organizuese, ikushte të domos-doshme për një jetë shtetërore.

Pjesë përbërëse e pandarë e lëvizjes për çlirimin kombëtar në këtë periudhë ka qenë lëvizja kulturore, me kërkesat e saj për gjuhën, shkollën, letërsinë shqipe. Detyra për të argumentuar e mbrojtur kërkesat e Lidhjes vuri në këtë periudhë në lëvizje mendjet më të ndritura të popullit shqiptar dhe i dha një shptytje të fuqishme veprimtarisë krijuarës kul-turore me karakter kombëtar. Në shërbim të luftës së Lidhjes, u krijuar Shoqëria e Shkronjave, u hartuan libra shkollorë, u zhvillua një publicistikë militante, në letërsinë e kohës hyri gjerësisht temë patriotike dhe u krijuan kryevepra të vërteta, siç është poema e Pashko Vasës «Mori Shqypnji, e mjera Shqyp-ni».

Përmbytja e përparuar kombëtare e Lidhjes dhe forca e lëvizjes së saj ngjallën një valë entuziazmi edhe jashtë trojeve shqiptare, tek arbëreshët e Italisë e të Greqisë, në kolonitë shqiptare të Egjiptit, Rumanisë etj., të cilat u solidarizuan me luftën e popullit shqiptar e dhamë një kontribut të vyer për ta bërë të injohur këtë luftë në botën e jashtme.

Lufta e Lidhjes, e zhvilluar në kushtet e krizës lindore e cila kishte vënë në lëvizje jo vetëm rrethet qeveritare të shteteve të interesuara, por edhe opinionin e gjërë publik botëror, ushtroi ndikimin e vet dhe tërroqi vëmendjen edhe në rrethet demokratike përparimtare evropiane, të cilat ngritën zërim në favor të të drejtave të ligjshme të kombit shqiptar.

Platforma kombëtare patriotike e saj qëndroi në bazë të të gjithë lëvizjes sonë kombëtare. Në momentet kyçe të lëvizjes patriotët shqiptarë iu referuan kurdoherë Lidhjes Shqiptare të viteve 1878-1881 dhe kërkesave të saj themelore për paprekshmërinë e tokave shqiptare, për bashkimin e tyre në një njësi të vetme territoriale, administrative, autonome, si etapë për të kaluar në pavarësinë e Shqipërisë. Akti historik i Kuvendit të Vlorës me Shpalljen e Pavarësisë dhe formimin e shtetit kombëtar në nëntor 1912 e çoi deri në fund këtë kërkesë të Lidhjes së Prizrenit, por në kushtet ndërkombëtare të vështira të Luftës Ballkanike nuk mundi të zgjidhë detyrën tjetër themelore të Lidhjes, ruajtjen e tërësisë territoriale të

Atdheut, për shkak të cungimit të rëndë që iu bë truallit kombëtar shqiptar.

*

* * *

Lidhja Shqiptare e themeluar në Prizren një shekull më parë përbën një ngjarje heroike më jetën e popullit tonë, më historinë e tij të çarë me shpatë e të shkruar me gjak. Ajo krijoj një bazë të shëndoshë për luftërat e mëvonshme për liri, pavarësi e përparim shoqëror.

Traditat e shkëlqyera patriotike të kësaj lufte për liri, pavarësi dhe drejtësi shoqërore u përtëriten me një forcë të madhe në vitet e stuhishme të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare, kur, nën udhëheqjen e Partisë, populli ynë shkroi faqet më të lavdishme të historisë së tij.

Sot, duke kretnuar 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare, përkujtojmë me nderim të thellë luftën heroike të të parëve tanë për bashkimin e çlirimin kombëtar, gjatë së cilës populli ynë u riafirmua si një popull liridashës, atdhedashës, i papërkultur, trim dhe i vendosur për realizimin e aspiratave të tij, si një popull që, ndonëse i vogël, me vitalitetin, guximin, trimërinë e drejtësinë e tij, iu imponua botës kapitaliste dhe imperialiste.

Së bashku me ne, këtë ngjarje të shënuar e përkujtojnë edhe vëllezërit tanë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, të cilët, si pjesë e kombit shqiptar, janë të pandarë nga historia e tij, e luftërave shekullore për liri e pavarësi. Në luftërat e përpjekjet e Lidhjes së Prizrenit, Kosova, Plava, Gucia, Dibra, gjithë krahinat e banuara nga shqiptarë të Malit të Zi e Maqedonisë u bënë ndër qendrat kryesore të luftës për autonominë e mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë. Në këtë përvjetor bashkohen me mendje e me zemër me mëmëdheun e tyre Shqipëri, edhe vëllezërit tanë të mërguar kudo në botë, të cilët do ta kujtojnë dhe nderojnë këtë jubile historik me dashuri e krenari kombëtarë.

Përkujtimi i veprës së madhe të Lidhjes së Prizrenit shtron detyra të rëndësishme përpëra organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe organizatave të masave. Është një detyrë nderi për të gjitha institucionet dhe për rrethet e gjera të aktivistëve, të cilët do të marrin pjesë në këtë aksion politik e shoqëror, që të vënë të gjitha forcat për t'i zhvilluar në një nivel të lartë aktivitetet e parashiikuara në program,

në mënyrë që të dalë më pah, me gjithë rëndësimë e madhështinë e saj, ajo ngjarje e shënuar që shoku Enver Hoxha e ka quajtur një «sfidë e pashembullt» që u bëri populli shqiptar imperialistëve dhe shovinistëve «për të siguruar lirinë dhe unitetin territorial të vendit».

Të gjitha këto manifestime kushtuar njëqindvjetorit të Lidhjes Shqiptare duhet të shërbejnë për ruajtjen e mëtejshme të frysës revolucionare e të patriotizmit të lartë që karakterizon masat tona punonjëse, për forcimin e unitetit të popullit rrëth Partisë, për ruajtjen e zhvillimin e traditave tona të lavdishme. Ato duhet të kontribuojnë në punën e madhe që bëhet në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, për forcimin e lirisë, të pavarësisë e të mbrojtjes së Atdheut, për mobilizimin e masave të gjera të popullit për të luftuar me vendosmëri për kapërcimin e vështirësive që vijnë nga bllokada e rrethimi imperialisto-revisionist, për ta çuar përpara ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

*Marrë nga «Zëri i popullit», Nr. 55 (9228)
e dielë, 5 mars 1978*

MEHMET SHEHU

FJALA E MBAJTUR ME RASTIN E VARRIMIT TË ESHTRAVE TË ABDYL E NAIM FRASHËRIT¹

Shokë dhe shoqe,
Të dashur vëllezér dhe motra,
Qytetarë të Tiranës,

Dita e sotme është një ditë e shënuar për popullin shqiptar — për ne që banojmë në truallin e dashur të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe për vëllezërit tanë shqiptarë përtetj ikufijve të Atdheut.

Me rastin e jubileut të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ne u dërgojmë urimet tonë të zjarrra gjithë vëllezërve tanë shqiptarë në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në gjithë viset e tjera, kudo që jetojnë.

Pas gati një shekulli më dhe të huaj, tash, më jubileun e madh të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, eshtrat e njërit prej bijve më të lavdishëm të popullit shqiptar, të patriotit e luftëtarit të madh Abdyl Frashëri, u sollën dhe do të prehen përgjithmonë më tokën e lirë e të lulëzuar të Mëmës Shqipëri, më tokën tonë të shenjtë, këtu më kryeqytetin e Atdheut tonë, bashkë me eshtrat e poetit të madh, patriotit zemërjzarr, «bilbilit të Shqipërisë», Naimit të pavdekshëm.

Brezi ynë e ka për ndër dhe për detyrë që t'i respektojë më shkallën më të lartë rilindasit tanë të lavdishëm, që bënë aq shumë për lirinë e popullit e të Atdheut, ndër të cilët shkëlqejnë si yj të zjarrtë e të pashuar vëllezërit Frashëri: Abdyli, Naimi dhe Samiu.

Partia e Punës e Shqipërisë është bartësja besnikë e flamurit të Rilindasve dhe është ajo që e ngriti këtë flamur më majat më të larta, më betejat e përgjakshme të epopesë më

1) Fjala është mbajtur më mitingun e punonjësve të kryeqytetit më 11 qershor 1978.

të lavdishme të popullit shqiptar, në Luftën Nacionalçlirimtare e revolucionin popullor, për çlirimin e Atdheut nga qdo zgjedhë e shtypje dhe tash në luftën e pashembullt në rrethim e në bllokadë pér ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Endrrat e mëdha të Rilindasve tanë u bënë realitet në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë heroike, me themeluesin dhe udhëheqësin e saj të lavdishëm, shokun Enver Hoxha në krye, dhe gjakut e djersës së popullit tonë; dhe ajo që është arritur në Shqipërinë socialiste, i ka kapërcyer një mijë herë këto endrra të këtyre patriotëve të mëdhenj e të pavdekshëm. Shqipëria e Skënderbeut dhe e Rilindasve, Shqipëria halle madhe e luftërave shekulllore, me truallin e saj të mbrijtur me gjakun e popullit të vet, Shqipëria socialiste e brezit të Enver Hoxhës, sot po marshon ballëlart e me hap luftarak në rrugën e madhe të socializmit e të komunizmit, në luftë me të gjithë armiqtë e saj dhe të njerëzimit, kundër imperializmit dhe socialimperializmit, kundër revizionizmit dhe reaksionit botëror, e s'ka forcë në botë që ta bllokojë e ta ndalë këtë marshim triumfues revolucionar.

Abdyli dhe Naimi ishim dy nga figurat më të ndritura të Rilindjes sonë Kombëtare, të asaj epoke revolucionare demokratike me rëndësi të madhe në historinë e popullit shqiptar, që shënoi daljen e kombit tonë nga errësira mesjetare — feudale e imperialiste në rrugën e gjerë të kryengritjes së armatosur të popullit shqiptar pér liri e pavarësi, pér demokraci, pér drithë e arsim.

Rilindasit shqiptarë ishin «njerëz të shquar me ide përpriantare. ishin liuministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdhedashuri të madhe e të zjarrtë», mendimtarë e luftëtarë të mëdhenj, të penës e të pushkës, organizatorë e diplomatë të talentuar. Ata shikruan në flamurin e tyre bashkimin e të gjithë popullit në luftën pér lirinë, pér pavarësinë kombëtare dhe pér unitetin territorial të Shqipërisë, pér vënien e Shqipërisë në rrugën e përparimit shoqëror demokratik. Vija e tyre ishte vija e luftës dhëmb pér dhëmb me të gjithë armiqtë e Shqipërisë, me fjalë e me penë, me organizim e me politikë, me pushkë e kryengritje, pér shpëtimin e Atdheut, pér lirinë e popullit, pér demokraci e përparim.

Rilindasit tanë, ashtu si të gjithë patriotët e vërtetë të së kaluarës, që nga koha e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut të madh, nuk ishin «heronj» të vëtmuar, por një plejadë e tërë bijsh të vërtetë të popullit tonë, bartës të virtuteve më

të mira të tij, të lidhur me të si mishi me kockën, shprehës të interesave më të larta të popullit, të shpirtit të tij të qëndresës së papërkultur ndaj çdo armiku, të atdherdashurisë së tij të pakufishme, të vullnetit luftarak e të vitalitetit të tij shembullor. Të tillë ishin Albdyli, Naimi dhe Samiu, Naum Veqilharxhi e Zef Jubani, Jani Vreto e Kostandin Kristoforidhi, Pashko Vasa e Jeronim De Rada, Koto Hoxhi e Hasan Tahsini, Zija Prishtina e dhjetëra patriotë e luftëtarë të tjerë të shquar të Rilindjes, të cilët populli ynë i kujton me dashuri e nderim të thellë. Lavdi ndër shekuj Rilindasve tanë të pavdekshëm!

Karakteri thellësisht politik çlirimtar, përbajtja e theksuar popullore e demokratike, mbështetja te forca e pashtershme e popullit, metoda revolucionare e luftës – kryengritja e armatosur, si rruga kryesore për arritjen e objektivave kombëtare, kanalizimi në këtë rrugë kryesore edhe i gjithë përpjekjeve për gjuhën e kulturën kombëtare, si mjet për zgjimin dhe ngritjen e masave popullore në luftën çlirimtare të armatosur, – këto përbëjnë disa tipare dalluese themelore të asaj lëvizjeje të madhe që njihet me emrin «Rilindja Kombëtare Shqiptare».

Këto tipare themelore karakterizojnë edhe gjithë veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të themeluar më 10 qershor të vitit 1878, e cila përfaqëson një moment kulminant e të lavdishëm të epokës së Rilindjes. **Lidhja Shqiptare e Prizrenit** ishte produkt e vazhdim i drejtëpërdrejtë i përpjekjeve të mëparshme për liri e pavarësi të popullit shqiptar. Ajo përbën një epope të shkëlqyer në zinxhirin e pashkëputur të luftërave heroike gjatë shekujve të popullit tonë kryengritës e të paepur, i cili «e çau rrugën e historisë me shpatë», duke ruajtur kurdoherë të pashuar dëshirën e zjarrtë për liri, për të jetuar zot në tokën e vet, për gjuhën e vet të pasur, traditat e shkëlqyera, zakonet e mira dhe personalitetin e vet të pacënueshëm.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit luftoi me të gjitha energjitet për të bërë realitet qëllimet thelbësore të lëvizjes kombëtare të popullit shqiptar: për njohjen e kombit shqiptar dhe për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në një shtet të lirë, për të fituar të drejtat e autonomisë kombëtare ndaj sundimit osman dhe për të mos lejuar copëtimin e Shqipërisë nga fuqitë e mëdha të Evropës dhe shovinistët e tërbuar të Ballkanit.

Lidhja e Prizrenit dhe populli shqiptar, që u bashkua rreth

saj, në të gjitha viset e Atdheut tonë, nuk iu nënshtruan presioneve, shantazheve e dhunës së shteteve të mëdha imperialiste, por me guxim e trimëri të pashoqe ngritën krye, dhe, me armë në dorë, iu kundërvunë pushtuesve osmanlinj, Traktatit famëkeq të Shën-Stefanit të vitit 1878 dhe vendimeve antishqiptare të Kongresit të Berlinit të po atij viti për copëtimin e Shqipërisë. Lidhja e Prizrenit dhe populli shqiptar luftuan me guxim e heroizëm kundër copëtimit të Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha, kundër qëllimeve të poshtra shoviniste të monarkive ballkanike fqinje dhe sulmeve të tyre barbare kundër viseve të Shqipërisë.

Do të mbeten të paharruara në shekuj luftërat e zhvilluara nga forcat e popullit të armatosur të Lidhjes së Prizrenit, siç është lufta kundër Mehmet Ali Pashës në Gjakovë, siç janë betejat e lavdishme përmbrojtjen e tokës shqiptare në Plavë e Guci, në Hot e Grudë dhe në Ulqin, beteja e përgjakshme e Shtimjes e të tjera të panumërtë, që vazhduan për tre vjet rreshth dhe në të cilat populli ynë, me heroizmin masiv, shkroi një nga faqet e lavdishme të historisë së tij për lirinë e vet, për tokën e vet, për vatanin e vet.

Lidhja e Prizrenit u kthye në një lëvizje të përgjithshme kombëtare, në të cilën u përfshinë përpjekjet dhe lufta e popullit tonë në të gjitha viset ku shqiptarët përbënën një tërësi kompakte dhe shumicën e popullsisë, në të katër vilajetet e asaj kohe – të Shkodrës, Kosovës, Manastirit e Janinës. Abdyl Frashëri dhe bashkëluftëtarët e tij jo rastësishzt zgjodhën Prizrenin si qendër të Lidhjes së shiptarëve. Kosova kreshnike gjithmonë ka qenë vatër e zjarrtë e patriotizmit shqiptar, si gjithë krahinat e Shqipërisë në Jug e në Veri, në Perëndim e në Lindje. Kudo u ngritën degë të Lidhjes Shqiptare, ndërsa në krahinat e çliruara ato zëvendësuan pushtetin osman me pushtetin shqiptar dhe populli, pa dallim feje e krahine, u bashkua i téri nën flamurin e Lidhjes.

Kjo luftë e drejtë thellësishzt popullore, e karakterizuar nga mobilizimi aktiv i të gjitha energjive krijuese, nga patriotizmi i flaktë i masave të gjera të popullit tonë dhe nga heroizmi masiv i tij, nxorri në shesh personalitete të tillë të shquara politike, ushtarake e të kulturës sonë kombëtare, si Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, Ymer Prizreni, Pashko Vasa, Thimi Mitko, Haxhi Zeka, Iliaz Dibra; nxorri luftëtarë heronj e prijës popullorë si Mic Sokoli, Ali Ibra, Shuaip Spahi, Isuf Sokoli, Ramadan Zaskoci, Jakup Ferri, Odhise Kas-

neci (Nesturi), e shumë e shumë të tjerë, para kujtimit të të cilëve përulet me nderim të thellë populli ynë.

Vendimi i Presidiumit të Kuvendit Popullor për t'u dhënë titullin «Hero i Popullit», luftëtarëve të shqar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit — Abdyl Frashërit, Sulejman Vokshit dhe Mic Sokolit, si dhe dekorimi i shumë patriotëve të tjerë të asaj periudhe, është shprehje e vlerësimit të lartë që i bëjnë Partia dhe pushteti ynë popullor luftës heroike që këta patriotë të mëdhenj kanë bërë për interesat e popullit e të Atdheut, është vlerësimi i lartë që Partia, pushteti dhe populli ynë u bëjnë vetë Lidhjes së Prizrenit e veprimtarisë së saj patriotike revolucionare. Lavdi luftëtarëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që luftuan me aq guxim e heroizëm, përlirinë e popullit, përtokën shqiptare, përkombin shqiptar!

Abdyl Frashëri ishte udhëheqësi politik dhe ideologu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, diplomati i mëncur që e përfaqësoi Lidhjen me dinjitet në botën e jashtme dhe mbrojti me këmbëngulje interesat e kombit shqiptar para Fuqive të Mëdha kundër synimeve të egra të shovinistëve ballkanikë për copëtimin e Shqipërisë. Ai ishte shpirti i Lidhjes së Prizrenit e i luftës së saj, frymëzuesi e hartuesi i programit të saj, aktivisti, luftëtar i organizatorëve palodhur përvënien në jetë të këtij programi luftarak e revolucionar. Si përfaqësuesi kryesor e më konsekuent i krahut më përparimtar në gjirin e Lidhjes, Abdyl Frashëri ishte i pari që lëshoi kushtrimin në popull për kryengritje të armatosur, pa pyetur për Perandorinë Osmane dhe Fuqitë e Mëdha, por me forcat e popullit e në luftë dhëmb për dhëmb me të gjithë armiqtë, përtë fituar autonominë e Shqipërisë ndaj Stambollit dhe kundër copëtimit të Shqipërisë nga monarkitë shoviniste ballkanike, të përkrahura nga Fuqitë e Mëdha imperialiste të Evropës.

Populli shqiptar, në të gjithë truallin tonë kombëtar, e ndoqi Abdyl Frashërin në rrugën e nderit sepse aspiratat e këtij patrioti të madh ishin aspiratat e vetë popullit, sepse lufta që ai udhëhiqte shprehë interesat më të larta të popullit e të kombit shqiptar. Pushtuesit osmanllinj e dënuan dhe e kalbën nëpër burgje Abdyl Frashërin, por ai kurrë nuk u përkul, ndërsa populli e ruajti atë në zemër dhe e bëri të pavdekshëm. Dhe është përsëri populli ynë që sot, me Partinë e lavdishme të Punës në krye dhe zot në vendin e tij, i solli eshtrat e birit të vet të paharruar që të pushojnë për jetë në tokën tonë të shenjtë që e lindi dhe përtë cilën ai shkrua

gjithë jetën. I paharruar qoftë kujtimi i patriotit të madh revolucionar Abdyl Frashëri!

Duke nderuar sot kujtimin dhe veprën e Abdyl Frashërit, populli ynë përulet me respektin më të madh edhe përpara kujtimit të vëllait e bashkëluftëtarit të ngushtë të tij, Naimit. Figura dhe vepra e pavdekshme e Naim Frashërit, e këtij luftëtar i zemërzi jarr të Rilindjes sonë Kombëtare, që tërë jetën e shkru «si qiriri» në shërbim të Atdheut dhe të popullit, ka mbetur e do të mbetet e skalitur përgjithmonë në mendjen dhe në zemrën e popullit shqiptar.

Naimi ishte një mendimtar i shqar, që aq shumë i dha zhvillimit të kulturës sonë kombëtare. Ai është poeti ynë i madh kombëtar, që aqëmbël u këndoi Mëmëdheut e bukurive të natyrës shqiptare, që me aq zjarr u këndoi lirisë e shpirtit të papërkultur patriotik të popullit shqiptar. Talentin e tij të fuqishëm dhe veprën e tij letrare madhështore Naimi i vuri në shërbim të çështjes më të madhe e më të shtrenjtë, në shërbim të clirimtë Atdheut e të popullit shqiptar. Ai nuk ishte poeti i salloneve dhe i botës së vogël meskine, as nuk u thuri lavde sultani e shtypësve, konkuastrorëve e gjakpirësve, por u këndoi popullit dhe luftës së tij përliri, i këndoi kryetrimt dhe heroit tonë kombëtar që udhëhoqi popullin në atë luftë legjendare që bëri epokë dhe që mban emrin e tij — Gjergj Kastrioti — Skënderbeut. Naimi u këndoi shpirtit dhe ndjenjave të pastra të popullit, u këndoi tokës shqiptare, bukurisë frymëzuese të saj. Vepra e Naimit ishte një kushtrim përparimtar drejtuar popullit përtë ripërtëritur ato tradita e virtute të lavdishme që gjithmonë e kanë karakterizuar popullin shqiptar dhe përtë rrëmbyer armët për clirim e vendit nga zgjedha e huaj.

Naimi është themeluesi i vërtetë i gjuhës letrare shqipe, të cilën e shihte me një koncept të theksuar politik, si një barrierë të fuqishme kundër rrezikut të asimilimit kulturor të huaj dhe si një armë të mprehtë përtë zgjuar ndërgjegjen kombëtare të popullit tonë në luftë kundër sklavërisë.

Drita e përhapur nga Naimi nuk u shua asnjëherë, por vazhdoi t'u ndriçonte brezave rrugën e luftës përliri, rrugën e nderit e të përparimit. Vepra e tij historike, si pjesë e pandarë e thesarit të madh shpirtëror të popullit tonë dhe shprehje e shkëlqyer e gjenisë krijuese të tij, jeton e nderohet në Shqipërinë e re socialiste. Emri dhe vepra e Naimit të madh do tëjenë kurdoherë një pishtar i pasuar në truallin shqiptar.

Patriotët dhe luftëtarët e mëdhenj të Rilindjes sonë Kom-

bëtare nuk jetuan të shihnin fryshtet e veprës së tyre. Por mundi dhe gjaku i derdhur nuk shkuan kot. Ata hodhën rrënje e u mishëruan në përpjekjet e brezave të mëvonshëm që, duke ecur në gjurmët e të parëve, mbajtën gjithmonë të gjalla traditat e luftës për liri.

Kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912, luftërat heroike dhe veprimtaria e palodhur patriotike e Ismail Qemalit e Luigj Gurakuqit, Isa Boletinit e Ded Gjo Lulit, Çerçiz Topullit e Mihal Gramenos, Hasan Prishtinës dhe qindra e qindra të tjerëve, që u kurorëzuan me fitoren historike të shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912; luftërat e pandërprera të shqiptarëve kundër ndërhyrjeve e pushtimeve imperialiste; kryengritja e madhe fshatare e Haxhi Qamilit e viteve 1914-1915; epopeja e lavdishme e Vlorës e viti 1920; revolucioni demokratiko-borgjez i viti 1924; lufta e demokratëve revolucionarë si Avni Rustemi, Bajram Curri e shokët e tyre dhe e grupeve komuniste kundër regjimit satrap, antipopullor, antikombëtar e obskurantist të Ahmet Zogollit; rezistenca e armatosur ndaj pushtimit fashist italian të 7 prillit 1939, — të gjitha këto janë dëshmi të gjalla historike, që tregojnë se populli ynë kurrë nuk i lëshoi armët nga dora dhe nuk i pushoi për asnjë çast luftën e përpjekjet për pavarësi kombëtare e gjirim kombëtar.

Këto tradita të lavdishme luftarake revolucionare i trashëgoi, i zhvilloi e i ngriti akoma më lart Partia jonë heroike në epopenë më të shkëlqyer të historisë shumëshekullore të popullit tonë, në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, dhe i brumosi ato me një përbajtje të re në luftën e pashebullt për ndërtimin e mbrojtjen e socializmit, për triumfin e mark-sizëm-leninizmit dhe të çështjes së revolucionit e të gjirimit të popujve.

Shokë dhe shoqe,

Rilindasit tanë të mëdhenj, midis të cilëve Vëllezërit Frashëri ishin ndër më të shquarit, tëndërruan, menduan, u përpoqën, luftuan dhe shkrinë gjithë jetën e tyre për të mirën e Atdheut, për ta parë Shqipërinë të lirë, të bukur, të begatshme e të përparuar.

Sami Frashëri, ideologu i mençur i Rilindjes sonë Kom-bëtare dhe dijetari e filozofji i madh i atyre kohëve, shkroi librin «Shqipëria q'ka qenë, q'është dhe q'do të bënëtë». Në të ai fliste për një Shqipëri të së ardhmes; politikisht të përparuar demokratikë, që sipas tij do të ishte e fortë po të kishte mbështetjen e popullit, për një Shqipëri ku të nxirre-

shin e të përpunoheshin metalet, të ndërtoheshin rrugë të hekurta dhe të zhvilloheshin industria e zejtaria, ku të thaheshin moçalet, të vaditeshin tokat e të përparonin bujqësia, blegtoria e pemëtaria. Samiu donte një Shqipëri të çliruar nga errësira e padiges, ku të zbatohet arsimi fillor i detyruar falas dhe të hapeshin shkolla të mesme e universitete, ku të ngriheshin akademia e shkencave, institute studimesh e shtypshikronja, ku të zhvilloheshin arti e kultura kombëtare, ku gruaja të çlirohej nga zgjedha e rëndë e zakoneve prapanike e nga sundimi i burrit etj. Ai bënte thirrje që të luftohej për të drejtat tona për të mirën e kombit tonë, dhe thoshte se «kush të na qëndronjë përpara e të na ndalonjë në këtë udhë të shenjtëruarë ta shtyjmë, ta rrëzojmë, ta shkelim e të shkojmë tutje... Të mos trembemi nga gjëkafshë, të përipiqemi e të mos pushojmë gjer sa të fitojmë atë që kërkojmë».

«Lum kush të rronjë, ta shohë zonjë» shkruante Naimi për Shqipërinë, duke shprehur këtë dëshirë të zjarrtë të të gjithë Rilindasve. Dhe ja, sot Shqipëria socialiste, në sajë të udhëheqjes së Partisë dhe të gjakut e të djersës së popullit, është bërë «zonjë», e çfarë «zonje»! Është bërë «zonjë në shtëpinë e vet», që gjëzon respektin e miqve të shumtë në gjithë botën dhe s'u trembet armiqve të tërbuar. Ajo është bërë një luftëtare heroike, e veshur me petkun e kuq të socializmit e të komunizmit, që mban në dorë pushkën e kazmën dhe çan përpara me guxim e vrull ronor në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste me djersën e vet dhe që s'ka forcë në botë ta ndalojë atë në këtë rrugë. Lavdi ndër shekuj Partisë sonë të Punës, që është pasardhësja e denjë e Rilindasve tanë, bartëse dhe zbatuese konsekiente e ideve e mësimeve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, besnikë gjer në fund e interesave të popullit, të socializmit dhe të komunizmit!

Rilindasit tanë ëndërronin për një Shqipëri të çliruar nga rendi feudal regresiv e obskuratorist. Atdheu ynë sot është vendi ku janë likuiduar përgjithmonë jo vetëm mbeturinat e marrëdhënieve feudale, por dhe marrëdhënet kapitaliste të shfrytëzimit të njeriut nga njeriu dhe ka triumfuar, në qytet e në fshat, rendi më i përparuar që njeh historia e njerëzimit – socializmi.

Te ne është në fuqi dhe qëndron e patundur si shkëmb graniti diktatura e proletariatit, që siguron demokracinë e vërtetë e më të plotë për masat e gjera të popullit punonjës,

me klasën punëtore në krye, e vetëm për to, që siguron ecjen gjithmonë përpëra në rrugën e lavdishme të ndërtimit të socializmit dhe që mbron interesat e popullit e të socializmit nga çdo armik.

Vepër e madhe e Partisë dhe e popullit e ka bërë Shqipërinë një vend socialist, ku ka vetëm zhvillim, lulëzim, përpërim, drejtësi shoqërore, punë, mësim, jetë të lumtur e të gëzueshme dhe luftë konsekuente për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste e për mbrojtjen e socializmit e të Atdheut nga gjithë armiqtë.

Jeta e lumtur që ne gjëzojmë në Shqipërinë socialiste është arritur me djersë e përpjekje të mëdha, me luftë heroike e punë të palodhur për të kapërcyer vështirësitë e panumërtë, për të përballuar blokadën e egër imperialisto-revizoniste, për të imposhtur të gjitha planet djallëzore të armiqve të brendshëm e të jashtëm. Presioni i madh i krizës së thellë ekonomiko-financiare të botës kapitalisto-revizoniste, ndaj ekonomisë sonë socialiste nuk ka pasur rrjedhime dhe ndikime negative sepse populli, mën udhëheqjen e Partisë, i ka vënë gjoksin ndërtimit të socializmit duke u mbështetur në forcat e veta.

Ekonomia jonë socialiste është e shëndoshë dhe e qëndruese. Shqipëria e vogël socialiste është vendi i parë në botë pa taksa, vendi që nuk njeh kriza, papunësi, ngritje gmimësh, që e ka të sankcionuar në Kushtetutë se nuk pranon kredi dhe «ndihma» nga asnjë shtet kapitalist e revizionist.

Partia jonë ka krijuar njeriun e ri të shoqërisë socialiste me botëkuptim parimor e virtute të larta morale, që mëndon, punon, lufton e jeton si revolucionar për të ndërtuar socializmin, për të përballuar e çarë rrëthimin e blokadën armiqësore të imperializmit e të revizionizmit dhe për të mbrojtur Atdheun. Marshimi i pandalshëm i revolucionit tonë socialist fshiu ngajeta shoqërore të keqen e madhe të fesë e të zakoneve prapanike, i hapi dyert e shkollave për popullin, emancipoi gruan, i çeli rrugë të gjerë shpërthimit të vrullshëm të aftësive dhe të energjive të pashtershme të masave punonjëse me klasën punëtore në krye.

Lakmitë e fuqive të mëdha imperialiste dhe të lajkejve të tyre shovinistë ndaj Shqipërisë nuk kanë marrë fund; sot këto lakmi janë të po asaj natyre që ishin dikur në kohën e Rilindasve, në mos më të egra e më të djallëzuara, por në kushte të reja. Superfuqitë imperialiste po e çojnë botën drejt luftës, përpiken t'u vënë zjarrin Evropës, Ballkanit dhe gjithë

botës. Revizionizmi modern është vënë krejtësisht në shërbim të kapitalizmit dhe të imperializmit. Oportunizmi i ri është bërë në fakt aleati më i devotshëm i imperializmit amerikan dhe mbështetësi më i zellshëm i forcave më reaksionare dhe fashiste të botës. Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi rus janë në garë me njëri-tjetrin për sundimin e botës. Zhurma e tyre për uljen e tensionit është demagogji dhe maskë. Re shtrëngatash errësojnë sot qielin e qëndrojnë varur mbi popujt e kontinentet.

Por bota «megjithatë lëviz» përpara, revolucioni nuk e ndal marshimin. Popujt po e kuptojnë cilët janë miqtë dhe cilët janë armiqtë e tyre. Lufta e popujve për çlirim dhe kundër imperializmit e neokolonializmit është në ngjitje; revolucionarët dhe marksistë-leninistët e vërtetë i kanë vënë gjoksin stuhisë imperialiste dhe revisioniste, duke u vënë në krye të proletariatit dhe të masave punonjëse në luftën e tyre të ndërlikuar dhe të ashpër kundër sistemit kapitalist, që po plaket dhe që nuk mund t'i shpëtojë vdekjes.

Në frontin e madh të kësaj lufte vendimtare të popujve liridashës, të proletariatit botëror, të revolucionarëve dhe marksistë-leninistëve të vërtetë, të të gjitha forcave përparimtare kundër imperializmit dhe socialimperializmit, kundër revisionizmit dhe oportunitzmit, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë zë një vend nderi si luftëtare e papërkulur, që ka vendosur t'i qëndrojë besnikë gjer në fund çështjes së lirisë së popujve, çështjes së proletariatit, marksizëm-leninizmit, socializmit dhe komunizmit.

Në luftën për ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e Atdheut, në luftën kundër të gjithë armiqve të brendshëm e të jashtëm, populli ynë, duke zbatuar me besnikëri vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë heroike, ka një eksperience të madhe. Gjithë komplotet e armiqve kundër Shqipërisë socialiste kanë dështuar gjer më sot dhe do të dështojnë edhe në të ardhmen. Garanci për këtë është udhëheqja heroike e Partisë sonë me shokun Enver në krye, është vitaliteti i madh i popullit tonë dhe uniteti i çeliktë i radhëve të Partisë rrëth Komitetit Qendorr të saj, dhe i popullit rrëth Partisë. Përpara këtij uniteti bëhet pluhur e hi çdo oryatje e armiqve. Kush nga armiqtë tanë të jashtëm i nën-vlerëson forcën e këtij uniteti dhe vendosmërinë e Partisë e të popullit tonë për të mos e ndarë fjalën nga vepra, për të mos u shmangur asnjë grimë nga via e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, ai gabon rëndë dhe aq më keq për të,

Patriotëve e luftëtarëve të mëdhenj që luftuan pa kursyer asnjë për lirinë e pavarësinë e Atdheut tonë u qante zemra për një Shqipëri të fortë e «me emër» në Evropë dhe në botë. Ata evokonin kohët e lavdishme të Skënderbeut. «Ti ke pas qenë një zoj’ e randë, burrat e dheut ty t’qujshin namë», shkruante asokohe Pashko Vasa, ky patriot i shquar i Rilindjes, eshtret e të cilit, gjithashtu, u sollën këto ditë në Atdhe. Sot emri i Shqipërisë kumbon dhe dëgjohet me respekt në mbarë botën. Dhe kjo ndodh në sajë të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës në revolucion e në ndërtimin socialist, në sajë të qëndrimeve të saj konsekiente inter-nacionaliste në përkrahje të lëvizjes revolucionare e të popujve liridashës, në sajë të luftës parimore dhe konsekunte që ajo gjithmonë ka zhvilluar e zhvillon kundër imperializmit dhe néokolonializmit ndërkombëtar, e në radhë të parë kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetic, kundër forcave të reakcionit, kundër revizionizmit modern dhe oportunizmit të të gjitha ngjyrave.

Kurdoherë që revisionistët modernë, të tërbuar nga qëndrimi i patundur marksist-leninist i Partisë së Punës të Shqipërisë, mosmarrëveshjet ideologjike i kanë shtrirë edhe në sferën e marrëdhënieve shtetërore, ata kanë pësuar disfatë dhe janë mbuluar me turp, kurse Shqipëria ka dalë gjithmonë triumfuese. Shembulli më i qartë për ikëtë është veprimi reakcionar i Nikita Hrushovit kundër Shqipërisë. Asgjë s’na tremb ne komunistët shqiptarë, popullin shqiptar, sepse ne jemi në të drejtën tonë, në të drejtën proletare, marksiste-leniniste, që është një mijë herë më e fortë se bllokada e rrëthimi imperialisto-revisionist, se shantazhi dhe kërcënimet e armiqve të jashtëm.

Historia e popullit tonë është historia e luftërave të tij shekullore të pandërprera kundër armiqve të egër e të pamëshirshëm, që e kanë shtypur e shfrytëzuar, e kanë vrarë e masakruar në orvatjet e tyre për ta nënshtruar e për ta zhdukur si popull e si komb. Por armiqtë kurrë nuk kanë mundur t’ia arrijnë qëllimit të tyre djallëzor. Në zjarrin e këtyre luftërave janë brumosur ato virtute të larta morale të popullit tonë, ato tradita luftaraake revolucionare, të cilat e kanë bërë të pamposhtshëm popullin shqiptar dhe kanë ngjallur e ushqyer simpatinë e respektin e gjithë rjerëzve liridashës e përparrimtarë të botës për popullin shqiptar dhe Atdheun e tij.

Partia jonë e Punës këto tradita patriotike, luftaraake dhe

revolucionare të të parëve tanë i ka shkrirë në një të vetme me patriotizmin socialist, që është bërë një armë e fuqishme për edukimin e brezit të sotëm dhe të brezave të ardhshëm në luftën për lulëzimin e pandërpërprerë dhe mëbrojtjen e At-dheut tonë socialist, për të imposhtur me heroizëm çdo armik, çdo rrëthim e bllokadë, për t'i mbajtur gjithmonë lart emrin dhe dinjitetin revolucionar të popullit shqiptar, të Partisë së Pumës të Shqipërisë e të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Lavdi luftëtarëve dhe heronjve që shkrinë jetën e derdhën gjakun për Nënën Shqipëri dhe për të mirën e popullit shqiptar!

Lavdi kujtimit të përjetshëm të Abdyl Frashërit e Namim Frashërit!

Rroftë populli ynë heroik, ndërtues i socializmit!

Rrofshin Partia jonë e lavdishme dhe udhëheqësi i dashur i Partisë e i popullit tonë, shoku Enver Hoxha!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Marrë nga «Zëri i popullit»
Nr 140 (9313) e hënë, 12 qershor, 1978*

RAMIZ ALIA

FJALA E MBAJTUR NË MBLEDHJEN SOLEMNE KUSHTUAR 100-VJETORIT TË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT¹

Të dashur shokë dhe shoqe,

Sot mbushen plot 100 vjet nga dita kur në Prizren u themelua Lidhja Shqiptare, që përfaqëson një nga ngjarjet më të shquara të historisë sonë të lavdishme. Ajo u krijua në situata shumë të ndërlíkuara e kritike, kur shtrohej çështja e mbrojtjes së të drejtave të ligjshme të kombit shqiptar, që ishim marrë nëpër këmbë e shkeleshim në mënyrë të egër nga sunduesit osmanllinj, kur fuqitë e mëdha imperialiste të Evropës dhe monarkitë shoviniste të Ballkanit, po kur-disnin plane të errëta për grabitjen e tokave shqiptare.

Luftërat e përpjekjet heroike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit pér liri dhe pér bashkimin e Atdheut në një shtet kombëtar i kujtojmë sot me ndjenjën e një respekti e mirënjohjeje të thellë, duke vlerësuar e ngritur lart rolin e pasojat e tyre historike pér krijimin e Shqipërisë së pavatur. Rruga dhe lufta e patriotëve shqiptarë, sic e ka karakterizuar shoku Enver Hoxha, «nuk ishte një rrugë e lehtë, rrugë e dredhive dhe e përuljes, e nënshtimit dhe e frikës para më të fortit, por rrugë e përleshjeve me armiqtë e egër të jash-tém dhe të brendshëm, të hapur dhe të maskuar, rrugë e çarë nga populli me gjoks, me mprehtësi e pjekuri të madhe politike, me penë, me pushkë në dorë, me gjak e sakrifica të panumërtë». (E. Hoxha, Vepra, vell. 24, f. 7).

Sot, duke festuar 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, e kësaj faqeje të ndritur të historisë sonë të shkruar me gjak, ne përkujtojmë me respekt e nderim të thellë heroizmin e

1) Fjala është mbajtur në mbledhjen solemne në Tiranë më 10 qershor 1978.

sakrificat e të gjithë atyre që për çështjen kombëtare nuk kur-syen asgjë dhe që, në situata shumë të vështira e të komplikuara, luftuan me trimëri të rrallë, me pushkë, me penë e me qka mundën për Shqipërinë mëmë. Ne nderojmë me mirënjohje kujtimin e udhëheqësve të shquar që dolën nga gjiri i popullit tonë të vogël në numër po të madh në trimëri, burrëri e mençuri. Atdhedashuria, guximi, urtësia e Abdyl Frashërit dhe Sulejman Vokshit, Iliaz Dibrës e Shuaip Spahisë, Ymer Prizrenit e Mustafa Tetovës, Daut Boricët, Filip Çekës, Selim Çobës, Mihal Haritos, Petro Meksit, Dhimitër Kolesë, Thimi Mitkës, Hëmnettë Ali Vrionit, Haxhi Zekës, Odhise Kasnecit e burrave të tjerë të asaj kohe nga të gjitha krahinat e Shqipërisë që i dolën zot Atdheut në ato rre-thana kritike, do të mbeten brez pas brezi shëmbull i madh i atdhedashurisë e devotshmërisë për popullin e vendin e tyre. Heroizmi i luftëtarëve të shquar popullorë, si Mic Sokoli e Ali Ibra, Isuf Sokoli e Mehmet Beci, Mehmet Gjyli, Jakup Ferri, Ramadan Zaskoci e shumë të tjerë, që i vunë gjoksin grykës së topave të armikut, do t'u kujtojnë gjithmonë brezave të tanishëm e të ardhshëm se lirinë popullit tonë nuk ia fali kush por e fitoi më gjakun e luftën e tij.

Njëqindvjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit populli ynë e përkujton i lirë dhe i pavarur, në një unitet të pathyeshëm dhe i bashkuar si mishi me kockën me Partinë e tij të Punës. Ai e përkujton këtë ngjarje të madhe historike në Atdheun e tij të përtëritur, zot i vendit dhe i fateve të tij, kur i udhëhequr nga Partia e vet marksiste-leniniste me shokun Enver Hoxha në krye, po ndërton jetën e tij të re dhe lulëzon Atdheun, kur Shqipëria socialiste nderohet e respektohet në të gjithë botën. Ai e përkujton këtë datë në hovin e punës e të entuziazmit të madh revolucionar për të zbatuar vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë në të gjitha fushat, për të çuar përpara industrinë e bujqësinë socialiste, arsimin e kulturën, për të forcuar mbrojtjen e Atdheut.

Në këtë përvjetor të shënuar të historisë sonë kombëtare, kur ne përkujtojmë me krenari luftëni heroike që bretat e kaluar kanë bërë për çlirimin e unitetin kombëtar, luftën që i tregoi botës vitalitetin dhe trimërinë e popullit shqiptar, vendosmërinë e tij për të jetuar i lirë e i pavarur, u dërgojmë përshtëndetjet tona gjithë shqiptarëvë patriotë ku-do që ndodhen, vëllezërve tanë të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, të cilët, si pjesë e pandarë e kombit shqiptar, jamë të pandarë nga historia e tij shekullore.

*
* *

Në historinë e lëvizjes sonë kombëtare Lidhja Shqiptare e Prizrenit zë një nga vendet më të shquara, ajo përfaqëson një etapë të rëndësishme të saj. Lidhja e Prizrenit është e para organizatë politike mbarëshqiptare e ngritur brënda në Shqipëri e që përfshiu gjithë vendin, një organizatë që ka jo vetëm një platformë ideologjike kombëtare e një program të përcaktuar qartë politik, por edhe një organizim shtetëror në shkallë kombëtare, një ushtri të sajën dhe një aparat propagandistik e kulturor të vetin. Ajo veproi si përfaqësuese e vetme e gjithë popullit jo vetëm brenda vendit, por edhe ndaj botës së jashtme, qeverive të huaja e organizmave ndërkombëtare. Në qoftë se shtetet e tjera formalisht nuk e pranuan, ajo i detyroi ato ta njojin në fushat e luftës dhe në ndeshjet diplomatike. E rëndësishme është se Lidhja e Prizrenit çështjen e lirisë e të pavarësisë së Shqipërisë e shtroi si një problem të ngutshëm e përzgjidhje imediate, si një problem që tanimë askush nuk mund ta injoronte. Ajo sfidoi Evropën imperialiste dhe i tregoi asaj se popullin shqiptar asnjë shypje, asnjë dhunë, asnjë komplot e intrigë nuk mund ta largonte nga rruga që kishte nisur.

Në kohën kur Shqipërinë e kanoste një kob i madh, copëtimi i trojeve të saj dhe përjetësimi i skillavërisë së huaj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u vu në krye të të gjithë popullit dhe nisi një luftë heroike përmbrrojtjen e të drejtave të tij. Programi i saj shprehte kërkesat themelore të lëvizjes kombëtare shqiptare: njojhen e kombit shqiptar si një e të pandarë e respektimin e parimit të kombësisë, ruajtjen e parprekshmërisë e të tërësisë së trojeve kombëtare dhe bashkimin e tokave të Shqipërisë në një shtet të vetëm kombëtar.

Lufta e Lidhjes për realizimin e këtij programi kur Shqipëria jo vetëm nuk kishte aleatë, por kishte shumë armiq, ishte me të vërtetë një ndërmarrje heroike. Vetëm një patriotizëm i flaktë, një qartësi mendimi, një besim i patundur në forcat e veta, një shpirt kryengritës dhe një krenari e lartë kombëtare mund t'i ngrinte, ashtu siç i ngriti, shqiptarët në luftë me «shtatë krajlat».

Lidhja e Prizrenit, si çdo ngjarje e madhe historike, nuk ishte një shpërthim i rastit, as edhe pellë e koniukturave, ajo nuk ishte një krijesë e diplomacisë së huaj, siç pretendoj-

në disa historianë të përciptë ose antishqiptarë. Ajo ishte rezultat i natyrshëm i zhvillimit të brendshëm politik ekonomik e shoqëror të Shqipërisë dhe i kishte rrënjet në luftën shekullore të popullit tonë për liri e pavarësi. Ajo nuik lindi në një tokë të shkretë, por ishte vazhdim i qendresës heroike të popullit shqiptar ndaj stuhive të tmerrshme të historisë, ishte rrjedhim i përpjekjeve aktive të një kombi të formuar plotësisht që luftonte për mbrojtjen e interesave të veta jetike.

Kur u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit Shqipëria kishte hyrë në shekullin e pestë të robërisë turke, e cila i kishte sjellë popullit shqiptar fatkeqësi e vuajtje të panumërtë. Shtypja kombëtare, shfrytëzimi i egër feudal, padituria në të cilën e mbante popullin pushuesi i huaj, luftërat shkatërrimtare të Perandorisë Osmane, pasiguria e anarkia ishin bërë të padurueshme. Çështja e flakjes tej të zgjedhës së huaj shtrohej si çështja me imperative përpëra popullit tonë. Kryengritjet e panumërtë, të cilat qysh nga koha e Skënderbeut nuik ishin pushuar asnjëherë, edhe pse kishin dështuar e ishin shtypur egërsisht, kishin lënë qdoherë pas tyre një urrejtje më të thellë për sundimtarët e huaj, një dashuri më të fortë për lirinë, një vendosmëri më të madhe për të fituar. Kjo dashuri për lirinë dhe kjo urrejtje për armiqtë, që ishin grumbulluar nga brezi në brez, do të shpërthemin si vullkan një ditë për t'i hapur rrugën çlirimt të kombit shqiptar dhe krimjitet të shtetit të tij të pavarur. «Në luftë për ekzistencën kombëtare dhe për çlirimin, — ka shkruar Marks, — shfaqet edhe ndërgjegjja nacionale, që synon në formimin e shteteve kombëtare...». (K. Marks — F. Engels, Vepra, Vëllimi 27. f. 186).

Shekulli i 19-të, ashtu siç kishte ndodhur edhe në vende të tjera të Evropës, kishte sjellë ndryshime rrënjesore në trevat shqiptare. Lindja e marrëdhënieve të reja kapitaliste, lidhja e krahinave midis tyre, shkrirja e tregjeve lokale në një treg të përbashkët kombëtar, kishin krijuar një bashkësi të vetme ekonomike, që krahas ekzistencës së bashkësisë së gjuhës e të territorit, kishin çuar në formimin e kombit shqiptar. Si rrjedhim, tanimë qdo veprim me karakter politik, ekonomik e kulturor merr dimisione dhe ka një vulë të qartë kombëtare.

Kjo gjë vihet re edhe në kryengritjet e mëdha popullore të viteve 30-70 të shekullit të 19-të, të drejtuara kundër pasojave shkatërrimtare të reformave turke të Tanzimatit e në mënyrë të veçantë kundër administratës së korruptuar bu-

rokratike që Porta e Lartë u orvat të vendoste në Shqipëri. Këto kryengritje e pasqyrojnë në mënyrë të qartë ndryshimin rrënjesor që kishte ndodhur në procesin e zhvillimit historik të popullit shqiptar. Shumë nga ato i kaluan caqet krahinore të kryengritjeve të mëparshme, siguruan lidhjet ndër-krahinore dhe udhëhiqeshin jo më nga feudalët e mëdhenj, por nga krerë të vegjël lokalë të lidhur me masën e fshatarësisë. Këto kryengritje mishëruan një ide tepër të rëndësi-shme; atë të dallimit të kombësisë shqiptare dhe shtruan çështjen e trajtimit të posaçëm të Shqipërisë, si një provincë më vete e Perandorisë, që të administrohej jo më nga nëpunës turq, por nga njerëzit e vendit. Këto dëshmojnë se tanimë në Shqipëri ekzistonin një komb dhe një ndërgjegje e formuar kombëtare. Këtë realitet e ka shprehur fare qartë një nga burrat e shquar të Rilindjes, Pashko Vasa, në tetorin e 1878-tës kur shkruamte: «Ndërgjegjja e popullit shqiptar ngre krye kundër idesë së nënshtimit... Pikërisht te kjo ndjenjë e ka burimin Lidhja e sotme Shqiptare. Ideja (e krijimit të saj) nuk është frymëzuar prej askujt, ajo ka lindur në ndërgjegjen e të gjithëve në të njëjtën kohë dhe asgjë nuk mund tia priste hovin... përfaqësuesit (e ardhur) në Prizren... pikërisht nga ndërgjegjja kombëtare e marrin parullën pér të komanduar si prijës dhe gjithashtu ndërgjegjes kombëtare i binden ata pér të vepruar si ushtarë». («Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912», Tiranë 1978. Memorandumi i 22 tetorit 1878, dokumenti 32, f. 67).

Lidhja e Prizrenit u formua në një kohë kur në Shqipëri ish ndierë fort jehona e revolucionit francez, e revolucioneve të 1848-tës etj., që kishin tronditur Evropën. Shumë nga udhë-heqësit e kryengritjeve shqiptare, e në mënyrë të veçantë ideologët e lëvizjes kombëtare, ishin frymëzuar nga idetë përparimtare të kohës dhe kishin nxjerrë mësimë nga këto revolucionë. Të panumërt ishin gjithashtu shqiptarët që kishin marrë pjesë në kryengritjet antiturke që kishin çuar në fitimin e pavarësisë së popujve të Ballkanit. Të gjithë këta tanimë ishin të ndërgjegjshëm se një gjë e tillë duhej të bëhej edhe në Shqipëri. Idetë përparimtare të kohës gjenin një terren të favorshëm në traditat e mëdha shekulllore të popullit shqiptar në luftën e tij pér liri, pavarësi e progres shoqëror.

Që shumë kohë përpëra Lidhjes së Prizrenit, Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Zef Jubani, Jeronim De Rada e ideologët e tjerë të Rilindjes në shkrimet e tyre ki-

shin paraqitur kërkjesat e para me karakter kombëtar për bashkimin e shqiptarëve pa dallim krahine e feje, për përhapjen e arsimit e të kulturës në gjuhën shqipe, për reforma ekonomike e shoqërore, që do ta vinin vendin në rrugën e progresit.

Kështu, ishin krijuar të gjitha kushtet që lëvizja kombëtare shqiptare të ngrihej në një shkallë më të lartë dhe t'i shtronte vetes detyra më të mëdha e më rrënjosore për të zgjidhur. Tani delte nevoja për një organizim në shkallë të të gjithë vendit dhe, mbi të gjitha, për një program, që t'i bashkonte energjitet luftarakë popullore për një qëllim të vetëm.

Këto kërkesa i realizoi Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila mori në dorë drejtimin e gjithë lëvizjes, u shtri organizativisht në të gjitha trevat e Shqipërisë dhe bashkoi në një të vetëm veprimin e masave popullore me idetë kombëtare.

Lidhja Shqiptare në Prizren u realizua në kohën e Krizës Lindore të viteve 1875-1881. Kjo krizë shërbeu si një shkëndijë që nxiti shpërthimin e urejtjes së madhe populllore të grumbulluar në shekuj ndaj pushtuesit të huaj, ajo shërbeu si një shenjë alarmi që bëri të ngrihen më këmbë masat popullore për të mbrojtur vendin, kombin e jetën e tyre nga komplotet që po thurmin Fuqitë e Mëdha.

Objektivisht ekzistonin mundësitet për bashkëpunim midis popujve të Ballkanit kundër armikut të tyre të përbashkët. Por nuk ndodhi kështu. Dhe jo përfajin e shqiptarëve. Mali i Zi e Serbia, ndonëse hynë në luftë me Turqinë në emër të çlirimit të bashkatdhatarëve të shtypur e të bashkimit të tyre kombëtar, synonin të aneksonin edhe pjesën më të madhe të tokave shqiptare. Kështu, zgjidhja e Krizës Lindore, që kishte filluar me kryngritjet popullore antiosmane në Ballkan, pësoi deformimin e parë nga shovinizmi i vendeve fqinje. Ndërkaoq, ndërhyrja e Fuqive të Mëdha imperialiste të asaj kohe i dha kësaj Krizë një drejtim tjeter në dëm të popullit shqiptar dhe në interes të synimeve ekspansioniste të këtyre Fuqive. Filloi kjo me Traktatin e Shën-Stefanit e Kongresin e Berlinit dhe përfundoi me pazarllëqet e mëtejshme në kurriz të popullit shqiptar, që çuan në copëtimin e Shqipërisë më 1913.

Sipas Traktatit të Shën-Stefanit, shteteve sllave të Ballkanit u kalonin vise të tëra shqiptare. Bullgaria e Madhe, që krijohej me këtë rast, përfshinte Kumanovën, Kaçanikun, Tetovën, Kërçovën, Gostivarin, Dibrën, Strugën, Peshkopinë, Pogradecin, Korçën. Serbia merrte një pjesë të sanxhakut të

Prishtinës deri në afersitë e Mitrovicës, ndërsa Malit të Zi i kalonin Gucia, Plava, Vermoshi, Kelmendi, Hoti, Gruda, Tivarë dhe Ulqini. Siç shihet, këtu nuk ishte fjala për ndonjë zonë të ngushtë e të diskutueshme periferike, por për grabitjen e një pjesë të madhe të territoreve shqiptare.

Pasojat e politikës imperialiste të Fuqive të Mëdha e vencanërisht të politikës shoviniste ruse, serbe e malazeze, ishin shumë të rënda për Shqipërinë. Dëbimi me forcë i dhjetëra mijë shqiptarëve nga viset veriore të Kosovës prej ushtrive serbe i dhanë të kuptojë popullit shqiptar se ç'fat e priste nga zbatimi i traktatit të Shën-Stefanit dhe nga vendimet e Kongresit të Berlinit. Pikërisht në këto vite u inaugurua nga qeveritë e Serbisë e Malit të Zi ajo politikë e shpërulguljeve masive me dhunë të shqiptarëve nga tokat e tyre, politikë që ka pasur si qëllim çkombëtarizimin e krahinave shqiptare. Edhe pas vitit 1913, kur me vendimin e fuqive imperialiste gjysma e tokave shqiptare iu dha Serbisë e Malit të Zi, kjo politikë nuk u ndryshua asnjëherë. Bile ajo u përpunua dhe u perfektionua më tej, duke marrë forma të përbindshme, si ato që parashtrohen në programin ultrashovinist të politikanit serb V. Çubriloviç që predikon shpërulguljen me dhunë në Turqi dhe eliminimin fizik të të gjithë shqiptarëve që mbetën nën mbretërinë jugosllave.

Ishin këto rrethana konkrete dramatike të atyre viteve që tronditën rëndë ndërgjegjen e popullit tonë, që bënë të shpërthejë revolta e papërmbarjur popullore dhe një lëvizje e përgjithshme për vetëmbrojtje.

Lidhja Shqiptare që u themelua në Prizren më 10 qershor 1878, njëqind vjet si sot, u krijua për t'i përballuar këto situata kur, shqiptarët, siç e thotë kënga popullore, «lidhën besë si e kem' adet, me fitue ose me dek». Pjesëmarrja në të e përfaqësuesve të të gjitha krahinave të ndryshme të vendit dhe mbështetja e fuqishme që i dhanë asaj të gjitha shtresat shoqërore, fshatarët, malësorët, vegjëlia qytetare, dëshmonë se me Lidhjen e Prizrenit në Shqipëri kishte ndodhur një ngjarje tepër e rëndësishme historike. Në krye të saj u vu atdhetari i flaktë Abdyl Frashëri, ideolog i shquar i lëvizjes kombëtare shqiptare dhe luftëtar i paepur për të drejtat e Shqipërisë, i cili ishte i njohur si në Jug edhe në Veri dhe gjëzonte një besim të madh në popull si mbrojtës i interesave të larta të kombit.

*
* *

Në kushtet e vështira kur Shqipëria ishte e vetme dhe e rrrethuar nga armiq që e kërcënoin nga të katër anët, përpara Lidhjes qëndronin detyra shumë të rënda e të komplikuara, që kërkonin sa trimëri e guxim aq edhe diplomaci e urtësi. Asaj i duhej të luftonte në disa fronte njëkohësisht, nën presionet e kohës që nuk priste dhe të ngjarjeve që kërkonin një reagim imediat.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka meritën e madhe se mbrojti këmbin shqiptar kur armiqjtë kërkonin të mohonin ekzistencën e tij. Që në fillim e gjatë gjithë jetës së saj Lidhja bëri një luftë të madhe për t'ua bërë të qartë jo vetëm fuqive të mëdha që ishin mbledhur në Berlin, por mbarë opnionit publik evropian, se shqiptarët përbëjnë një komb më vete e tanimë të formuar plotësisht, që ka një histori të lashtë, që ka gjuhën e kulturën e tij, që ka dhënë kontributin e vet në qytetërimin evropian, që i ka rezistuar çdo agresori e që nuk është përurur kurrë përpara pushtuesve të huaj.

Volume të tëra përbëjnë memorandumet, letrat e protestat dërguar nga të katër anët e Shqipërisë Kongresit të Berlinit, artikujt e gazetave e dokumentet e tjera që i bëjnë të njojur opinionit publik botëror çështjen shqiptare. «Shqiptarët, — deklaronte Abdyl Frashëri, — kanë ruajtur atdheun e tyre, kombësinë e tyre, gjuhën e tyre dhe zakonet e tyre duke sprapsur në kohët barbare sulmet e romakëve, të bizantinëve dhe të venedikasve. Si mund të lejohet që në këtë shekull të diturisë dhe të qytetërimit një komb kaq trim dhe kaq i lidhur me truallin e tij, të sakrifikohet...?». («Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912». Memorandumi i Lidhjes Shqiptare drejtuar Fuqive nënëshkruuese të Traktatit të Berlinit, Dokumenti 43, f. 83).

Në një memorandum të qytetit të Shkodrës të nënëshkruar nga 500 veta, që iu dërgua Kongresit të Berlinit më 13 qershor 1878 thuhet: «Shqipëtar, qoftë katolik, ortodoks ose mysliman, e urren pushtuesin turk po aq sa urren çdo pushtues tjetër të huaj... Ashtu sikurse nuk jemi dhe as nuk duam të jemi turq, po ashtu do të luftojmë me të gjitha forcat tonë kundër cilitdo që do të kërkonte të na bënte sllavë, austriakë ose grekë. Ne s'duam të jemi veçse shqiptarë». (Historia e Shqipërisë, vël. 2, f. 131, Tiranë, 1965).

Kjo luftë për këmbin shqiptar në atë kohë kishte një

rëndësi shumë të madhe, parimore dhe praktike. Fuqitë e mëdha imperialiste dhe klientët e tyre të Ballkanit, me qëllim që tokat shqiptare t'i përdornin si plagë tregu në pazarllë-qet e tyre, mohonin ekzistencën e kombit shqiptar, të kulturës e të historisë së tij, mohonin ekzistencën e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar dhe e paraqitnin luftën e tij si luftë të disa fiseve të ndara. Pati, ndër këta, që thanë se nuk ekziston fare një popull shqiptar, por vetëm një shprehje gjeografike, Shqipëri. Por perandorët e Evropës, sulltani i Turqisë e mbretërit e Ballkanit e panë shpejt se ç'ishte kjo shprehje gjeografike. Kundër saj dhe për të shtypur rezistencën e armatosur të popullit shqiptar, që nuk pranonte vendimet e tyre ata u detyruan të dërgonin edhe flotat e ushtritë e tyre.

Jehona e këtyre pikëpamjeve reaksionare dëgjohet edhe sot nga disa historianë e publicistë të huaj, të cilët për të nënveftësuar e përcmuar përpjekjet e kombit shqiptar për të drejtat e tij, e paraqitin edhe tani, pas njëqind vjetëve, luftën e Lidhjes së Prizrenit si luftë të «disa fiseve të ndara shqiptare». Këmbëngulja në padrejtësitë e shtrembërimet historike synon të nënveftësojë rëndësinë e luftërave të kombit shqiptar, i cili asnjëherë nuk ka luftuar për të pushtuar tokat e për të shkelur të drejtat e të tjerëve, por gjithë jetën ka qenë në luftë për të mbrojtur vatrat e të drejtat e tij, që të tjerët ia mohonin dhe ia kanë rrëmbyer.

Luftërat e shqiptarëve për njohjen e kombësisë, për të qëndruar në tokat ku kanë lindur të parët e tyre, për gjuhën e kulturën shqipe, për ruajtjen e traditave e të individualitetit kombëtar nuk i kanë sjellë dëm askujt, nuk kanë cënuar të drejtat e ndonjë kombi ose populli tjetër. Edhe evo-kimi i këtyre luftërave e përpjekjeve, që i mbush zemrat e të gjithë shqiptarëve me një krenari të ligjshme për të kaluarën patriotike të popullit tonë, nuk prek askend, përveç se ata që nuk janë çliruar akoma nga shovinizmi antishqiptar dhe nga mbrojtja e padrejtësive që i janë shkaktuar Shqipërisë.

Luftën e madhe dhe të gjithanshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për njohjen e kombit shqiptar dhe për zbatimin e parimit të kombësisë në zgjidhjen e çështjes shqiptare, ne e kujtojmë dhe e vlerësojmë lart jo vetëm si stërnipërit e atyre që në ato vite kritike ngritën zërin dhe rrëmbyen armët për të mbrojtur të drejtat e shenjta e të pacënueshme të kombit shqiptar, por edhe si militantë marksistë-leninistë, për

të cilët lufta për lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar është e pandarë nga lufta për socializëm.

Njohjen dhe afirmimin e kombit shqiptar Lidhja e Prizrenit e shikonte të lidhur ngushtë me çështjen e organizimit politik shtetëror, të një organizimi kombëtar politiko-administrativ, që do të siguronte vetëqeverisjen e Shqipërisë. Këtë mendim politik përparimtar, që pasqyronte zhvillimin historik të kombit shqiptar, Lidhja e shprehur me kërkesën për formimin e një shteti të vetëm kombëtar shqiptar, të një shteti autonom brenda kuadrit të Perandorisë Osmane si hap i parë, për të kaluar, apo të krijuar kushte të favorshme, në shkëputjen e plotë.

Kërkesa e autonomisë së Shqipërisë, që do të bashkonte në një unitet të vetëm të gjitha trojet shqiptare, u shtrua qysh në aktet e para të Lidhjes dhe u zhvillua e u përpunua në mënyrë konsekuente, duke marrë një kuptim më të gjerë e më të thollë, në zjarrin e luftës kundër shovinistëve fqinj dhe sunduesve osmanë. Nëpërmjet Këshillit të saj të Përgjithshëm të mbledhur në Prizren në nentor 1878, Lidhja shtroi përrapa Portës së Lartë dhe fuqive evropiane vullnetin e përbashkët të kombit për të krijuar me katër vilajetet, ku shqiptarët përbënин pjesën më të madhe dhe kompakte të popullsisë, një vilajet të vetëm me një qendër në mes të Shqipërisë, me administratë shqiptare e me një kuvend të përgjithshëm që të zbatonte reforma të dobishme përvendin.

Në Kuvendin e Gjirokastrës, që u mblohdh në korrik të 1880-tës, me përfaqësues të të gjitha viseve shqiptare, u bë një hap i mëtejshëm, u shtrua kërkesa e formimit të një qeverie shqiptare dhe e shkëputjes faktike të Shqipërisë nga perandoria Turke. Programi i hartuar në Gjirokastër dëshmon se kërkesat e Lidhjes për zgjidhjen e njëkohshme të ruajtjes së tërësisë tokësore, të bashkimit e unifikimit të trojeve shqiptare dhe të qeverisjes autonome kombëtare të vendit, u përgjigjeshin plotësisht dëshirave e aspiratave të popullit shqiptar, idealit të lëvizjes kombëtare shqiptare.

Lidhja e Prizrenit luftonte për një shtet të tillë autonom shqiptar që të ishte një dhe i pandarë. Ajo hodhi poshtë dhe dënoi si veprime antishqiptare të gjitha projektet e fuqive të mëdha për të ashtuquajturën «zgjidhje» të çështjes shqiptare nëpërmjet formimit të njësive të veçanta autonome të mbësh-tetura në ndasitë krahinore ose fetare, pas të cilave fshihejshin interesat e fuqive të huaja evropiane dhe ballkanike për ta mbajtur nën sundimin e tyre gjithë Shqipërinë.

Meritë historike e Lidhjes dhe shprehje e guximit të saj është fakti se ajo, e mbështetur në forcat ushtarake vullnetare që kishte ngritur me iniciativën e vet dhe me përkrahjen e popullsisë, pa pritur miratimin e sulttanit, e zbatoi autonominë në praktikë, zëvendësoi dora-dorës administratën civile dhe ushtarake turke, duke ushtruar pushtetin e vet të plotë në viset veriore e lindore të Shqipërisë, dhe sidomos në vilajetin e Kosovës. Në viset e tjera administrata osmane qëndronte formalisht, sepse praktikisht ishte e paralizuar. Lidhja nuk pati frikë të merrte përsipër përgjegjësitë historike që impononte koha dhe këtë e tregoi fare mirë kur, në fund të vitit 1880, në Prizren, në marrëveshje me Abdyl Frashërin dhe përfaqësues të tjerë të Shqipërisë së Jugut, Komiteti Qendror i Lidhjes e shpalli veten «Qeveri e Përkohshme» shqiptare me Ymer Prizrenin në krye.

Duke u bërë jehonë këtyre ngjarjeve, ideologu i madh i Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri i shkruante Jeronim De Radës se «Lidhja e Prizrenit e pa të nevojshme të bashkojë Shqipërinë e ta bëjë një me autonomi, e mbase me shkëputje fare, pas pumës. Kështu Lidhja mori emrin e Kuvernës së Përdorme (qeveri e përkohshme) dhe përzuri guvernoratët turq nga gjithë vilajeti i Kosovës dhe nga Prizreni, nga Gjakova, nga Tetova, nga Dibra etj.».

Ndonëse jetoi një kohë të shkurtër, krijimi i «Qeverisë së Përkohshme» pati një rëndësi të madhe. Ajo ishte një dëshmi e aftësive të popullit shqiptar për të qeverisur vetë vendin, për një jetë shtetërore të organizuar e të pavarur, që një propagandë e tërë armiqësore përpinqej t'ia mohonte. Nga ana tjetër, me kushtetimin e Komitetit Qendror të Lidhjes në qeveri të përkohshme, populli shqiptar tregonte se thyente jo vetëm «vullnetin» e sulttanit, por edhe normat e rregullat ndërkombëtare që fuqitë e mëdha vendosnin nëpër kanceleritë e tyre.

Përfaqësuesit radikalë të Lidhjes dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në tërësi formimin e një shteti kombëtar autonom dhe shkëputjen e tij nga Perandoria Osmane nuk e shikonin thjesht si një akt formal administrativ, por si një kthesë që do t'i çelte rrugën përparimit ekonomik, shoqëror e kulturor të pavarur të vendit. Në pikëpamjet dhe veprimitarirë e udhëheqësve të Lidhjes patriotizmi e demokratizmi ishin të pandarë.

Shqipëria e pavarur në konceptin e ideologut të shquar të Rilindjes Kombëtare Sami Frashëri, e që përfaqësonte mendimin shqiptar të përparuar të kohës, nuk do të kishte ne-

vojë as për mbretër, as për princër, që do t'i pinin gjakun popullit. Shqipëria, shkruante Samiu në fillim të vitit 1881, do të qeverisej prej një lloj demokracie, formën e së cilës nuk do ta merrte hua nga vendet e tjera, por do ta gjente në vetë popullin shqiptar, në traditat e tij. Këto ide mbi organizimin e ardhshëm të shtetit shqiptar Samiu i zhvilloi më tej në veprën e tij të famshme «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bënëtë», e cila më vonë u bë platformë e plotë programatike për të gjithë lëvizjen kombëtare.

* * *

Lufta për ruajtjen e tërësisë territoriale të Atdheut përbën një nga anët më të ndritura të veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Përballë rrezikut të madh që e kërçenonte Shqipërinë, kur edhe Porta e Lartë kapitulloi përpara Fuqive të Mëdha dhe po i shtrëngonte shqiptarët t'u dorëzonin shteteve fqinj vise amtare, në kundërshtim me të gjithë e kundër të gjithëve, Lidhja mori më duart e veta mbrojtjen e vendit. Ajo kundërshtoi me rrugë diplomatike dhe me armë vendimet e padrejtë të Kongresit të Berlinit, i denoncoi këto vendime si «një krim historik e moral» dhe shprehu vendosmërinë «për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë tokë nga trualli amtar», për të luftuar deri në pikën e fundit të gjakut për mbrojtjen e tij. «Çdo ndryshim kufiri që bëhet pa ne..., — deklaroi Lidhja, — do të ishte i pavlefshëm, dhe pa pjesëmarrjen e kryetarëve... të Shqipërisë, ne nuk do të pranonim lëshimin as edhe të një pëllëmbe të territorit tonë». Dhe kur fuqitë e mëdha të Evropës nuk e dëgjuan këtë paralajmërim solemn, Abdyl Frashëri iu drejtua atyre me fjalët që kamë mbetur historike: «Puna juaj me Traktatin e Berlinit mbaron, puna jonë si shqiptarë nga kjo ditë fillon».

Faqë të lavdishme heroizmi shkroi populli shqiptar, i udhëhequr nga Lidhja, në luftën për mbrojtjen e Plavës e të Gucisë, Hotit, Grudës e Ulqinit, këtyre viseve shqiptare, me të cilat Fuqitë e Mëdha kërkonin të kënaqnin lakmitë e Knjaz Nikollës të Malit të Zi. Kjo ishte një luftë që bëhej për mbrojtjen e interesave të të gjithë kombit shqiptar e të tërësisë së trojeve të tij, një luftë që i tregonte botës se shqiptari nuk përulet kurrë përpara synimeve ekspansioniste të kujtdo qoftë.

«Të paharruara, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — do të mbeten betejat legjendare të shqiptarëve që për tre vjet me radhë mbrojtën me gjoks Plavën e Gucinë, Hotin, Grudën e Ulqinin, duke u bërë kështu një sfidë të pashëmbullt fuqive perëndimore, që kishin vendosur t'ia shkëpusnin ato Shqipërisë». (E. Hoxha, Vepra, vell. 24. f. 11).

Lufta për Plavën, Gucinë, Hotin, Grudën dhe Ulqinin ngriti më këmbë gjithë Shqipërinë. Pas malësorëve të Veriut dhe mijra vullnetarëve nga viset e tjera që u vajtën atyre për ndihmë, qëndronte një popull i tërë. Një kontribut të vëçantë në këtë luftë dha populli i Kosovës, i cili, që në kushtrimin e parë, nën udhëheqjen e Lidhjes, vrapi po drejt llogoreve për të mbrojtur kufijtë e Veriut. Forca e bashkuar e popullit shqiptar bëri që të thyhen e të dështojnë sulmet e njëpasnjëshme të Malit të Zi, ajo i detyroi Fuqitë e Mëdha të ndryshojnë disa herë vendimet e tyre të padrejta.

Për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Atdheut, popullit shqiptar iu desh të luftonte i vetëm dhe të përballonte edhe flotën e bashkuar të Fuqive të Mëdha të Evropës, që bllokoi bregdetin shqiptar dhe mori përsipër të realizonte me dhunë vendimet grabitqare të Kongresit të Berlinit. Atij iu desh të luftonte me ushtritë osmane të Dervish Pashës, me forcat e Malit të Zi dhe me presionet e vazhdueshme politike dhe ushtarake të monarkive serbe e greke. Me armë dhe me gjakun e tij populli shqiptar nuik lejoi t'i shkëputen Plava e Gucia, Hoti, Gruda dhe Çamëria, por humbi një pjesë të viseve verilindore të Kosovës që mbetën nën sundimin serb dhe qytetet e Tivarit e Ulqinit që u aneksuan nga Mali i Zi.

Një rezistencë të pashoqe dhe një trimëri të rrallë tregoi ushtria vullnetare, e udhëhequr nga luftëtar i paepur Sulejman Vokshi, në luftën kundër ushtrive të shumta që dërgoi Turqia në Shqipëri për të shkatërruar Lidhjen. Dhunës së Portës së Lartë, që kërkonte t'i detyronte shqiptaret të hijnqin dorë nga qëndresa e armatosur për mbrojtjen e tërësisë së Atdheut dhe për sigurimin e autonomisë, Lidhja iu përgjegj me kryengritjen e armatosur. Lufta popullore kundër ushtrive të shumta të mareshalit turk Dervish Pasha, që u zhvillua me një forcë të vëçantë në Kosovë, në Dibër, etj. ku u çliruan njëri pas tjetrit qytetet kryesore, treguan vullnetin e paepur të popullit shqiptar për të mbrojtur të drejtën e tij që të ekzistojë si komb, treguan dashurinë e tij të pafund për liri e pavarësi.

Betejat e përgjykshme të vëllezërve tanë të Kosovës në

pranverën e vitit 1881 ia rritën edhe më shumë lavdinë kombit shqiptar. Përballë 40 batalioneve turke qëndruan 7000 kryengritës shqiptarë të udhëhequr nga trimat e shquar Sulejman Vokshi, Ali Ibra, Mic Sokoli, Bajram Rama, Sefë Kosharja, Smail Hyseni etj. Të panumërtë janë betejat që zhvilluan vullnetarët kundër hordhive otomane, si beteja e Slivovës, e Shtimjes, e Caralevës, e Dulës, e Suharekës, e Plavës, e Gucisë etj. Lumë u derdh gjaku shqiptar për të mbrojtur tokën e të parëve, lirinë dhe nderin e Atdheut.

Ushtritë e mëdha turke e shtypën kryengritjen shqiptare, e shkatërruan Lidhjen, e shkretuan dhe e mbytën në gjak vendin. Por ato nuk mundën të mposhtin shpirtin kryengritës dhe frymën liridashëse të popullit shqiptar. Këtë vendosmëri e besim në të ardhmen i shpreh bukur kënga e popullit e ngritur në ato kohë të vështira në Kosovë, që thotë: «Dervish Pasha po pëvet: /— Zot, mileti ka u tret?/ — Qatje nelt ku zbardhin retë, /koftë kysmet do t'i shohsh opet.».

* * *

Krijimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe lufta e saj për autonomi e mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut kundër koalicionit më të madh të armiqve që mund të krijohej në atë kohë, nxorrën edhe një herë në pah të vërtetën e mëdha se populli shqiptar e ka bërë vetë historinë e tij. Përballë popullit tonë të vogël qëndronin forca të mëdha, Perandoria Otomane, fuqitë e mëdha të Evropës dhe monarkitë shoviniste fqinje. Alternativat ishin: ose Shqipëria të shtypej nën «gërmadhat e rënda» të Turqisë, ose të copëtohej nga shovinistët fqinj, ose të ngrihej në këmbë dhe të luftonte me besim në forcat e veta për të shpëtuar nga armiqtë dhe rreziqet e mëdha që i kanoseshin. «Të shpëtuarit a të humburit e Shqipërisë, — shkruante në këtë kohë Sami Frashëri, — është në dorën e shqiptarëve». (Sami Frashëri, «Shqipëria ç'ka që-në, c'është e ç'do të bënëtë?», Tiranë, 1962, f. 65). Dhe shqiptarët zgjodhën rrugën e nderit e të lavdisë. Populli u ngrit në këmbë dhe luftoi deri në fund për të drejtat e tij.

Lidhja e Prizrenit dhe udhëheqësit e saj kishin besim të patundur në forcën e popullit, në dashurinë e tij të zjarrtë për Atdheun e lirinë, në vendosmërinë e tij për t'u qëndruar talla-

zeve të historisë. Përvoja e luftërave për liri i bindte ata se e vjetmja rrugë për të siguruar autonominë dhe tërësinë tokësore të vendit ishte mbështetja në forcat e popullit.

Lidhja e Prizrenit dhe ngjarjet e periudhës 1878-1881 e bënnë të mundur që të kuptoheshin më mirë rreziqet që i kanoseshin vendit tonë dhe të zbulohet politika antishqiptare e fuqive të mëdha evropiane dhe e shteteve shoviniste të Ballkanit. Përfundimet e hidhura që sollën kombinacionet politike, diplomatike e ushtarake të këtyre fuqive shpërndanë iluzionet e lëkundjet dhe vërtetuan se sigurimi i lirisë e i pavarësisë mund të arrihej nga vetë populli shqiptar.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit përfaqëson një nga pikat më të larta të Rilindjes, të cilën shoku Enver e ka cilësuar «një epokë revolucionare-demokratike me shumë rëndësi». (E. Hoxha, Raporte e Fjalime, 1967-1968, f. 368). Ajo i dha luf-tës për tërësinë territoriale dhe autonominë një përmbytje patriotike e demokratike të përparuar. Vetë kërkesa për zhdukjen e zgjedhës turke dhe për formimin e shtetit të pavarur kombëtar ishte një masë e rëndësishme demokratike, sepse, siç thekson V.I. Lenini, në çdo luftë kombëtare «të një kombi të shtypur ka një përbajtje demokratike të përgjith-shme, të drejtuar kundër shtypjes...». (V.I. Lenin, Vepra, vell. 20, f. 471).

Masat popullore dhe përfaqësuesit e tyre në komitetet e Lidhjes përbënin forcën më të vendosur që i shtynte Lidhjen dhe udhëheqësit e saj më konsekuentë të ndërmerrnin veprime radikale, politike dhe ushtarake, për mbrojtjen e të-rësisë së Atdheut dhe për autonominë e Shqipërisë, të paralizo-nin lëkundjet dhe tradhtinë e elementeve çifligarë e klerikalë turkomanë. Qysh në fillim, qysh në Kuvendin e parë të Lidhjes, bënin pjesë shumë njerëz të thjeshtë të popullit, për të cilët Pashko Vasa shkruante: «Këta përfaqësues nuk ishin as krerë, nuk ishin gjithashtu as njerëz me influencë. Ata kanë folur në emër të popullit shqiptar sepse ishin edhe vetë ata populli, ...ata u kthyen në gjirin e popullit nga kishin dalë, edhe sot, po t'i kérkoje, nuk do t'i gjeje dot, ata janë të pakap-shëm, të padukshëm», (Akte të Rilindjes Kombëtare Shqip-tare 1878-1912. Memorandumi i 22 tetorit. Dokumenti 32, f. 67).

Veprimitaria politike, ideologjike dhe ushtarake e Lidhjes zgjoi dhe kaliti ndërgjegjen politike të mijëra e mijëra shqip-tarëve, katundarë, malësorë e qytetarë, të cilët për tre vjet me radhë luftuan me guxim e vendosmëri kundër armiqve të shumtë e të fuqishëm.

Por krahas kësaj, — dhe qka është më e rëndësishme, — Lidhja realizoi në shkallë kombëtare bashkimin e popullit shqiptar, zbuloi forcën e këtij bashkimi. Ajo bëri një luftë të vendosur për kapërcimin e ndasive fetare, partikularitetet e krahinore e fisnore dhe bëri përpjekje të mëdha për të bashkuar të gjitha masat rrëth idealit kombëtar. Që në fillimet e veta, çështjen e unitetit kombëtar ajo e trajtoi si bazën e vetme e themelore të realizimit të programit të saj dhe si kusht për mbrojtjen e Atdheut e fitoren mbi armiqët. Pikërisht pse ideja e unitetit u përgjigjej interesave më të larta të Atdheut dhe përfaqësonte aspiratat e masave më të gjëra, pse përfaqësonte armën më të fuqishme e më të sigurtë që populli shqiptar mund t'u kundërvinte armiqve, shpërthyen ato akte të mëdha solidariteti dhe ai heroizëm masiv që deri atëherë nuk kishte njojur Shqipëria.

Ky bashkim kombëtar e tregoi forcën e vet në momentet më të vështira, gjatë viteve 1878-1881, në luftën për mbrojtjen e kufijve të Veriut e të Jugut, kur në të njëjtën kohë niseshin nga qendrat e Shqipërisë së Veriut e të Jugut protestat që u dërgoheshin Fuqive të Mëdha, kur në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut mblidheshin ndihma e vuillnetarë që dërgoheshin në Veri, kur popullsia e Kosovës dhe e Shkodrës u tregua e gatshme të dërgonte forca vullnetare për mbrojtjen e kufijve të Jugut.

Forcimit të unitetit kombëtar i shërbeu vetë organizimi i shëndoshë i Lidhjes, e cila bashkoi në gjirin e saj gegë e toskë, myslimanë e të krishterë. Nëpërmjet një rrjeti të dendur komitetesh e degësh, Komiteti Qendror në Prizren lidhej me të gjitha krahinat dhe udhëhiqte drejtëpërdrejt masat populllore që ishin ngritur në këmbë përpara rrezikut të copëtimit të Atdheut. Vatra të fuqishme e ndër qendrat kryesore të Lidhjes Shqiptare ishin sidomos ato krahina që ishin bërë objekt i planeve ekspansioniste të monarkive shoviniste ballkanike — Kosova, Dibra, Shkodra me malësitë e Veriut, Gjirokastra etj. Lidhja krijoj kështu një front të gjerrë të forcave patriotike të kombit, një bashkim që la gjurmë të pashlyeshme në mendimin politik dhe në veprimtarinë praktike të lëvizjes kombëtare gjatë gjithë periudhës së mëvonshme.

*
* *

Fryma patriotike dhe demokratike e lëvizjes kombëtare shqiptare të periudhës së Lidhjes së Prizrenit u ndie me forcë të veçantë edhe në literaturën artistike dhe publicistike të kohës, që morën një hov të ri nga zjarri i luftës për liri. Formimi i Shoqërisë së Shkronjëzave në Stamboll më 1879, hartimi i alfabetit të gjuhës shqipe dhe botimi i teksteve shkollore i dhanë një shtytje të madhe përhapjes së mësimit të gjuhës shqipe dhe ndihmuani «punën e Lidhjes... punën e vëllazërisë së shqiptarëve dhe të bashkimit e të ngjalljes së Shqipërisë», siç thoshte Sami Frashëri.

Krijimtaria letrare e publicistike e burrave të shquar të penës, e patriotëve të mëdhenj Sami Frashëri, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Jani Vreto, Thimi Mitko, Jeronim De Rada, Koto Hoxhi etj., ka pasur po atë rëndësi dhe ka qenë po aq e vlefshme sa edhe lufta me pushkë. Me veprën e tyre të pavardekshme në shërbim të Atdheut ata kanë merituar vlerësimin e madh që u kanë bërë Partia dhe shoku Enver si «njerez të shquar, me ide përparimtare, iluministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdhedashuri të madhe e të zjarrtë». (E. Hoxha, Raporte e fjalime, 1967-68, f. 369).

Lidhja e Prizrenit shënon një etapë të re në zhvillimin e kulturës kombëtare demokratike. Ajo ndikoi drejtëpërdrejt që të zgjidheshin një varg çështjesh imperitative që kishin të bënин me zhvillimin e kësaj kulture, si ato për caktimin e një alfabeti unik, për zhvillimin e arsimit kombëtar, për zgjerimin e botimeve të ndryshme letrare, publicistike, politike, arsimore etj. Hovi që mori në këtë periudhë shkrimi shqip, letërsia artistike e politike, gazetaria e përkthimet dëshmojnë përrëndësinë tepër të madhe që kishte faktori kulturor krahas atij politik, diplomatik e ushtarak.

Por Lidhja u dha një impuls të ri zhvillimit të letërsisë kombëtare e mendimit politik shoqëror dhe hodhi baza të shëndosha edhe për perspektivën. Qysh në ditët kur zhvilloheshin betejat luftarake të Lidhjes, problemi i gjuhës shqipe u shtrua dhe u konsiderua si një strumbullar i lëvizjes kombëtare, si një faktor që qimentonte unitetin e jetës shpirtërore të kombit, si një shprehje e originalitetit të kulturës kombëtare dhe si armë e luftës për liri e pavarësi.

Rritja e interesimit për vlerat e mrekullueshme të kulturës populllore, veçanërisht të folklorit, njojja më mirë e

traditave të lashta dhe e historisë së popullit, lulëzimi i letërsisë artistike dhe shpërthimi i bujshëm i krijimtarisë gjore, të frymëzuara nga idealet e patriotizmit e të lirisë, dëshmojnë për influencën e madhe që ushtruan idetë e veprimtaria e Lidhjes për përparimin e kulturës kombëtare.

Ideologët e Lidhjes dhe të mbarë Rilindjes luftën për karakterin kombëtar e demokratik të kulturës e shikonin si një faktor me rëndësi për të fituar lirinë e pavarësinë, për të ruajtur e konsoliduar individualitetin e jetës kombëtare shqiptare, për të rritur e forcuar ndërgjegjen kombëtare të popullit.

Një meritë e madhe e Lidhjes së Prizrenit dhe e gjithë rilindasve tamë ishte përballimi dhe zgjidhja në favor të çështjes kombëtare të problemeve që nxirrte feja në Shqipëri. Përvoja vërtetonte dëmin e madh që i kishin sjellë dhe i sillnin vendit fanatizmi dhe përçarja fetare, të cilat shfrytëzoheshin nga të huajt për të penguar zhvillimin e lëvizjes për çlirimin kombëtar. Ndryshe nga ndonjë vend tjetër ballkanik, në Shqipëri asnjëra nga fetë, as të trija së bashku, nuk mund t'i shërbenin çështjes së çlirimt dhe të shndërrroheshin në një flamur të saj.

Duke u ngritur mbi fetë, mbi ndasitë e fanatizmin fetar, gjë që nuک ishte aspak e lehtë për kohën që flasim, ideologët e Lidhjes dhe të Rilindjes hodhën parullën militante se feja e shqiptarit është shqiptaria. Ky qëndrim shumë i drejtë e shumë përparimtar forcoi bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia fetare, në luftën për liri e pavarësi.

Ideologjia dhe mendimi politik i Rilindjes, i mbrujtur edhe me përvojën e betejave ushtarake, politike e diplomatike të Lidhjes, i ndriçoi perspektivën dhe objektivat lëvizjes sonë për çlirim kombëtar deri në fitoren e pavarësisë.

Megjithëse Lidhja Shqiptare, e themeluar në Prizren pati një jetë të shkurtër, epopeja e madhe që shkroi ajo i dha një shtytje të re të mëtejshme lëvizjes kombëtare të popullit tonë. Rëndësia e saj nuک matet me kohën që jetoi, por me influencën e madhe që ushtroi në luftërat e mëvonshme për liri. Në momentet kyçe, kur u ndesh përsëri në qëndrimin armiqësor të Fuqive të Mëdha dhe të qarqeve shoviniste fqinje, populli shqiptar u mbështet më idetë patriotike të Lidhjes Shqiptare, në përvojën e saj politike, organizative dhe ushtarake. Platforma e saj, e përpunuar në zjarrin e luftës çlirimtare, që parashikonte ruajtjen e tërësisë territoriale dhe

formimin e shtetit të pavarur shqiptar, mbeti si bazë e programit të lëvizjes kombëtare shqiptare gjatë gjithë periudhës deri më 28 nëntor 1912.

Kuvendi Kombëtar i Vlorës, i kryesuar nga patrioti i madh Ismail Qemali, me Shpalljen e Pavarësisë dhe formimin e shtetit të pavarur më 28 nëntor 1912, ku është edhe kontributi i madh i Lidhjes së Prizrenit, realizoi një kërkesë themelore të saj. Por në kushtet ndërkombe të tepër të ndërlikuara, kur kishte shpërthyer Lufta Balkanike dhe trojet shqiptare ishin bërë përsëri objekt i lakmive grabitqare dhe i veprimeve pushtuese të monarkive fqinje, mbeti pa u zgjidhur detyra tjetër themelore e Lidhjes, ruajtja e tëresisë territoriale të Atdheut, trualli i të cilit u cungua rëndë.

Koha e ka vënë Lidhjen e Prizrenit në piedestalin e historisë së lavdishme të popullit shqiptar. Fryma e lartë patriotike, urrejtja kundër shtypjes, dashuria e pafund për lirinë, qëndresa e papërkulur përpara çdo presioni e ndërhyrjeje të huaj, vullneti për dije e përparim, besimi i patundur në forcat e veta, që u shfaqën aq madhërisht në vitet kur zhvilloi aktivitetin e saj Lidhja e Prizrenit, u mishëruan dhe u bënë pjesë e pandarë e karakterit të popullit tonë. Këto tipare të shquara u pasuruan në përbajtje dhe u ngritën më lart në epokën heroike të Luftës Nacionaçlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit, kur vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, u bë me të vërtetë i lirë e i pavarur, kur Atdheu ynë socialist u bë i fortë e i begatë.

Shokë dhe shoqe,

E kaluara heroike e popullit tonë, luftërat e tij për liri e pavarësi janë një burim i madh frymëzimi edhe për të sotmen, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e Atdheut.

Përpara popullit tonë qëndrojnë detyra të mëdha, realizimi i të cilave do ta fuqizojë e lulëzojë edhe më tepër vendin, do ta pasurojë edhe më shumë jetën materiale e shpirtërore të njerëzve tanë. Partia kërkon nga të gjithë, nga punëtorët, kooperativistët dhe inteligjencia, të punojnë me të gjitha forcat e me një frymë të lartë patriotike e shpirt revolucionar për të rritur vazhdimeshit prodhimin industrial e bujqësor, për të çuar përpara revolucionin tekniko-shkencor, për të zhvilluar më tej kulturën socialiste, për të rritur vigjilencën dhe forcuar mbrojtjen e Atdheut.

Vendi ynë punon e jeton në një botë ku forca të egra përpiken me të gjitha mënyrat të pengojnë ecjen përpara të tij.

Në këto kushte kushtimi dhe zbatimi sa më i thellë i parimit të madh revolucionar të mbështetjes në forcat e veta është një garanci për të përballuar të gjitha rreziqet dhe për të çuar përpara ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Duke u mbështetur në forcat e veta, të parët tanë u bënë ballë vështirësive dhe armiqve të shumtë e të ndryshëm. Në kohën e sotme forcat materiale e shpirtërore të popullit shqiptar janë të pakrahasueshme me të kaluarën. Ai tani është zot i fateve të tij, udhëhiqet nga një parti heroike marksiste-leniniste, e sprovuar dhe e kalitur në betejat e mëdha klasore kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, ka një ekonomi të zhvilluar socialiste, një mbrojtje kombëtare të pathyeshme. Këtë kështjellë të socializmit, që është bërë e dashur për të gjithë patriotët shqiptarë kudo që jetojnë nëpër botë dhe që gjëzon përkrahje e simpati në popujt e revolucionarët e të gjitha vendeve, nuk ka furtunë që ta tronditë.

Në luftën e gjatë e të vështirë të popullit tonë për lirinë kombëtare dhe krijimin e shtetit të pavarur një rol vendimtar ka lojtur bashkimi i popullit për realizimin e idealeve të tij. Fryma e unitetit dhe e patriotizmit, që është ruajtur kurdoherë e gjallë në popullin tonë, mori një përbajtje të re dhe u ngrit në një shkallë më të lartë në vitet e Luftës Nacionaçlirimitare, e veçanërisht në periudhën e ndërtimit të socializmit. Ajo ka qenë një nga faktorët themelorë në fitoret që ka arritur vendi ynë në mbrojtjen e Atdheut e ndërtimin e jetës së re, në përballimin e bllokadave e të shantzhevë të njëpasnjëshme që kanë bërë armiqtë kundër vendit tonë.

Në kushtet e rrëthimit imperialisto-revisionist e të presioneve të ndryshme që armiq të vjetër e të rinj ushtrojnë ndaj Shqipërisë socialiste, forcimi i kompaktësisë dhe i unitetit të popullit rrëth Partisë është një detyrë tepër e rendësishme për çdo qytetar e patriot. Uniteti i çeliktë është garanci për mbrojtjen e Atdheut dhe të fitoreve të revolucionit, për të ecur kurdoherë të sigurtë e ballëlartë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste në të cilën na udhëheq Partia.

Duke festuar 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, duke nderuar përpjekjet heroike të të parëve tanë, kontributin e tyre të madh në luftërat për lirinë e pavarësinë e Atdheut, ne i kuptojmë edhe më mirë rreziqet që vijnë aktuasilist nga politika agresive e shoviniste e superfuqive, nga komplottet e manovrat e rrezikshme të borgjezisë e të reaksionit.

Gjendja ndërkombëtare sot është e komplikuar dhe e turbullt. Ajo mbart me vete plot kërcënime e të papritura. Në shumë vende e rajone të botës janë krijuar vatra tensioni dhe janë shkaktuar konflikte të reja. Këto zjarre i kanë ndezur dhe u fryjnë imperialistët amerikanë e socialimperialistët sovjetikë, të cilët nuk ndalen përpara asnjë krimi për të kënaqur interesat e tyre egoiste dhe ekspansioniste.

Në Lindjen e Mesme të dy superfuqitë, në garë njëra me tjetrën, po ndërhyjnë brutalisht pér të përçarë popujt arabë e pér të sabotuar luftën e tyre çlirimtare, pér të mbytur çështjen e drejtë të popullit palestinez dhe pér të përjetësuar pushtimin e tokave arabe nga Izraeli, pér ta vënë këtë rajon strategjik e të begatshëm nën sundimin e tyre imperialist.

Me një tërbim të pashoq janë hedhur imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe aleatët e tyre neokolonialistë pér të shtrirë thonjtë e tyre grabitqarë në Afrikë. Është kjo politikë e veprimtari e këtyre ujqve të pangopur që bën të derdhet gjaku i popujve të këtij kontinenti të shumëvuajtur në Bririn e Afrikës, në Angola, në Zaire e Sahara, është kjo politikë që i nxit racistët e Afrikës së Jugut të shtypin e të masakrojnë aksoma popujt e Azanisë, Namibisë e Zimbabves.

Rezultat i politikës së superfuqive imperialiste dhe i komploteve e intrigave të tyre është konflikti vëllavrasës midis Vietnamit e Kamboxhias, grushtet e shtetit reaktionare që ndodhin njëri pas tjetrit në mjaft vende të Amerikës Latine, Azisë apo Afrikës, shtimi i bazave ushtarake në vendet e huaja, gara e papërmëbajtur e armatimeve etj.

Vargu i krimeve të superfuqive nuک ka fund. Ndërhyrja e tyre në punët e brendshme të popujve bëhet hapur dhe me një arrogancë të pashoqe, përpjekjet pér të ushtruar diktat në punët botërore e pér të kufizuar sovranitetin shtetëror të kombeve kanë marrë proporcione të përbindshme. Retë që qëndrojnë sot mbi qiellin e jetës ndërkombëtare janë të mbarsura me rrezikun e luftës, të cilën e duan, e përgatitin dhe e nxitin imperialistët amerikanë, socialimperialistët sovjetikë, borgjezia ndërkombëtare dhe gjithë reaksioni i bashkuar me ta.

Prandaj Partia na mëson që të jemi kurdoherë vigjilentë. Armiqtë e popujve e të socializmit janë të egër e të pabesë, qofshin këta imperialistë amerikanë ose socialimperialistë sovjetikë, qofshin reaksionarë të ndryshëm, borgjezë ose revisionistë.

Për të mashtruar e çoroditur popujt, për t'i hapur rrugë ekspansionit imperialist, nga shumë anë bëhen përpjekje që e zeza të paraqitet e bardhë, që armiku të paraqitet mik. Njihet demagogjia e imperialistëve amerikanë dhe e socialimperialistëve sovjetikë për t'i shitur veprimet e tyre agresive e ndërhyrjet brutale në jetën e popujve si kujdes për paqen e sigurinë e kombeve.

Por tani popujt po ndeshen edhe me një propagandë tjeter, sa demagogjike aq edhe të shfrenuar, po ndeshen me teza e teori kundërrevolucionare, që luajnë rolin e opiumit pér vënien në gjumë të frymës revolucionare të popujve. E tillë është edhe e ashtuquajtura teori e «tri botëve». Kjo teori kërkon të zëvendësojë marksizëm-leninizmin me oportunizmin. Ajo predikon që proletarët e popujt të bashkohen me borgjzinë e imperializmin, të bashkohen me reaksionin klasik e fashistët e njohur, të bashkohen edhe me djallin pér mbrojtjen gjoja të pavarësisë kombëtare. Duke u fshehur prapa kërcenimit të hegemonizmit të socialimperializmit sovjetik, që është një kërcënim i egër dhe i vazhdueshëm, teoria e «tri botëve» u kërkon popujve që të mos lëvizin, të mos luftojnë kundër sundimit amerikan dhe shtypjes e shfrytëzimit të kolonialistëve të vjetër, por të ruajnë statukuonë, gjendjen e mjeruar ekzistuese. Ruajtja e statukuosë u intereson imperialistëve të ndryshëm, ajo është në dëm të revolucionit e të luftës clirimtare të popujve.

Teoria e «tri botëve», që pretendon të jetë edhe strategji e revolucionit, në të vërtetë është një teori antimarksiste e kundërrevolucionare. Punëtorëve, proletariatit të vendeve të ndryshme dhe masave punonjëse ajo u predikon të heqin dorë nga revolucioni, sepse, sipas saj, akoma nuk ka ardhur koha pér revolucion. Ajo mohon rolin hegemon të proletariatit në revolucion. Në kundërshtim me kriteret klasore marksiste-leininiste, ajo i konsideron si aleatë të saj edhe forcat e djathta e reaksionim më të zi, bile e quan fitore kur në vende të ndryshme në fuqi vijnë përfaqësuesit e së djathtës, qofshin ata edhe më ekstremistët.

Teoria e «tri botëve» është një teori antipopullore. Në kundërshtim me interesat jetike të popujve, në kundërshtim me Leninin, i cili nxitjen e luftës e ka quajtur krim, sepse luftët e paguajnë popujt me gjakun e tyre, në vend që të bëjë përpjekje pér shkatërrimin e planeve imperialiste të luftës, pseudoteoria e «tri botëve» nxit luftën botërore, ajo ndez edhe më tepër garën e armatimeve midis dy superfuqive,

sikur nga kjo garë, nga prodhimi i bombave me neutron dhe nga rritja e buxheteve të blloqeve ushtarake do t'i vinte botës shpëtimi!

Teoria e «tri botëve» u këshillon popujve që të mbësh-teten tek imperializmi amerikan, pikëpamjet e të cilat ajo i shpall «të përbashkëta ose të njëjtë» me predikimet e saj. Se cilat janë pikëpamjet e imperializmit amerikan popujt i dinë mirë. Imperialistët amerikanë janë antikomunistë të tërbuar, mbrojtësit e sistemit kapitalist e neokolonialist, xhandarë të reaksionit ndërkombetar. Ata kanë luftuar e luftojnë me të gjitha forcat që kanë për të shkatërruar socializmin, për të mbytur revolucionin, për të skillavëruar popujt. Popujt, njerëzit e thjeshtë kudo në botë, nuk mund të mos pyesin: Me këto pikëpamje e me këtë strategji të imperializmit amerikan bashkohet teoria e «tri botëve»?

Kjo teori hiqet si kampione e mbrojtjes së pavarësisë e të sovranitetit kombëtar të popujve, por praktikisht, ajo bash-kohet me armiqtë e popujve. Luftën për liri, pavarësi e sovranitet kombëtar të popujve të së ashtuquajturës «botë e tretë» ajo nuk e shikon si pjesë përbërëse e të pandarë të revolucionit, por si një fushë që mund të shfrytëzohet për qëllime pragmatiste e koniunkturale. Ky qëndrim nuk është në favor të sovranitetit e të luftës çlirimtare të popujve, ai i shërbën rujtjes së të gjitha padrejtësive imperialiste që rëndojnë mbi ta. Me predikimet e saj oportuniste e antimarksiste për bashkim me imperializmin amerikan, me borgjezinë e madhe ndër-kombëtare e klikat reaksionare, në emër gjoja të krijimit të një fronti unik, sa absurd aq edhe te parealizueshëm, teoria e «tri botëve» minon jo vetëm revolucionin, të cilin e mohon, por edhe çështjen e pavarësisë së popujve, të cilën pretendon se e mbron. Kur në këtë front rekomandohet të bëjnë pjesë Pentagoni e NATO-ja, Uoll-Striti e sheikët e vajgurit, gjeneralët e Vermahtit e samurajët japonezë, Shtrausi e Mobutu, popujt nuk e kanë vështirë të dallojnë në të frontin antikomunist e kolonialist, kundër të cilat me dhjetëra vjet kanë luftuar e derdhur gjak breza të tërë revolucionarësh e patriotësh në të gjitha vendet.

Teoria e «tri botëve», që hiqet si antirevizioniste, në qëndrimin ndaj klikave reaksionare e forcave të djathta, është në një vijë me Kariljom, që kur diskutohet në parlamentin spanjoll për një kushtetutë të re, kërkon të mbrohet monarkia dhe të hidhet poshtë kërkesa për vendosjen e republikës. Ajo është në një vijë me revisionistët italianë të Berlinguerit, që

janë mbrojtësit më të zjarrtë të rendit borgjez dhe të aparatit të tij shtypës policor. Me këta revizionistë pseudoteoria e «tri botëve» është në paqe. Në këtë rrugë ndonjë ditë, ajo mund të afrohet e të puqet edhe me revizionizmin sovjetik. Historia ka provuar se kush ndjeq një politikë antimarksiste, pragmatiste e koniunkturale, nuk vonon të quajë mik atë që deri dje e mallëkonte, si armik, siç ka vepruar Nikita Hrushovi.

Partia jonë ka luftuar e do të luftojë për të demaskuar si politikën agresive e demagogjinë «paqedashëse» të imperialistëve amerikanë e të socialimperialistëve sovjetikë, ashtu edhe teoritë false që minojnë çështjen e revolucionit e të gjirimit të popujve, siç është teoria e «tri botëve». Përsa u përket teorizimeve mbi «botën e paangazhuar», ato janë një gjenieshtër e falsitet, që nuk meritojnë asnjë vëmendje, sepse po hidhen poshtë përditë nga ngjarjet që ndodhin në botë.

Liria e pavarësia, socializmi e revolucioni mund të mbrohen e të çohen përpara me sukses vetëm duke luftuar me guxim e vendosmëri kundër të gjithë armiqve të proletariatit e të popujve kundër imperialistëve qofshin këta amerikanë ose sovjetikë, imperialistë të rinj ose të vjetër, kundër revizionistëve të të gjitha ngjyrave e reaksionarëve të të gjitha vendeve, kundër të gjithë atyre që ua kanë me hile popujve dhe proletariatit.

Partia jonë, siç e theksoi me forcë edhe në Kongresin e 7-të të Partisë shoku Enver Hoxha, është solidare dhe i jep përkrahjen e singertë e pa rezerva luftës që popujt e ndryshém zhvillojnë sot për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së tyre nga synimet agresive të imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e imperializmave të tjera, gjithë atyre që luftojnë kundër racizmit, kolonializmit, neokolonializmit dhe formave të tjera të skallavërimit kombëtar. Populli shqiptar ka dënuar dhe dënon me forcë qđo ndërhyrje të huaj në jetën e brendshme të popujve, qđo përpjekje të forcave imperialiste, revizioniste e reaksionare që kufizon sovranitetin dhe pengon emancipimin e kombeve.

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë socialist është përmarrëdhënie normale e miqësi me të gjitha ato vende e shtete që respektojnë parimet e sovranitetit e të mosndërhyrjes në punët e brendshme të të tjereve. Veçanërisht me vendet fqinje dëshirojmë të kemi kurdoherë marrëdhënie të fqinjës së mirë, miqësi e shkëmbime në fushën e tregtisë e të kulturës, duke mos cënuar të drejtat sovrane të njëri-tjetrit.

Të parët tanë, njëqind vjet më parë, me Lidhjen Shqiptare në Prizren, sfiduan armiqtë e bashkuar të kombit shqiptar. Kjo sfidë ishte një shprehje e vendosmërisë, e trimërisë dhe e guximit të popullit shqiptar për të luftuar në çdo rrethanë, qoftë edhe kundër të gjithëve, për të drejtat e tij, për lirinë, për pavarësinë, për bashkimin kombëtar. Sot Shqipëria e lirë dhe e pavarur, që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, heroike, largpamëse, që ka në krye birin e shtrenjtë e të dashur të mbarë popullit shqiptar, shokun Enver Hoxha, marshon e sigurtë në rrugën e socializmit, qëndron me ballim lart dhe e patundur përpëra armiqve të vendit tonë, të revolucionit e të marksizëm-leninizmit. Ajo qëndron e tillë sepse e frymëzon besimi i pakufishëm në forcat e veta, në forcën e popujve, në forcën e marksizëm-leninizmit fitimtar, në triumfin e revolucionit e në të ardhmen e socializmit. Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës nuk kanë kërcënuar kurrë ndokënd, por edhe frikën nuk ia kanë kërkujt. Popullin e Partinë tonë nuk ka e nuk do të ketë asnjë forcë në botë, asnjë kërcënim, asnjë shantazh, asnjë bllokadë e presion që ta zembrapsë nga rruga që ka zgjedhur, që ta largoje nga lufta për çështjen e madhe të komunizmit.

Rroftë 100-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit!

Rroftë populli shqiptar, liridashës, trim e patriot!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë me shokun Enver Hoxha
në krye!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Marrë nga gaz. «Zëri i popullit», Nr. 139 (9312)
e diel, 11 qershori 1978.*

ALEKS BUDA

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE RRËNJËT E SAJ HISTORIKE

Në jetën e popujve, në rrjedhën e viteve dhe shekujve, ka ngjarje që për domethënien e tyre, qëndrojnë si udhërrëfyes në udhëkryqet e mëdha të historisë. Ato i venë popujt përpara pyetjes: Nga duhet të shkojmë? Në shumësinë e rrugëve që ndeshen, ka të tilla që, të lehta në dukje, janë rrugë të mbyllura, pa krye e mbarojnë në greminë; të tjera, që duhen çarë me luftë e vështirësi, janë ato që çojnë më në fund drejt horizonteve të hapura.

Kësaj pyetjeje në një udhëkryq të madh të historisë i dha populli shqiptar një përgjigje që ze një vend nderi në histori: me themelimin e Lidhjes Shqiptare në Prizren më 10 qershor 1878, përfaqësuesit e kombit, të mbledhur në këtë qytet të lashtë shqiptar të Kosovës, shpallën vendosmérinë e tyre të patundur për të luftuar për të drejtat e veta kombëtare dhe i vunë themellet asaj organizate politike, e cila për 3 vjet me radhë udhëhoqi luftën e masave popullore për çlirim nga zgjedha shekullore e huaj, përmbrojtjen e trojeve të veta, përbashkimin në një shtet të vetëm autonom e të njësuar kombëtar.

Lidhja dhe lufta e masave popullore që ajo udhëhoqi, përbën një nga ato ngjarje, për të cilën mund të thuhej, se pa të, rrjedha e historisë mund të kishte qenë detyruar të merrte tjetër rrugë e të qëbente çka kishin ndërtuar vitet e shekujt. Prandaj me krenari e mirënjojje, me dashuri e zjarr të pashuar patriotik, këtë qindvjetor e pret dhe e përkujton mbarë populli shqiptar, në RPS të Shqipërisë dhe kudo ku bamojnë shqiptarë, kudo ku tingëllon fjala e gjuhës së lashtë shqipe, sepse trashëgimi i madh i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte dhe është pasuri e përbashkët e një kombi

të tërë, pavarësisht nga ndarjet, ashtu siç ishte para njëqind vjetësh e përbashkët lufta e tij.

Gjysmë shekulli që çoi në themelin e Lidhjes shqiptare, veprimtaria e saj si e para organizatë politike mbarëshqiptare që prej kohës së lavdishme të Skënderbeut, e cila bashkoi masat popullore mbi bazën e programit politik shoqëror të ri e të përparuar të lëvizjeve kombëtare demokratike, përbënte dëshminë e rritjes së forcave ekonomiko-shoqërore, e shkallës më të lartë politike e kulturore që kishte arritur tanë populli ynë, edhe pse në kushtet e vështira të një sundimi të huaj shumë të rëndë, të regjimit despotik feudal osman.

Por kjo vijë rritjeje të gjithanshme kryqëzohej me vijën e ndërhyrjeve armiqësore po aq të gjithanshme, me politikën grabitqare të fuqive të mëdha kapitaliste evropiane dhe të satelitëve të tyre, të monarkive ballkanike. Ishte kjo ndërhyrje që krijoj, në kuadrin e konfliktit të madh ndërkombëtar të viteve 1877-1881, atë situatë krize vërtet tragjike që rrezikoi ta shpinte popullin shqiptar në «pikën zero» të rrugës së tij: ky komb me rrënjenë të lashta etnike, që nuk ishte shkrirë gjatë shekujve në etnitë e mëdha historike: bizantine-greke, sillave, turke e në kulturat e tyre, tanë do të copëtohej si një entitet gjoja «amorf», (siç e formulonte, diçka më vonë, Jovan Cvijic), si një «mbeturinë e historisë»; trojet e tij do të ndaheshin si një «terra nullius», një tokë e kurrikjt dhe do të shërbenin si lëndë ndërtimi për të fuqizuar shtetet e reja ballkanike. Kjo ishte një ndërprerje brutale e rrugës së konstituimit të tij si entitet politik në shtetin e bashkuar kombëtar. Kriza lindore, nga një çështje politike, siç ishte për popujt e tjerë, për popullin tonë, për kombin shqiptar u kthye në një pyetje të madhe — jetë a vdekje dhe kësaj pyetjeje populli shqiptar dhe figurat që qëndruan në krye të Lidhjes, i dhanë një përgjigje — rëndësia e së cilës vështirë se mund të mbivlerësohet: me luftë shumëfrontesh, shumëformash, përtë asgjësuar atë vendim të forumeve të fuqive të mëdha, që një nga figurat e shquara të kohës, Abdyl Frashëri, e quajti një krim politik amoral: Një dënim me vdekje kundrejt një populli të tërë.

Me luftën e Lidhjes, populli shqiptar i hodhi frontit të bashkuar të forcave të reaksionit një «sfidë të pasembullt», siç e ka quajtur shoku Enver Hoxha¹⁾: «këtu zot jam unë e

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 11.

kurrikush nuk ka të drejtë ta nxjerrë këtë tokë n'ankand!» — një fjalë e tillë nuk e humbet fuqinë as edhe pas një shekulli!

Pak ishin në numër vitet kur veproi Lidhja — por qfarë vitesh! Çfarë ngjarjesh të ngjeshura e të stuhihme i mbushin ato! Si në qdo moment historik kur në arenë hyjnë masat popullore, të pajisura me një program që e kanë bërë përvete si mishërim të aspiratave të tyre jetësore, në këto vite ecuria historike bëri hope të vrullshme, arriti shkallë pjekurie politike, që do të ishin të pamendueshme përvite të një zhvillimi normal.

Me energji revolucionare të pashterura, me një patriotizëm të pastër, masat popullore shqiptare, si kurdoherë që janë në rrezik interesat e tyre më jetësore, gjetën në veten e vet forcat morale e materiale, nxorën nga gjiri i vet forcat udhëheqëse dhe, sypatrembur e zemërhekur, u ngritën në luftë, pa mbështetje politike nga jashtë, me vetëbesim të partur ndërsa forcat e veta.

Nën flamurin e luftës së Lidhjes për çlirim kombëtar, përmbrojtjen e tërësisë së trojeve të atdheut, për bashkimin e gjithë shqiptarëve në një unitet shtetëror autonom kombëtar, u bashkuau pa dallim krahine e feje, zemrat e armët e masave patriotike që nga Ulqini e Malësitë e Veriut, që nga Kosova kreshnike, që nga Dibra e krahimat e tjera të banuara prej shqiptarësh, deri në trevat më skajore shqiptare në Jug e në Jugperëndim. Ky program u shpreh në protestat e memoranumet, në programet politike-ideologjike që dolën nga pena e udhëheqësve e ideologëve të shquar të Lidhjes si Abdyl e Sami Frashëri, Jani Vreto e Pashko Vasa etj., të atyre figurave të ndritura, të cilët i shërbyen çështjes së popullit si «iluministë revolucionarë, të guximshëm dhe me një atdhedashuri të madhe e të zjarrtë», duke luftuar «me pushkë e me pendë përlirinë dhe pavarësinë e popullit, përzgjimin e tij»².

Ky s'qe një program që mbeti në letër; ai u vu në jetë në llogoret e luftës përmbrojtjen e trojeve të atdheut në Plavë e Guci, në Hot e Grudë, në Ulqin e në Jug, në mobilizimin e në luftën e masave popullore përvitësuese dëbuar administratën e urryer të memurëve osmanë, përvitësuese pushtetin organeve të Lidhjes si organe të vetësundimit autonom — të «vetëligjësisë» kombëtare. Të paharruar do të mbesin përvitësuese aktet

2) E. Hoxha, *Raporte e Fjalime 1967-1968*, Tiranë 1969, f. 369.

e heroizmit popullor të një Sulejman Vokshi e Mic Sokoli, të Ali Ibrës e Sef Koshares, të Isuf Sokol Logorecit e të armatës së paemër të luftëtarëve popullorë, të cilët në Dibër e në Kosovë, në betejat që u zhvilluan në Caraleve, Shtimje, Sllivovë e Dule, në Malësinë e Tropojës, etj. dhanë jetën për të mbrojtur autonominë dhe Qeverinë e Përkohshme që ishte shpallur në tokat e gliruara.

Edhe pse u shtyp dhe u mbyt në terror e gjak, lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare në vitet 1878-1881 cau rrugë të reja në historinë tonë kombëtare. Ajo qëndron si një blok masiv në themel e jetës së re të kombit shqiptar — këtë komb ajo e nxori faqebardhë para gjykimit të pasardhësve e të historisë, kësaj mësueseje të rreptë, po të drejtë të jetës.

*
* *

Të ndërgjegjshëm për detyrën e nderit që ka shkenca marksiste-leniniste shqiptare për të studiuar e vlerësuar, për t'ua bërë të njohur masave tona punonjëse traditat e mëdha revolucionare-patriotike të popullit tonë, historianët e filozofët, filologët e letrarët tanë janë krenarë që mund t'i kushtojnë kësaj ngjarjeje të shënuar pengun e nderit e të ponisë së tyre, të mbledhur në këtë konferencë që po i fillon sot punimet në atmosferën kretnore të këtij qindvjetori, si dhe në sesionet shkencore kombëtare që do ta pasojnë në 5 rrethe. Me referatet e kumtesat që do të paraqesin studiuesit tanë, duke u mbështetur mbi rezultatet e arritura prej kërkimeve tona dhe mbi një vlerësim kritik të studimeve të trashëguara, do të përpilen të jepin një kontribut shkencor, secili nga këndi i fushës së tij, për të arritur një vlerësim e kuptim të thelluar të kësaj ngjarjeje të shënuar të historisë sonë kombëtare.

Lidhja Shqiptare dhe veprimitaria e saj kanë tërhequr vëmendjen edhe të historiografisë së huaj, si pjesë e historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare në një periudhë kyç të tyre, dhe si problem interesant në kuadrin e studimeve krahasuese mbi lëvizjet kombëtare evropiane të shek. XIX-XX. Nuk është e rastit që me këtë temë për shkak të aktualitetit të saj, historiografia ndërkombëtare pat filluar të merrej qysh në vitet kur po zhvilloheshin vetë ngjarjet — dhe vazhdon ta bëjë këtë. Është e natyrshme se edhe në këtë fushë, ose sidomos në këtë fushë, ndeshen vijat e mëdha të kontradiktavë ideo-

logjike-politike të kohës, ashtu siç ndodh në përgjithësi për historianë e marrëdhënieve ndërkombe të viteve të kritës lindore 1875-1878.

Duke u mbështeur mbi mësimet e Marksizëm-Leninizmit dhe të Partisë e të shokut Enver, që Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe në gjirin e saj viteve të Lidhjes u kanë kushtuar kurdoherë vëmendje të veçantë, historiografia jonë e re, me një varg studimesh të saj është përpjekur për një kuptim dialektik e klasor të proceseve dhe fenomeneve të kësaj periudhe të ndritur të historisë sonë. Në Historinë e Shqipërisë, vëllimi II (1965), u arrit një trajtim i parë i gjerë e i thelluar i kësaj epoke, i mbështetur mbi materializmin historik. Edhe pse jo pa të meta, kjo përbënte një hap të rëndësishëm përrpara në historiografinë e përgjithshme kushtuar kësaj periudhe.

Historianët tanë kanë kënaqësinë të konstatojnë se për disa çështje e aspekte ata takohen edhe me rezultatet e punës së historianëve shqiptarë nga Kosova si dhe me disa historianë përparimtarë të huaj. Mund të themi se rezultatet e historiografisë së re shqiptare kanë çarë rrugë dhe një varg prej tyre janë pranuar tashmë dhe nga historiografia ndërkombe. Duke u mbështetur mbi punën e bërë, dhe me ndihmën e materialeve të reja që kanë dalë e vazhdojnë të dalin në dritë, është bërë i mundshëm e i nevojshëm një trajtim më i thelluar e më i argumentuar i aspekteve të ndryshme të përmbajtjes së veprimit tarisë së Lidhjes Shqiptare në kuadrin e gjithë epokës së saj.

Këtij qëllimi i shërben edhe referati që po e hap vargun, i cili nuk synon tjetër veç se të shërbejë si një farë hyrje e përgjithshme për referatet e kumtesat që e pasojnë, duke paraqitur disa konsiderata mbi rrënjet historike të Lidhjes Shqiptare të viteve 1878-1881.

* * *

Problemi i rrënjeve historike të Lidhjes përbën një detyrë me karakter të ndërthurur e mjaft të ndërlikuar. Ai tërheq pas vetes një vargan pyetjesh e çështjesh të dyta, të cilat kërkojnë një farë zgjidhje paraprake, në qoftë se duam të arrijmë pastaj në kuptimin e drejtë të problemit të parë të shtruar.

Le ta nisim konstatimin se historiografia jonë Lidhjen Shqiptare e veprimtarinë e saj nuk e kuptojnë si një episod të lidhur vetëm e thjesht kronologjikisht me çka e pararend dhe e pason. Ajo është pjesë përbërëse e rrjedhim i një tërësie ngjarjesh e procesesh, me të cilat është ndërlidhur dhe ndërthurur — procese që përbëjnë thelbin dhe përmbytjen qenë-sore të shek. XIX në historinë e popullit shqiptar.

Si në pikën e zjarrit të një thjerze optike, në vitet e mbar-sura me ngjarje të stuhishme të Lidhjes, përqëndrohet problematika e gjithë këtij shekulli — të epokës së Rilindjes sonë Kombëtare. Përmbytja e këtyre viteve i përgjigjet plotësisht kuptimit historik të këtij termi, si një fazë që përbën përmbylljen e kapërximin e së kaluarës — në rastin tonë të periudhës së pashallëkeve feudale dhe nga ana tjetër lidhet me të ardhmen, në të cilën kalon nëpërmes një procesi përthyerjesh e përtëritjeje ekonomike-shoqërore e politike, duke nxjerrë forca të reja shoqërore në skenë, duke u çarë rrugën marrëdhënieve shoqërore të reja më të larta.

Vitet e Lidhjes përbëjnë një kulm të parë të kësaj epoke historike, në të cilën procesi i konstituimit të shqiptarëve si komb, e fuqizon në shkallë të lartë luftën e popullit për të dalë «nga errësira mesjetare feudale, imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë e arsim», siç e karakterizon shoku Enver Hoxha³⁾. Kjo ishte rruga që goi në qirimin kombëtar, në emancipimin e plotë politik-shoqëror e kulturor të shqiptarëve si komb.

Duke e vendosur Lidhjen dhe veprimtarinë e saj në pikën e kryqëzimit të ligjorive, si një etapë më të lartë zhvillimi dhe rrjedhim premisash objektive historike, të lidhur me armaturën ekonomike-shoqërore të një kombi të formuar, ky kuptim yni ndeshet ballë për ballë me disa pikëpamje simpliste, antishkencore, të cilat me një sofistikë antidialektike, duan ta përjashtojnë zhvillimin historik të popullit shqiptar nga sfera e veprimitarisë së ligjorive shoqërore «normale», duke paraqitur atë si rrjedhim fatalitetesh natyrore, gjeo-politike, të cilët përcaktokan pastaj edhe veprimin e faktorëve të tjerë shthurës që nuk lejokan zhvillimin e një kombi dhe të një lëvizjeje unitare nationale etj. etj.

«Autoritete» në lëmin e studimeve të Evropës Juglindore,

3) E. Hoxha, *Raporte e Fjalime, 1967-1968*, Tiranë 1969, f. 369.

që notonin dikur e notojnë ende në ujërat e turbullta të geopolitikës fashiste gjermane, e argumentojnë vlerësimin e tyre nihilist ndaj Lëvizjes kombëtare shqiptare dhe luftës së saj me argumentin se tokat shqiptare, të cilat me të vërtetë përbëjnë kushtin themelor për ekzistencën e një kombi, qenkan «prej natyre një «tokë e kurrukt» në dobi të fqinjëve majtas, djathjas e prapa krahëve të tyre». Vetë konfiguracioni i trojeve të tij e dënona popullin shqiptar që të jetë, siç thonë ata, i paafëtë për formimin e një shteti kombëtar, duke e detyruar të renditet kurdoherë në «suaza supranacionale» — duke filluar «nga Bizanci e Perandoria Osmane e duke shkuar deri te Austro-Hungaria dhe Bashkimi Sovjetik», siç e formuloi përsëri tanë së voni këtë mendim H. D. Schanderl, i cili qëndron mbi shpatullat e «autoriteteve» si G. Stadtmüller, Heymann, Hobus etj...⁴

Ndofta nuk do t'ia viente të qëndroje kaq gjatë në këto pikëpamje, po të mos ishte fakti se disa vepra, si «Historia e Evropës Juglindore» e G. Stadtmüller, trumbetohen e ribotohen si një «Standard work» i një autoriteti, i cili paska zbuluar ligjet që kanë drejtuar fatet e popullit tonë. Lëvizja kombëtare shqiptare — po ku ka një dicëka të tillë, kur Stadtmüller e «din mirë», se shqiptarët, për shkak të përkatësisë së tyre «në bashkësinë fetare islamike» na paskan qenë «bartës klasikë të ndërgjegjes perandorake osmane».⁵ Çlirimi kombëtar i Shqiptarëve — po ai nuk qe gjë tjetër veç se një shkëputje mekanike e Shqipërisë nga territoret e perandorisë osmane, si një akt i diplomacisë evropiane, e cila e paska ngritur një «çështje shqiptare» sa herë që Perandoria Osmane kërcenohej me prishjen, më 1876 për herë të parë, thotë dishepulli i Stadtmullerit, jugosllavi Stulli⁶ ose më

4) H.D. Schanderl, *Die Albanien-politik Österreich-Ungarns und Italiens 1877-1908*, Wiesbaden 1971, f. 9, G. Gesemann, *Das Königreich Süd-slawien*, Leipzig 1935, f. 20; E. Heymann, *Balkan, Kriege, Bündnisse, Revolutionen*, Berlin 1938, f. 63; G. Hobus, *Wirtschaft und Staat im Südosteuropäischen Raum 1908-1914*, München 1939, f. 72, G. Stadtmüller, *Albanische Volkstumsgeschichte als Forschungsproblem* in *Leipziger Vierteljahrschrift für Südosteuropa* 5 (1941) f. 74.

5) G. Stadtmüller, *Geschichte Südosteuropas*, München 1950, f. 343.

6) B. Stulli, *Albensko Pitanje*, Zagreb 1959, (Rad. JAZU) f. 296.

1912, thotë Stadtmuller⁷ dhe e përsërit D. Gjorgjeviç në raportin e tij para Kongresit Ndërkombetar të shkencave historike në Vjenë më 1965⁸, kur u prishën lidhjet territoriale me Stambolin dhe Shqipëria, «me kujdesin e fuqive të mëdha» paska rënë si një mollë nga druri, si shtet i pavarur në prehrin e shqiptarëve! Le t'u shtojmë këtyre zbulimeve edhe «ligjin e shpérthimeve demografike» të shqiptarëve që përcaktoka daljen e dhunëshme të tyre në arenën historike sa herë që u dobësoka «autoriteti», dmth. kërbaçi, i pushtetit qendror perandorak!⁹

Në të tilla pikëpamje bashkëjetojnë në fakt edhe konceptet despotike e teokratike të sultaniёve-kalifë dhe të patrikanës ekumenike, për të cilët në perandorinë osmane nuk kishte kombësi, por vetëm 3 komunitete fetare, edhe konceptet shoviniste të një lloj publicistike të shkallës së fundit, të shek. XIX e të fillimit të shek. XX. E keqja është se pikëpamje të tillë, mbi bazën e ligjit të përsëritjes, vazhdojnë të mbahen, ndonëse të kamufluara tanë me një terminologji të re «sociologjike».

Shqiptarët? — s'ekziston një unitet i tillë; shqiptarë mund të quhen vetëm «turko-albanët» ose gegët!¹⁰

Kryengritjet popullore shqiptare të viteve 1830-50? — produkte shthurjeje të një shoqërie feudale fisnore!¹¹

Lidhja Shqiptare e viteve 1878-1881? — një organ i maskuar keq i Portës, ose, në rastin më të mirë, një «aleancë turko-shqiptare» e forcave shoqërore më reaksionare — një shpérthim i icksenofobisë islamike, i shfrytëzuar nga Porta për të kundërshtuar humbjet territoriale pas Shën Stefanit!¹²

Territoret kombëtare shqiptare të mbrojtura nga Lidhja? — territore anësore!¹³

Autonomia e Shqipërisë si kërkesë e Lidhjes? — një rrugë për të ruajtur supremacinë e myslimanëve shqiptarë mbi

7) G. Stadtmüller, *Geschichte Südosteuropas...*, f. 377.

8) D. Djordjevic, *Les revolutions nationales balcaniques*, Beograd 1965, f. 221-222.

9) G. Stadtmüller, *Geschichte Südosteuropas*, f. 339, 343, 347.

10) P. I. Rushes, *Albanians Captives*, Chicago 1965, f. 8, 62.

11) V. Stojanceviç, *Jugoslovenski istoriski Casopis*. VII, 1957, f. 139-140.

12) N. Ražnatović, *Istoriski Zapiski*, Cetinje 1963, nr. 21, f. 73 vv;

Medjunarodni naucni Skup, tom. I, Sarajevo 1978, f. 294-297.

13) N. Ražnatović, *Istoriski Zapiski*, 1973, nr. 1, 2; f. 37 vv.

popullsinë sllave të krishtere të nënshtuar të Kosovës, derisa «dhuna shqiptare» e detyroi më më fund Serbinë të hyjë nën luftën e parë ballkanike!¹⁴

Emrat e historianëve si Stojanceviç, Rushes, Raznatoviç etj. që mbrojnë teza të tilla, as nuk do t'ia vlente t'i përmendje, po të mos ishte fakti që prapa këtyre pikëpamjeve fshihen tendenca dhe faktorë të çaktuar politikë antishqiptarë.

Ne sollëm këtu si shembull e si tregues për qëndrimet që janë mbajtur, disa raste skajore nga literatura e 25 vjetëve të fundit, pa mohuar përpjekjet për një kuptim më të drejtë të fenomeneve e proceseve që kanë të bëjnë me Lidhjen Shqiptare e lëvizjen kombëtare shqiptare, nga autorë të huaj si Stavrianos¹⁵, Bartl¹⁶, Schanderl¹⁷ etj., për të përmendur vetëm disa studime të fundit, me gjithë të metat që ato paraqesin.

Në këto kushte, detyra për të vënë më dukje rrënjet historike të Lidhjes Shqiptare e të veprimitarisë së saj, kërkon prej nesh që ato të vendosen së pari në pikën e kryqëzimit të ligjorative objektive të historisë së popullit tonë, për të treguar se faktorët themelorë që përbëjnë përbajtjen e Lidhjes nuk qenë as produkte të «importit», as të rastit e çastit. Rrënjet e tyre historike të çojnë në thelbin e atyre problemeve që përbëjnë koordinatat themelore të zhvillimit historik të popullit shqiptar, duke u nisur nga fillimi i shek. XIX.



Le të fillojmë me konstatimin se përpjekja për një kuptim të drejtë shkencor të Lidhjes Shqiptare dhe të epokës së saj duhet të niset nga vatra e këtyre ngjarjeve, nga Shqipëria e populli shqiptar, nga njojja e thellë e kushteve të zhvillimit të tyre të brendshëm e të forcave lëvizëse të sho-

14) V. Stojanceviç, *Jugoslovenski istorijski Casopis*, XI, 1960, f. 208-209; 212.

15) L. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, N. York, 1958, f. 502-504.

16) P. Bartl, *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhägigkeitsbewegung 1878-1912*, Wiesbaden 1968.

17) H. D. Schanderl, vep. e cit.

qërisë shqiptare — pa lënë pas dore, pa dyshim, edhe ndërthurjen e faktorit të brendshëm me atë të jashtëm. Pikërisht një orientim i tillë u ka munguar studimeve të huaja, duke përfshirë këtu edhe literaturën historike shqiptare të paraçlirimit. Një orientim i tillë kërkon që pika e gravitetit të kalojë nga jashtë, brenda. Kushti i dytë është që ky orientim të shprehet edhe në vlerësimin e bazës burimore, duke i dhënë përparësi materialit burimor të brendshëm. Këtu nuk është fjala thjesht për aspektin formal të prejardhjes, por në radhë të parë për karakterin e burimeve, nga i cili përcaktohet deri diku edhe orientimi i kuptimit të objektit që studiohet.

Duhet thënë se dobësia e përgjithshme e punimeve, midis tyre dhe të atyre autorëve që përmendëm më lart për përpjekje më serioze për të kuptuar këtë epokë, qëndron në absolutizimin e vlerës së bazës faktike që kanë pasur në dispozicion, qëndron në injorimin e karakterit të njëanshëm të saj. Nga kjo kritikë nuk mund të përjashtohen deri diku edhe punimet e deritanishme të historiografisë sonë. Dihet se me gjithë materialin faktik të pasur që japid, raportet kon-sullore, të cilat përbëjnë mbështetjen kryesore — në disa raste edhe të vetmen! — për njojhen e kohës, «i shohin ngjarjet, sidomos ato që zhvillohen në Shqipëri, me syzet e paragjykimeve kulturore dhe të «parti pris» të politikës së shteteve të tyre. Dhe vetëm realiteti kokëfortë i detyron nganjëherë, por me shumë vonësë, hartuesit e tyre të pranojnë deri me një farë grade realitetin — në qoftë se ia arrijnë! Rrjedhimi i kësaj njëanshmërie është ai primitivizm i tmerrshëm që i bëhet në shumicën e literaturës së huaj gjendjes ekonomike-shoqërore të tokave shqiptare. Po të nisesh p.sh. nga terminologjia e përdorur në ato dokumente, popullsia, jo vetëm e krahinave për të cilat luftonte Lidhja, po e gjithë tokave shqiptare, në të vërtetë nuk paska qenë shqiptare, sepse përbëhej nga «turq e grekë» (për ne është e qartë se këto terma përdoreshin natyrisht në kuptimin fetar!). Nga mosnjohja e moskuptimi i asaj gjendjeje të ndërlikuar që sundonte në malësitë shqiptare, të ndara në njësi administrative-ushtarake të vëtadministruara, përdorej termi «fis» në një funksion që ai as nuk e kishte, as nuk e kishte pasur që prej disa shekujsh, duke e përgjithësuar atë, që është akoma më keq, përtëj disa trevave të kufizuara malore, mbi territorin e gjithë Shqipërisë, në një fazë kur me gjithë pambetjen karakteristike për vendet nën sundim të perando-

risë osmane, në jetën e saj vepronin tashmë ligjet e ekonomisë dhe të shoqërisë kapitaliste dhe ishte formuar ajo kategorji e qëndrueshme historike, kombi shqiptar, mbi bazën e bashkësisë territoriale, gjuhësore, ekonomike e kulturore-shpirtërore. Si rrjedhim i këtij primitivizimi të përgjithshëm, primitivzohej edhe gjithë Lidhja Shqiptare, karakteri dhe përbajtja e veprimtarisë së saj.

Për këtë arsyen mendojmë se për kuptimin e veprimtarisë së Lidhjes, përparësi duhet të kenë dokumentet e lindura në vend, sidomos ato që kanë dalë nga veprimtaria e qendrës dhe të degëve të Lidhjes, d.m.th. aktet, vendimet, memorandumet, publicistika, epistolaret e anëtarëve të saj, që historiografia jonë i ka vlerësuar dhe vënë në qarkullim si burime të dorës së parë. Me gjithë dobësitë e paqartësitet që jo rastësish përbajnjë, me gjithë gjuhën ezopike që janë të detyruar të përdorin, ato përbëjnë një bazë autentike për të përcaktuar programet e Lidhjes dhe veprimtarinë e saj në evolucionin e tyre historik.

* * *

Cili qe trashëgimi që mori epoka e Lidhjes nga e kaluara? — trashëgim ndaj të cilët ajo, si qdo brezni historike pasardhëse, mbajti, në mënyrë të vetëdishme ose jo, një qëndrim dialektik — e vazhdoi, e ngriti në nivel më të lartë dhe më në fund e kapërzxeu.

Jo rastësish ne i lidhëm rrënjet e epokës së Lidhjes me fillimet e shekullit XIX, c'ka në kushtet historike të tokave shqiptare do të thotë me dy pashallëket në fakt autonome të Shqipërisë së Veriut dhe të Jugut. Tregjet ndërkrahinore, të formuara gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII, qenë një hap drejt unititetit ekonomik të vendit e u shërbyen këtyre formacioneve shtetërore feudale shqiptare si bazë për të bashkuar shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare në kuadrin e dy formacioneve politike paralele. Këtu nuk është fjalë për një fenomen anarkie (Stadtmüller¹⁸), ose për një fenomen shthurjeje e degjenerimi që shënon një fund (Vukosavljeviç)¹⁹, por për një proces me elemente ekonomike e po-

18) G. Stadtmüller, *Geschichte Südosteuppas*, f. 345-347.

19) S. Vukosavljevic, *Istoria Seljackog drustva*, Beograd 1956, f. 13.

litike që çonin përpara, shprehje e një qëndrese të përgjithshme të një kombësie të nënshtruar, në të cilën bënte pjesë edhe klasa feudale e fuqizuar shqiptare. Ky ishte një proces, i cili, siç thekson Engelsi për mesjetën, favorizonte formimin e kombeve e të shteteve kombëtare, në bazë territorresh unitare nga pikëpamja e kombësisë e të gjuhës²⁰.

Rënja e dy pashallëkeve më 1822 e 1831 nuk mund të ishte, pra, fundi, por ishte fillimi i një qëndrese në shkallë më të gjërë, me forcët e reja të masave popullore që zunë të dalin tanë e tutje në ballë të konfliktit me pushtetin qendror të huaj; ky konflikt nuk zhvillohej më nëpërmes luftës së kufizuar të klasës feudale, por në ndeshje ballore e massive, në një mënyrë siç nuk kish ndodhur më që prej shekullit XV-XVI, kundër asaj që Sami Frashëri e quajti «pushtimin e dytë të Shqipërisë», kundër atij invazioni memurësh «myflisë të pabrekë», «halldupë e konjarë», siç i cilësonte me urrejtje populli jo vetëm sepse ishin të huaj si kombësi, por edhe sepse me ta vinte një sistem i tërë i rëndë takshash e detyrimesh, gjyqesh të korruptuara dhe shërbimi ushtarak në dhe të huaj. Kontradikta kombëtare përforcohej kështu nga kontradiktë shoqërore. Çdo lëvizje kombëtare e një populli të shtypur, na mëson Lenini, ka në vetvete një element demokratik²¹. Një dëshmi të gjallë të kësaj shkrirjeje të dy elementëve, kombëtar e shoqëror, që përbën thelbin e fuqinë e lëvizjes kombëtare e të patriotizmit popullor, na e jep një vjershë e viteve 60, e lindur në zonën Tepelenë-Gjirokastër:

Ky halldupi, ky konjari bukën tonë po na ha,
Khveshur, zbatohur na ka lënë, lakuriq pa një para.
Gjithë halldupët pashallarë, të mëdhenj e si zotë,
Shqipëtarë s'ka të mbajë as një festë në kokë.
Gjynah, pra, nga perëndia të punojë shqipëtarë,
Dhe të hajë e të pijë e të bëjë rehat konjari...²²

Për vetë karakterin e saj të gjithanshëm, kjo kontradiktë nuk mund të kufizohej vetëm në masat fshatare-ajo do të përfshinte, siç e bëri në fakt, së bashku me to, dhe për të njejtat

20) Marx-Engels-Lenin-Stalin zur deutschen Geschichte, vell. I. Berlin 1956, f. 162.

21) V. I. Lenin, Veprat, vell. 20, f. 471.

22) E. Brandi, Alvanika parpona, Athinë 1880, f. 152-153

arsye, edhe popullsinë qytetare. Kryengritjet, të nisura si lëvizje «fshatare», gjejnë mbështetje në qytetet (në Berat, Elbasan, Shkodër, në Prizren, Gjakovë etj); më disa raste rolin udhëheqës e merr dhe e ruan tanimë qyteti, siç që rasti në Shkodër, në qytetet e Kosovës, ç'ka dëshmonte pér forcimin e frontit dhe pér rritjen e ndikimit të borgjezisë qytetare, si forcë më e përparuar, mbi fshatin, që ishte përfshirë tanë në sferën e veprimit të tregjeve qytetare. Me këto lëvizje u bashkua, në një varg rastesh edhe si udhëheqëse, një pjesë e klassës feudale shqiptare, e zhveshur prej reformave centralizuese osmane nga pushteti politik në vend, me synimin pér t'u rikthyer në fuqi — një synim objektivisht i parealizueshëm, sepse me shembjen e pashallëkeve dhe tatëpjetët e pronës feudale-ushtarake klasa feudale ishte dobësuar tashmë, ndërsa po konsolidoheshin gjithnjë e më tepër pozitat e ekonomisë së re kapitaliste, në kuadrin e së cilës qe detyruar të përshtatej edhe ekonomia çifligare.

Kuadri që paraqiste Shqipëria në vitet 30-50 të shek. XIX karakterizohej nga acarimi i mëtejshëm i konfliktit osmano-shqiptar që nxori në shesh elemente të reja, sasiore dhe cilësore. Në këto kryengritje merrnin pjesë të gjitha klasat e shtresat e popullit shqiptar me një shtrirje të gjerë që nga Veliu, Lindja e deri në Jug, çka i bënte ato në fakt kryengritje të përgjithshme të shqiptarëve si një tërësi kombëtare. Dhe si e tillë ata u kuptuan edhe nga Porta, edhe nga diplomatë të huaj. Ato shpërtheyen njëra pas tjetrës, në të njëjtat vite, kundër të njëjtët armik, pér të njëjtat shkaqe edhe faktikisht pér të njëjtat kërkesa e qëllime (nga lëvizje tipike fshatare, siç qe rasti në zonën Kumanovë-Tetovë-Gostivar, që «zgjedh» nga radhët e veta «mbretin e mirë», mbretin Dervish, pér t'u mbrojtur nga zullumet e «mbretit të keq», ato shkojnë deri te kryengritjet e udhëhequra në Jug nga Tafil Buzi, që kërkonin të arrinin qëllime të një niveli më të lartë politik — shkëputjen nga sundimi osman, pér të shpëtuar nga të këqiat që sillte regjimi i absolutizmit burokratik të sulttanit, sipas shembullit të fqinjëve ballkanikë që kishin krijuar shtetet e veta).

Këto rrethana u bënë shkak që të realizoheshin forma organizative më të larta; u krijuan kuvende e besëlidhje ndërkrahinore të cilat lejuan veprime luftarake të përbashkëta në shkallë të gjerë, siç ishte Besëlidhja e 9 krahinave, më 1828, e përtëritur më 1834, që drejtoi pér disa vite me radhë kryengritjen e Toskërisë dhe krijoi lidhje edhe me lëvizjet e Shqipërisë

së Veriut, aksionet e përbashkëta të Dibrës me Elbasanin, të Matit e Kosovës me Shkodrën dhe Kuvendi i madh ndërkrahinor i Mesaplikut si organizatë politike e kryengritjes së vitit 1847.

Nevojat e luftës përbënин një faktor objektiv që shtynte përpara për të gjetur forma organizimi politik-ushtarak të reja më të larta e të qëndrueshme. Porse kësaj situate objektive nuk i përgjigjej aspekti subjektiv. Deri në pragun e Lidhjes nuk u arrit ende një organizim i tillë unitar i gjithë kësaj lëvizjeje. Megjithatë, kjo ishte objektivisht luftë e përbashkët e gjithë krahinave shqiptare, që përfshinte e përfqaqësonte në thelb interesat objektive të gjithë klasave e shtresa ve themelore që përbënин shoqërinë shqiptare. Kërkesa për të përjashtuar nga zbatimi i politikës së centralizmit burokratik tokat shqiptare, donte të thonte në fakt zbatimin e një statusi të veçantë për territoret shqiptare, duke i dalluar dhe veçuar ato nga territoret e tjera të Perandorisë. Ajo përmبante pra «në vezë» kërkesën e administrimit autonom të Shqipërisë, duke ua lénë këtë në dorë «krerëve» të vendit — çka nuk donte të thonte kurrësesi, në kushtet e shndërrimeve ekonomike-shoqërore që po ndodhnin në Shqipëri, që push-teti t'u kalonte në dorë përfqaqësuesve të «regjimit të vjetër» tashmë të perënduar.

Edhe pse nuk kishte ende një program politik me synime largshkuese të formuluara qartë, këtu kemi të bëjmë me një konstelacion forcash shoqërore që përfqaqëson tashmë interesat e kombit shqiptar si një unitet, një konstelacion që do të zotërojë arenën politike shqiptare deri më 1912.

Këto lëvizje të fuqishme të viteve 30-50 ku rolin kryesor e luanin masat populllore, përbëjnë në të vërtetë fazën e parë — e jo vetëm një premisë, përgatitje, ose sfond — të asaj epoke të re, e cila me emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare, realizoi detyrën e vërtetë historike të shek. XIX — çlirimin e popullit shqiptar nga robëria e perandorisë feudale osmane, krijimin e shtetit të pavarur e sovran, si kusht për zhvillimin e tij të mëtejshëm ekonomik e shoqëror.

*
* * *

Kërkesat që kishin shtruar kryengritjet populllore mben-tën në fakt edhe më tej në rendin e ditës, përtej viteve

1878-1881; po pikërisht në vitet e Lidhjes ato gjetën rast për të shpërthyer me forcë të re; ato përbëjnë atë lëvizje masive që zhvillohet përsëri në të gjitha krahinat shqiptare, nga Veriu në Jug, kundër organeve të pushtetit osman. Edhe tani bashkohej urrejtja kundër «të huajit» — ai termi «halldup» e «konjar» vazhdon ta ruajë kuptimin e dallimit si kombësi — me urrejtjen me karakter shoqëror, të drejtuar kundër administratës së korruptuar osmane si shfrytëzuese të masave populllore. Pa këtë rrënje shoqërore nuk do të mund të kuptoheshin as aksionet mësimtare pér mënjanimin — në shumë raste dhe dëbimin me dhunë — të organeve shtetërore thuajse në gjithë qytetet e Shqipërisë në vitet 1878-1881, as mbështetja që gjeti programi i autonomisë së hartuar — dhe zbatuar më në fund me dhunë — në luftë të hapur kundër Portës, nga krahu më i përparuar i Lidhjes, duke pasur pér këtë mbështetjen, madje në radhë të parë, të masave populllore.

Po kjo urrejtje shoqërore kundër shfrytëzuesit e nxiste edhe më tepër urrejtjen kundër sundimtarit të huaj kur ky, pa pikë ngurrimi, po nxirrte tani në ankand pasurinë e parë dhe kryesore të popullit, truallin, tokën e tij, duke përdorur të njëjtën dhunë, me të cilën po e mbante prej shekujsh nën robërinë e vet. Në këtë pikë përputheshin interesat shoqërore dhe ato kombëtare të masave popullore me ato të borgjezisë kombëtare, që përbënët në këtë etapë shtresat demokratike të shoqërisë shqiptare. Në momentin e caktuar historik, në këtë front u tërroq edhe klasa çifligare, e mënjanuar nga pushteti politik, e kërcenuar edhe ajo nga rreziku i përbashkët i humbjeve territoriale. Kjo përputhje interesash të klasave e shtresave kryesore të kombit në këtë moment të caktuar, përbënte një faktor që lejoi luftën të arrinte një etapë më të lartë zhvillimi.

Këtij fronti të gjerë forca shqërore i shërbeu programi i përvizuar nga aktivistët e Rilindjes në vijat e tij të përgjithshme qysh në vitet '50-'60; ky program arriti përcaktimin e objektivave dhe të rrugëve konkrete pér realizimin e tyre, në pragun e Lidhjes dhe gjatë viteve të veprimit tarisë së saj.

Nga vetë kushtet konkrete historike të Shqipërisë, ishte e qartë se objektivi që qëndronte përparrë lëvizjes kombëtare, ishte lufta pér çlirim kundër sundimit osman — kjo ishte vazhda logjikë sidomos e gjysmëshekullit të kryengritjeve populllore kundër regjimit të centralizmit burokratik. Por në kushtet konkrete të krijuara veçanërisht në vitet e krizës lindore, ky objektiv ishte si plotësim një objektiv të dytë,

mbrojtjen kundër ndërhyrjes grabitgare të monarkive ball-kanike e të fuqive të mëdha prapa tyre.

Sigurimi i të drejtave kombëtare kundrejt Portës, dhe njëkohësisht i trojeve kombëtare kundrejt rrezikut të copëtimit nga intervencioni i forcave të shteteve fqinje, përbënин një detyrë të ndërthurur shumë të madhe e të rëndë, e cila mund të zgjidhej me sukses, në rrugën e luftës së armatosur, vetëm po të mbështetetë mbi një program politik të përparuar: mbi bashkimin e gjithë shqiptarëve në një unitet shtetëror kombëtar, cilado të ishte forma e tij. Kësaj lufte, pra, duhej t'i paraprinte një luftë ideologjike, e cila do ta shoqëronte dhe ta plotësonë atë, për ta vënë lëvizjen shqiptare mbi baza politiko-shoqërore të reja, të përparuara. Është e qartë se me këtë kuptim, Lidhja dhe veprimtaria e saj nuk hyjnë kurrsesi në atë kallëp, në atë shtrat Prokrusti, ku duan ta fusin ata historianë që e konceptojnë atë thjesht si një lloj lufte antiintervencioniste – duke nxjerrë prej kësaj premise filletare të gabuar, domosdo, dashur e padashur, por më tepër me dashje – ato konkluzione të gabuara e antihistorike që vumë në dukje në fillim.

Këto komponente themelore të programit të Lidhjes kishin një parahistori; ato nuk lindën në një moment, të gatshme, si Athinaja nga koka e Zeusit.

Procesi historik i konsolidimit të kombit shqiptar si një kategori historike më e lartë, proces që zhvillohet në gjysmën e parë të shek. XIX, ishte lidhur me një përbajtje të re ekonomike-shoqërore. Në kushtet e Shqipërisë, as fshatarësia, për vetë gjendjen e saj të prapambetur dhe për natyrën e saj shoqërore, dhe aq më pak iklastra sunduese çifligare, nuk mund të ishin forcat drejtuese të këtij procesi. Kjo ishte detyra historike e borgjezisë kombëtare shqiptare dhe e inteligjencies së re të dalë nga radhët e saj, të interesuar për vetë interesat e tyre klasore, në një zgjidhje përparimtare të detyrate kombëtare e demokratike që shtronë koha. Dhe kësaj detyre, inteligjenca përparimtare shqiptare e kohës iu përgjegj me nderë.

Lind pyetja – dhe jo rastësisht – se ku duhen kërkuar rrënjet e kësaj lëvizjeje që ka shkruar faqe të ndritura të historisë së mendimit politik-shoqëror e të kulturës së kombit tonë.

Një literaturë e tërë i është kushtuar kësaj pyetjeje, në kuadrin e problemit të studimit krahasues të lëvizjes kombëtare të popujve, sidomos të Evropës Juglindore.

Nuk na çudit që një problem kaq i ndërlikuar, ka gjetur shpesh përgjigje simpliste, si ajo e dhënë nga Stadtmüller, sipas të cilit popujt e Evropës Juglindore paskan njohur vetëm ndjenjën e «dallimit etnik» kundër të huajt, por nuk paskan pasur një «ide kombëtare» (Nationalgedanken), të barabartë me atë të Perëndimit. Ata e paskan «importuar» këtë të gatshëm, në momentin e caktuar, prej andej^{22/1}.

Kjo është një mënyrë «krejt e njëanshme e të shtruarit të problemit, që i sheh fenomenet ideologjike në prizmin e huazimeve thjesht mekanike. Këtu është fjala në të vërtetë për një ndërlidhje dialektike të proceseve ideologjike me bazën e tyre, ku proceset ideologjike në një varg rastesh u paraprijnë ndryshimeve në bazë.

Një gjysmëshekulli i tërë, i mbushur me ngjarje e procese të brendshme politike-shoqërore tronditëse, kryengritjet e Bushatlinjve e të Ali Tepelenës e rënia e tyre, kryengritjet e mëdha popullore të viteve 1830-1850 që mbuluan gjithë Shqipërinë, ndërthurja e konflikteve të jashtme, revolucioni i viteve 1848-1849, kryengritjet e popujve fqinjë që çuan në formimin e shteteve ballkanike, ndërhyrja e këtyre në skenën politike shqiptare, e më në fund lëvizjet e armatosura që shpërthenin pa ndërprerje kudo në Shqipëri, deri në pragun e Lidhjes, në Dibër, në Dukagjin, në Kosovë, në Mirditë etj. a nuk përbën ato ngjarje, të cilat shtronin përparrë vepruesve mendorë të kohës atë pyetje tronditëse, që shtrohet para popujve pikërisht në momente kthese: Çfarë duhet të bëjmë? Cila është rruga që duhet të ndjekim? Nuk është kurrsesi e rastit, që të gjithë ideologët e lëvizjes sonë kombëtare, duke filluar nga Jubani, P.Vasa, e deri te S.Frashëri e nisin pikërisht nga këto ngjarje fillin logjik për konsideratat e tyre në lidhje me rrugën historike e me platformën e Lëvizjes kombëtare shqiptare.

Përgjigjen u përpooq t'ua jepte këtyre pyetjeve një brez, i cili doli në arenën historike pikërisht në këtë fazë të re, që nis me çerekun e parë të shekullit të ri: midis të paemërve, i pari që e njohin me emër ndër figurat e ideologëve të Rilindjes sonë, është ai Naum Veqilharxhi, i cili shkruante më 1846 ato fjalë lapidare që shënojnë këtë kthesë: «Ka ardhur koha që t'i flakim të gjitha paragjykimet e vjetëruara, ka ardhur koha... që të këmbejmë udhë... duke marrë si shebull kombet e përparuara mbi tokë... Dhe duke synuar kë-

tu, le të ecim pa u lëkundur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje». Si në cdo rast, faza kur një proces bëhet i ndërgjegjshëm e gjen një shprehje programatike, tregon se ai ka arritur tashmë një shkallë të lartë pjekurie.

Problemi që shtruam në lidhje me zanafillën e këtyre lëvizjeve mendore, dhe zgjidhja që mendojmë se i duhet dhënë, është në kundërshtim të plotë me shpjegimet që i janë dhënë mekanizmit të lindjes së proceseve të lëvizjeve kombëtare në literaturën historiografike perëndimore, ku përcaktohen përkëtë qëllim disa «modele tip», siç është p.sh. ai i historianit çekoslovak M. Hroh²³⁾, që pretendon të cilësohet marksist. Ato e kthejnë problemin me kokë poshtë, kur mendojnë se lëvizjet kombëtare të popujve të vegjël nisen nga veprimitaria humtuese e disa figurave eruditësh — si p.sh. të tipit të Herderit — rrëth gjuhës e historisë së një populli të tillë, dhe vetëm më vonë arritkan të përfshijnë një rrëth të caktuar më të gjërë.

Shembulli shqiptar, si shprehje e një ligjorie më të përgjithshme, nuk hyn në këtë model jo sepse përbën një përjashtim, por sepse vetë modeli është i shtrëmbër. Rilindasit tanë u nisen nga përvoja historike e kohës, dhe nëpërmes përpunimit e përgjithësimit teorik të saj, hartuan platforma programatike, të cilat në një shkallë më të lartë të spiralit, iu drejtuan bazës nga e cila ishin nisur, duke u shërbyer lëvizjeve të kohës si program e platformë ideologjike-politike. Kjo që rruga që ndoqën pas Veqilharxhit Z. Jubani, P. Vasa, e më vonë S. Frashëri, veprat e të cilëve përbëjnë në një vijë vazhduese ngjitime, etapat kryesore të zhvillimit të mendimit politik-shoqéror të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Armët mendore përzgjidhjen e këtyre detyrave, përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje të re i muarën nga arsenali i ideve që u ofronte koha, duke zgjedhur e përvetësuar andej për çka kishin nevojë. Iluminizmi, i lindur në kushtet e luftës së borjezisë evropiane të fundit të shek. XVIII kundër rendit feudal-absolutist, u bë shkolla ku — si gjithë inteligjenca ballkanike — edhe inteligjenca përparimtare shqiptare mësoi në gjysmën e parë të shek. XIX të përdorte armët e luftës. Ata kaluan të gjithë nëpër shkollën e Rusoit, teoria e të cilit mbi të drejtën natyrore të individit e të popujve u kundërvihet si një «ungjill»

23) In: Th. Schieder (ed.) Sozialstruktur und Organisation europ. Nationalbewegungen, München 1971, f. 124-125.

i ri, pretendimeve të rendit të vjetër feudal-absolutist për të qenë i përjetshëm. Nga ky burim është ushqyer antiteza «natyrë-konvencion», e cila qëndron në bazë të mendimit filozifik e politik të Jani Vretos. Në bazë të teorisë të së «drejtës natyrore», Jani Vreto «sovranitetin e popullit», lirinë «e lindur me njeriun si dhuratë të parë që i jep natyra», kombin si një kategori të «vetijtë»²⁴, ua kundërvinte atyre pushteteve që mbaheshin në fuqi «për hirë të zotit» — perandorisë universale të Sulltanit, «kishës së Madhe të Stambollit» ose fuqive të mëdha bashkëkohore. «Shtetet e qytetër uara (nënkupto Fuqitë e Mëdha) kurrë nuk kanë folur gjëra të drejta, ata kanë folur e vepruar kurdoherë padrejtësish, në kundërshtim me natyrën»²⁵ shkruante ai në lidhje me vendimet e Kongresit të Berlinit kundrejt Shqipërisë, duke i vënë ato në një radhë si shkaktarë të dhunës, grabitjes, përçarjes, obskurantizmit që rëndonin mbi popullin shqiptar.

Nën shenjën e historizmit fillon ai kthim drejt së kaluarës së kombit, një lloj romantizmi aktiv, i kthyer nga e kaluara për të marrë fuqi, e që shikon me optimizëm përpëra, me besim në mundësitet e rrugës historike të popullit të vet — duke e konsideruar realitetin e prapambetur si një moment relativ në rrugën e zhvillimit njëlinear të popujve. Këto janë konceptet e Veqilharxhit, që përbajnjë «në bërtamë» gjithë filozofinë teorike e praktike të Rilindjes sonë në fazën e saj të parë — një filozofi e optimizmit dhe demokratizmit. Edhe pse nisës nga pozita të filozofisë idealiste, ishte vetë realiteti, ishin kushtet reale historike që i imponuan asaj zgjidhjet konkrete të drejta. Si «iluministë revolucionarë të guximshëm» rilindasit bashkuani kurdoherë teorinë me praktikën, luftuan edhe «me pushkë e me pendë për lirinë dhe pavarësinë e popullit, për zgjimin e tij» thotë shoku Enver Hoxha²⁶.

Kjo ishte një detyrë e ndërthurur që niste me përpjekjet për afirmimin e gjuhës amtare si shprehje të identitetit dhe unitetit kombëtar në luftë kundër presionit shkombëtarizues të gjuhëve e kulturave universale të shtetit e të kishave, dhe njëkohësisht si «rrip transmisioni të rëndësishëmi»²⁷ për të përfshirë në lëvizje masat, për të realizuar mbi këtë bazë të

24) J. Vreto, *Vepra*, boluar nga A. Uçi, f. 230, 232, 237.

25) J. Vreto, letër J. K. Hoxhit, datë 18.VII.1879.

26) E. Hoxha, *Raporte e Fjalime 1967-1968*, Tiranë 1969, f. 369.

27) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 10.

gjerë e demokratike njësinë kombëtare edhe në aspektin politik, duke kapërxyer përçarjet fetare e krahinore.

Vetë realiteti historik, faktori i masave të vëna në lëvizje prej dhjetëra vitesh në luftë për të drejtat e tyre shoqërore, vetë interesat klasore të borgjezisë kombëtare bënин që kjo luftë të mos mbetej thjesht në një plan gjuhësor-kulturor. Bashkimi kombëtar — kjo donte të thoshte bashkim jo vetëm mbi bazën e bashkësisë etnike-gjuhësore e të historisë së përbashkët; ai merrte edhe një përmbytje politike-territoriale dhe ekonomike-shoqërore të përparuar.

Duke i shtruar në mënyrë thelbësore këto koncepte, Zef Jubani e Pashko Vasa, të parët, e zgjeroin konceptin e kombit si bashkësi historike, shpirtërore e gjuhësore, duke vënë theksin mbi aspektin territorial dhe përmbytjen ekonomike dhe rrjedhimet shoqërore që duhej të kishte krijimi i një formacioni shtetëror shqiptar.

Problemi i njësisë dhe i mbrojtjes së trojeve të popullit shqiptar vihej kështu në kryqëzimin e vijave të mëdha ideo-logjike-politike-ekonomike. Këtu ishte fjala jo vetëm për troje stërgjyshore, për vatrën e lashtë historike të një populli që i kishte larë prej shekujsh me gjak, siç e theksiston memorandumet e Lidhjes Shqiptare vazhdimisht, por njëkohësisht edhe për bazën e jetës ekonomike të popullit, cënimi i së cilës prishtë ekuilibrin e një bashkësie ekonomike të formuar historikisht, siç theksonte me një gjykim të mprehtë Jani Vreto.

Ideologët e Rilindjes dhe aktivistët e Lidhjes me të drejtë shihnin në unitetin territorial formën e vetme me të cilën jeta kombëtare mund të arrinte zhvillimin e saj të plotë dhe unitar. Këtu ishte fjala për një rezultat logjik të gjithë zhvillimit historik të jetës së një populli dhe njëkohësisht përkushtin themelor të realizimit të së drejtës për t'u konstituar e organizuar si një unitet politik kombëtar.

Në këtë kuptim, lufta që zhvilloi Lidhja për mbrojtjen e çdo pëllëmbe toke, kishte një kuptim të përgjithshëm. Deklarata që i bëri populli i Plavës e Gucisë Komisionit Ndërkombëtar me 15.VIII.1879 se as ai vetë nuk kishte të drejtë të disponente mbi tokën e krahinës së tij pa miratimin e gjithë krrëve të Shqipërisë, tregonte se kjo ide kishte zënë tashmë rrënje të thella në ndërgjegjen e masave popullore.

E parë në këtë ndërlidhje të përgjithshme, edhe kërkesa për një status të veçantë e autonom të tokave shqiptare vjen duke marrë një kuptim më të plotë e më të lartë politik, duke

u mbushur me përbajtje politike dhe ekonomike-shoqërore më të përparuar në mendimin e veprat e Zef Jubanit, të Pashko Vasës, në memorandumet e Lidhjes etj.. Në konceptin e autonomisë së Shqipërisë fillojnë të bashkohen si në një lumë, rrymat e veçanta të luftës për autonomi krahinore që kishin një vatër aktive veçanërisht në malësitë. Me interes janë në këtë drejtim përpjekjet e përsëritura disa herë — qysh nga viti 1862 e deri më 1876-77 nga grupi i patriotëve të Shkodrës me Z. Jubanin në krye, për t'i bërë kryengritjet e Mirditës pikënisje për të shtruar gjithë çështjen shqiptare — një detyrë që u realizua në plan kombëtar e ndërkombëtar vetëm në vitet e Lidhjes, në luftën e saj për realizimin e autonomisë politike të të gjitha tokave shqiptare së bashku.

Rritja e zgjerimi i Lëvizjes kombëtare shqiptare shtronnte si detyrë gjithnjë e më urgjente, krijimin e një qendre organizative unike të saj. Orvatjet e përsëritura qysh prej 1858 në Stamboll, çuan në realizime akoma të pjesshme — tepër të mëdha qenë vështirësítë që vinin nga faktorë pengues të brendshëm e në radhë të parë të jashtëm. Formimi i shoqërive e komiteteve të veçanta në Shkodër e sidomos jashtë atdheut, në Stamboll, në Bukuresht, në kolonitë arbëreshe të Italisë, qenë një fillim që arriti të realizohej në plan mbarëshqiptar vetëm më 1877, me krijimin e komitetit të Stambollit dhe nën kujdesin e tij, të Komitetit Qendror të Lidhjes me qendër në Prizren dhe me degët e komitetet e saj lokale në gjithë krahinat të banuara prej shqiptarëve. Kjo qe zgjidhja në nivelin më të lartë të kësaj detyre të rëndësishme politike kombëtare.

Ndoqëm vijat e zhvillimit të një vargu procesesh të karakterit politik-shoqëror. Si rezultante të zhvillimit të brendshëm ato na çojnë deri në pikën e kryqëzimit të tyre. në pragun e themelimit të Lidhjes Shqiptare në vitin 1877.

Të theksosh se kjo ishte një rezultante procesesh të brendshme, nuk do të thotë kurrsesi të nënvleftësosh rëndësinë e faktorit ndërkombëtar. Ai lojti një rol të rëndësishëm, edhe s'kishte si mos e luante, si faktor ndihmës, si ajo «shkëndë elektrike» që shërbeu, pas fjalëve të Pashko Vasës, për shpërthimin e dinamitit të grumbulluar prej kohësh, si një katalizator që bën të precipitojnë proceset kimike.

*

* * *

Në jetën politike të popujve të robëruar nuk mungojnë raste, kur lufta e tyre gjen një situatë ndërkomëtare të favorshme, e cila e bën të mundshme formimin e një aleanse politike pak a shumë të qëndrueshme. Populli shqiptar, për një varg rrëthanash, as në shek. XIX nuk pati një mundësi të tillë që do ta kishte lehtësuar luftën e tij për çlirim.

Lëvizja politike shqiptare u ndodh kështu vetëm, përballe dy fuqive të mëdha që ndanin sundimin në perandorinë osmane — Sulltanit kalif e Patrikanës greke; por ajo nuk gjeti aletë as midis shteteve ballkanike, të cilët ia detyronin ekzistençen e tyre zbatimit të parimit të kombësisë.

Përkundrazi, gjendja në të cilën e kishte katandisur Porta Shqipërinë, krijonte sipas mendimit të qarqeve sunduese në këto shtete një rrëthanë shumë të favorshme për të realizuar plane të një ekspansioni të guximshëm, aq më tepër që kryengritjet e vazhdueshme shqiptare e kishin dobësuar sundimin osman në Shqipëri. Pikërisht kjo rrëthanë shërbeu për ta aktivizuar edhe më shumë politikën e monarkive ballkanike në Shqipëri.

Në parashikim të mundësisë së një krize të re vdekjeprurëse për sundimin osman në Ballkan, secila nga këto monarki, duke llogaritur në mbështetjen që mund të kishte në njëren nga fuqitë e mëdha, sidomos të Rúsise, synonte ta mbushte vetë atë zbrazëti që do të krijohej në tokat shqiptare, ose, në pamundësi, ta ndante plaçkën. Në pritje ato krijonin kontakte me personalitete ose lëvizje kryengritëse në tokat shqiptare. Duke shfrytëzuar nevojën që kishin kryengritësit shqiptarë në Veri e në Jug për të gjetur strehim në tokat jashtë sferës së veprimit të qeverisë osmane, qeveritë ballkanike u përpoqën të fitonin nëpërmes tyre ndikim mbi këto lëvizje, përt'i kanalizuar në dobi të planeve të tyre. Për këtë qëllim shfrytëzohej mundësia që ato kishin për të krijuar pa pengesa nga Porta e Lartë shkolla e institucione të tjera kulturore e fetare në tokat shqiptare, kurse ndiqej me egërsi edhe përpjekja më e vogël nga ana e shqiptarëve për të organizuar veprimtari të tilla. Me shumë mjeshtri shfrytëzohej edhe legjenda për një origjinë të lashtë të përbashkët të shqiptarëve e serbo-malazëve, e nga ana tjetër të shqiptarëve e grekëve nëpërmes stërgjyshërvë të përbashkët pellazgë. Faktet e bënë të qartë se çfarë fshihej prapa këtyre «lidhjeve të farefisnisë». Ndërsa u premtonin shqiptarëve «respektimin e fesë e të za-

koneve», një farë «autonomie kulturore» sui generis, pa asnjë aspekt politik, qeveritë serbe e greke zhvillonin ndërkokë bisedime e hartonin plane të fshehta për ndarjen e tokave shqiptare.

Më 1877 u krijuan disa kontakte midis lëvizjes shqiptare e qarqeve zyrtare greke për të hetuar mundësinë e një aleance kundër ekspansionit të Malit të Zi e Serbisë, të përkrahur nga Rusia, por ato dështuan. Përvojën e këtyre orvatjeve e përmblodhi më vonë A. Frashëri me fjalët se qeveria greke (e kjo vonte po aq për atë serbe e malazeze) kërkonte në të vërtetë te shqiptarët «jo aleatë, por të nënshtruar».

Qëllimet e vërteta të përpjekjeve për të arritur «një bashkëpunim» me shqiptarët, ishin dukur më 1854 e 1866 e më në fund në shkurt 1878, me aksionet e bandave greke të hedhura fshehurazi në territorin shqiptar. Nga ana tjetër operacionet e luftës u dhanë më 1877/78 qeverive serbe e malazeze rast për të realizuar më në fund planet e tyre të vjetra, për të krijuar «Serbinë e Madhe» dhe «Zetën historike» në kurriz të tokave shqiptare. Ky ishte rasti më i volitshëm, që me ndihmën e Rusisë, të dy monarkitë të zbrisnin më në fund në rrafshinat e në tokat e buta të banuara prej shqiptarëve.

Ngjarjet treguan se aktorët kryesorë e vendimtarë në politikën ballkanike nuk ishin qeveritë e këtyre shteteve, por Fuqitë e Mëdha kapitaliste, që dolën nga prapaskena ku kishin qëndruar, atëherë kur kriza shpërtheu haptazi me disfatën e ushtrive osmane.

Traktati i Shën Stefanit që i jepte fund luftës sipas interesave të politikës cariste, dhe Kongresi i Berlinit, i cili pretendonte ta rishikonte të parin në favor të «ekilibrit» të Fuqive, ishin në fakt që të dy vepër e së njëjtës politikë imperialiste të Fuqive të Mëdha. Edhe kur përgatiteshin ta zhduknin Perandorinë Osmane nga Ballkani, edhe kur deklaronin se donin të ruanin ekzistencën e saj dhe status-kuonë, të dy grupimet zhvilluan të njëjtën politikë armiqësore ndaj popullit shqiptar dhe të drejtave të tij kombëtare themelore. Të dy i bënë tokat shqiptare gurë shahu dhe objekt kompensimi në lodrat e tyre politike, duke pritur një situatë të favorshme për ta zgjidhur definitivisht në favorin e vet çështjen ballkanike e me të edhe çështjen shqiptarë.

*
* *

Situata e krijuar në vitet 1877-1878 e detyroi lëvizjen shqiptare dhe organin e saj, Lidhjen, të vepronte në një luftë me dy fronte: Pa humbur nga sytë objektivin e luftës kundër Portës të ndiqte nga ana tjetër objektivin e luftës kundër pushtimit të tokave shqiptare nga Serbia e Mali i Zi, të cilëve iu shtua me Traktatin e Shën Stefanit edhe «Bullgaria e Madhe», e krijuar nga carizmi rus, e cila në shërbim të tij, fushte një pykë të thellë në tokat shqiptare, në drejtim të detit Adriatik.

Lufta në dy fronte, me dy objektiva, përbënte një veçori të lëvizjes shqiptare jo vetëm në vitet e Lidhjes, por deri në shpalljen e pavarësisë.

Dallimi i dy objektivave nuk do të thotë kurrsesi se njëri objektiv kishte përparësi përpara tjetrit. Një vlerësim i tillë do të thonte në të vërtetë të nënvleftësoje njërin kundrejt tjetrit. Ato përbëjnë një të tërë, një detyrë të vetme me dy anë që rrjedhin njëra nga tjetra, dhe plotësojnë njëra-tjetren.

Kjo veçori që e dallon mjaft lëvizjen shqiptare nga lufta politike që bënin shtetet ballkanike në këto vite, nuk jep kurrsesi të drejtë për ta përjashtuar këtë lëvizje nga fronti i luftës së përgjithshme kundër sundimit shekullor osman në Ballkan, bile për ta hedhur atë në anën e kundërt të barrikadës, siç e bëjnë ata autorë që e paraqesin Lidhjen si organ të Portës, dhe në luftën e saj kundër perandorisë nuk shohin asgjë tjetër veçse shpërthimin e pakënaqësisë së shqiptarëve, sepse kjo nuk paska ditur ose dashur të ndalonte lëshimet tokësore.

Në përgjithësi tek autorët e huaj, si edhe tek publicistika e sotme, zyrtare ose gjysmëzyrtare, që del në Jugosllavi, vihet re një moskuptim themelor i programit dhe rrjedhimisht edhe i gjithë veprimtarisë së Lidhjes.

Aty bëhet një ndarje antidialektike dhe antihistorike e qëllimeve të Lidhjes, duke mohuar lidhjen organike të kërkesave kryesore që cëndronin në programin e saj. Njohja e shqiptarëve si komb, një e i pandarë, implikonte logjikisht njëkohësisht edhe zbatimin tërësor të të drejtave të tij kombëtare; kjo donte të thonte se nuk mund të ndahej lufta për çlirimin kombëtar dhe për autonomi, nga lufta e Lidhjes për unitetin e trojeve shqiptare dhe kjo nga lufta për bashki-

min kombëtar në një shtet. Këto përbëjnë tri hallka të pashdashme njera nga tjetra. Të mohosh njérën e të pranosh tjetrën, do të thotë t'i mohosh të gjitha.

Këtu është rasti për të vënë në dukje, se qindvjetori i krizës lindore ka dhënë shkas për botimin e një literature të gjerë shkencore dhe joshkencore kudo në botë.

Me gjithë ndryshimet që kanë në dukje, shumë botime bashkohen në mbivlerësimin e rolit të Fuqive të Mëdha, duke konsideruar si faktor shpëtimtar, herë «të paqës» e herë «të popujve», politikën imperialiste të njërsë ose të tjetërë fuqi të madhe.

Sidomos historianët revizionistë nga Bashkimi Sovjetik, vazhdojnë përpjekjet për t'i «shpëtuar ftyrrën», për t'i «korrigjuar» karakterin grabitqar politikës imperialiste të carizmit rus, për ta paraqitur atë si përkrahës të luftës së popujve ballkanas. Siç e kamë thënë prej kohësh klasikët e mëdhenj Marksi e Engelsi, dihet se këtu ishte fjala për hegemoninë e Rusisë në Ballkan, për të dalë në «ujërat e ngrohta» të Mesdheut, duke futur në darën e vet Dardanelet nga ana e Bullgarisë, e aspak për t'i «ndihmuar» vëllezërit e krishterë të Ballkanit, në një kohë kur revolucionarët demokratë rusë shtronin së detyrë që populli rus vetë të çlyrohej nga zgjedha e «turqve të brendshëm», d.m.th. të carizmit.

Sidomos disa historianë bullgarë si K. Kosev dhe H. Hristov kanë zënë këtu pozita shumë «të avancuara». I pari deklaron me shumë guxim se lufta e Rusisë në vitin 1877 paska pasur bille karakter... «subjektivisht mbrojtës»²⁸; dyti nuk ngurron të deklarojë se Traktati i Shën Stefanit, me të cilin carizmi, duke krijuar «Bullgarinë e Madhe» synonte të vinte bazat e hegemonisë së vet në Ballkan, duke sakifikuar e copëtuar sidomos truallin kombëtar të shqiptarëve, paska qenë për atë kohë zgjidhja plotësisht e drejtë e çështjes së popujve ballkanas, se ai u përgjigjej plotësisht situatës etnike në këtë gadishull²⁹ dhe për ndonjë pasaktësi në këtë drejtim, ai edhe historiani sovjetik Naročnicki, në mënyrë nai-ve, bëjnë përgjegjës... disa «shkencëtarë perëndimore» të asaj kohe, që paskan dhënë informata jo të sakta...³⁰

28) K. Kosev, *Spisanie na BAN*, nr. 4, 1977, f. 63.

29) H. Hristov, *Istoriceski Pregled*, Sofje, 1977, nr. 5;6, f. 10; 12; 20.

30) V. Naročnickij në *Medjunarodni naučni Skup*, Tom. I, Sarajevo 1978, f. 36.

Studimet rreth Lidhjes e veprimtarisë së saj bëjnë pjesë në atë problematikë shkencore që pikërisht në ditët tona përjeton një ringjallje: dhe jo rastësisht. Tematika e formimit të kombeve e të lëvizjeve kombëtare për çlirim, për zhvillimin e lirë të kulturës nacionale të popujve, merr një rëndësi të veçantë pikërisht në ditët tona, në kushtet kur një varg popujsh janë çliruar ose duke luftuar për çlirimin e tyre, për identitetin e tyre kombëtar politik e kulturor.

Një literaturë e tërë e çdo ngjyre, përpinqet në këto kushta paraqesë kombin e luftën kombëtare si një kategori tashmë historikisht të kapérxyer. Kombet e shtetet sovrane kombëtare përbëkan tashmë një kuadër tepër të ngushtë, brenda të cilit popujt nuk paskan mundësi të realizojnë e zhvillojnë gjithë potencialin e forcave të veta ekonomike e kulturore, as të shfrytëzojnë fitoret e teknikës moderne. Nuk ka nevojë për të shkuar larg, për të treguar se vetë realiteti ynë i gjallë, i hedh poshtë këto «konstruksione».

Në këto kushte studimi i viteve të Lidhjes si pjesë e Lëvizjes së përgjithshme shqiptare për çlirimin kombëtar merr një rëndësi të veçantë në kuadrin e luftës ideologjike që bën sot Partia e Punës e Shqipërisë në plan kombëtar e ndërkombëtar.

* * *

Si çdo ngjarje e madhe që i ka rrënjet thellë në truallin historik, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si një lis vigan, i lëshon degët e veta përtëj viteve të veprimtarisë së saj — mbi dhjetëvjetorët pasardhës. Me programin e saj vepruan lëvizjet e fuqishme që shpërthyen në Shqipëri në vitet 1896-99 për të realizuar autonominë kombëtare dhe çuan në themelimin e Lidhjes së Pejës, në kryengritjet e viteve 1908-1912, në Kuvendin historik të Gerçës më 1911. Dhe kur patriotët shqiptarë, të nisur nga gjithë skajet e trojeve shqiptare, morën rrugën për të shkuar në Vlorë, në ato ditë të stuhishme të nëntorit 1912 që ngjisnim aq tepër me ato të fillimit të vitit 1878, ata e bënë me ndërgjegjen e plotë se po ecnin në rrugën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, po shkonin për të kryer e plotësuar detyrat që kishte lënë ajo.

28 nëntori 1912 — shpallja e pavarsisë kombëtare, krijuimi i shtetit sovran shqiptar, qenë kurorëzimi i një lufte të lavdishme, një ikum i parë i së cilës kishte qenë pikërisht

Lidhja e Prizrenit. Por detyra tjetër po aq e madhe, e ngritur nga Lidhja në plan ndërkombëtar, mbrojtja e tërësisë së trojeve shqiptare, bashkimi i tyre si kusht për realizimin e unitetit kombëtar, mbetën pa u realizuar. Në kushtet e luftës ballkanike, në kuadrin e politikës imperialiste të blloqeve që ndiqnin Fuqitë e Mëdha, dhe me ndihmën direkte të këtyre, qeveritë shoviniste ballkanike, gjatë mundësitetë për të realizuari synimet e tyre grabitqare në Ballkanin Perëndimor, mbi atë që ata e quanin trashëgimin e Perandorisë Osmane – e që ishin për një pjesë troje kombëtare shqiptare.

Traktati i Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit ishin prologu i një dënim i verdikti të egër imperialist që u zbatua më 1913 – me atë cungim e gjyqtimit territorial të pashoq që pësoi populli shqiptar, duke mbetur gjysma e trojeve të tij jashtë kufijve të shtetit kombëtar.

Në këtë rrugë historike, të çarë me shpatë e të larë me gjak, Lidhja Shqiptare e Prizrenit përbënte një ngjarje heroike, e cila krijoj një bazë për luftën e mëvonshme të popullit shqiptar për liri, pavarësi e përparim shoqëror. Sepse e kaluara nuk është thjesht një diçka e kaluar: ajo është pjesë përbërëse e së tanishmes, dhe i shërben së ardhmes – ky kuptim dialektik qëndron në themel të mësimave të Partisë e të shokut Enver, dhe shpjegon rëndësinë që ata u japin traditave për edukimin patriotik e revolucionar të popullit tonë.

Nga lartësia e fitoreve të arritura, populli shqiptar kthehet sot për të ndjekur me syrin e mendjes atë rrugë aq të vështirë, po aq të lavdishme, që bënë të parët e tij.

Luftëtarët e shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, figurat e ndritura të Rilindjes sonë Kombëtare janë sot më afër se kurrë pranë popullit të tyre, në mesin e popullit të tyre, sot që flamurin aq të shtrenjtë për ta të luftës për liri e pavarësi, për sovranitetin kombëtar, për demokraci e progres shoqëror, flamurin e së ardhmes së kombit shqiptar e mori dhe e mban në dorën e saj të çelniktë klasa punëtore shqiptare dhe po e çon në fitore të plotë, nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë e të themeluesit të saj shokut Enver Hoxha.

STEFANAQ POLLO

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT DHE LUFTA E SAJ PËR ÇLIRIMIN E BASHKIMIN KOMBËTAR

Në historinë e popujve ka momente apo periudha të tilla dramatike, kur në jetën e një brezi ndodhin ndryshime të thella që i rritin së tepërmi përmasat dhe i shpejtojnë në mënyrë të ndjeshme ritmet e saj. Të tilla janë edhe periudhat e afirmimit kombëtar të popujve, kur ideja kombëtare merr një shtrirje e thellësi të jashtëzakonshme e shndërrohet në një forcë materiale që vë në lëvizje klasa e shtresa të ndryshme të kombit. Ato hedhin në jetën aktive politike masat e gjera të popullit dhe, duke kapérxyer pengesat e shkaktuara nga prapambetja ekonomike e shoqërore, shpejtojnë shumë procesin e zgjimit kombëtar e të bashkimit politik të tyre. Një periudhë e tillë në historinë e re të popullit tonë ka qenë ajo e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në vitet 1978-1881, e kësaj «sfide të pashebullt», siç e ka përcaktuar shoku Enver Hoxha, që populli shqiptar u bëri imperialistëve e shovinistëve «për të sigruar lirinë dhe unitetin territorial të vendit»¹.

Kanë kaluar 100 vjet nga dita e themelimit të saj. Koha, ky gjykues objektiv i historisë, ruan si një thesar të çmuar e përjetëson ato figura dhe ato lëvizje që i kanë pasur rrënjët në popull e që kanë shprehur e realizuar aspiratat e tij. Tradita popullore edhe pas një shekulli vazhdon t'i ruajë Lidhjes së Prizrenit një vend nderi duke dhënë edhe vlerësimin përmirrat dhe përgjegjësitë historike të njerëzve dhe të klasave të asaj epoke.

Nga kjo largësi njëshekullore historiografia jonë është do-në gjendje të hedhë sot një vështrim kritik mbi gjithë do-

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 10.

kumentacionin e studimet që janë shkruar nga bashkëkohësit dhe brezat e mëvonshëm, nga shqiptarë e të huaj dhe, mbi bazën e filozofisë sonë marksiste, të bëjë një sintezë të re e të japë një gjykim objektiv mbi vendin, karakterin, rolin e pasojat historike të luftës së popullit tonë të udhëhequr nga Lidhja e Prizrenit, duke pasur parasysh mësimin e shokut Enver Hoxha që «Rilindasit tanë duhet të vihen drejt në epokën kur kanë jetuar, punuar dhe luftuar, duhet të vihen në dukje idetë e tyre, të cilat ishin prodhimi i zhvillimit të shoqërisë së asaj epoke...»².

Nga problematika e gjerë e kësaj periudhe, në këtë referat do të trajtohen ato probleme që lidhen me strategjinë dhe takтикën politike që Lidhja adoptoi në etapat e zhvillimit të lëvizjes, për të zgjidhur detyrat themelore që qëndronin para saj — çlirimin dhe bashkimin kombëtar.

* * *

Lidhja shqiptare e Prizrenit e viteve 1878-1881 është rezultante e bashkëveprimit të tre faktorëve themelorë: e lëvizjeve popullore antiosmane të periudhës së Tanzimatit, lëvizje që mbushin analet e historisë së viteve 40-70, e ideo-ologjisë së re të Rilindjes që kishte filluar të përpunohej e të pushtonote mendjet e zemrat e përfaqësuesve më të përparuar të inteligjencies shqiptare të kohës dhe e krizës lindore. të viteve 70 që rishtroi në rend të ditës, por tani me një forcë të veçantë, çështjen e fatit të mëtejshëm të kombit shqiptar, të tërësisë së territorit të tij dhe të çlirimit nga zgjedha shekullore osmane. Bashkëveprimi i këtyre faktorëve i dha lëvizjes kombëtare shqiptare të viteve 1878-1881 tipare e drejtime specifike dhe në mënyrë të veçantë një shtytje të fuqishme me përpjestime të tillë që nuk i kishte njojur historia e mëparshme e vendit nën sundimin osman. Bashkëveprimi i këtyre faktorëve shënoi nga ana tjetër fillimin e një etape më të lartë të lëvizjes kombëtare shqiptare që i dha Lidhjes së Prizrenit një fisionomi cilësisht, të re.

Lidhja e Prizrenit lindi mbi truallin e zjarrtë të kryengritjeve të mëdha popullore antiosmane të drejtuara kundër

2) E. Hoxha, *Raporte e fjalime 1967-1968*, Tiranë 1969, f. 369.

«reformave» të Tanzimatit, të cilat jo vetëm nuk i njihnin shqiptarët si kombësi më vete e u mohonin atyre të drejtën e shkrimit e të mësimit në gjuhën amtare por edhe forconin më tej shtypjen ekonomike e kombëtare. Sukseset dhe dështimet e këtyre kryengritjeve lanë si trashëgim një përvojë të pasur politike, organizative dhe ushtaraqe, nga e cila brezi i Lidhjes së Prizrenit nxori mësimë.

Në zjarrin e kësaj lufte popullore ishte thelluar urrejtja kundër administratës së re, të korruptuar, burokratike të Perandorisë Osmane dhe ishte shprehur aspirata e përgjithëshme për t'u veçuar nga ligjet dhe nëpunësit e Portës së Lartë e për t'u administruar nga njerëzit e vet.

Logjika e kësaj lufte i kishte quar kryengritësit te ideja e domosdoshmërisë së bashkimit të shqiptarëve, të bashkimit të të gjitha viseve të banuara prej tyre, jo vetëm për të përballuar me sukses një armik më të fuqishëm, por edhe për të dalë përpëra tij si një entitet i veçantë me kërkesa të përbashkëta. Shprehje organizative e kësaj domosdoshmërie kishin qenë kuvendet e «Lidhjet» ndërkrahinore dhe përpjekjet për të krijuar lidhje mbarë shqiptare.

Kjo aspiratë e përgjithëshme e bashkimit të shqiptarëve e të territoreve të tyre në një njësi të veçantë në sistemin e Perandorisë Osmane, që nisej nga konsiderata ekonomike e kombëtare, nuk kishte arritur ende të formulohej në një program të qartë e të plotë për bashkimin politik shtetëror të popullit shqiptar.

Pikërisht në këtë periudhë, në vitet 30-70, mbi bazën e kësaj përvoste të luftës çlirimitare të masave popullore të Shqipërisë, kishte filluar të përpunohej ideologjia e lëvizjes kombëtare. Të nisur nga fakti që kombi shqiptar përbënte një bashkësi territoriale, gjuhësore, shpirtërore dhe historike, ideo-logët e parë të Rilindjes sonë u përpoqën t'i drejtonin energjitetë luftarake të popullit shqiptar në një udhë të re, në udhën e arsimimit në gjuhën shqipe (N. Veqilharxhi), të bashkimit kombëtar mbi dallimet krahinore e fetare (Th. Mitkuai), në udhën e reformave ekonomike e shoqërore (Z. Jubani). Por këto ide nuk ishin shkrirë ende me lëvizjet çlirimitare të vendit.

Shkrirja e ideve kombëtare me lëvizjet popullore anti-osmane ishte një kusht i domosdoshëm për t'i nxjerrë ato nga caqet e vjetra lokale, për t'i vënë mbi baza të shëndosha organizative dhe për t'u hapur atyre një perspektivë të qartë duke u dhënë programin politik kombëtar. Ky ishte një pro-

ces i gjatë, i vështirë e i ndërlikuar në kushtet e prapambetjes së atëhershme ekonomike e shoqërore të vendit. Por ndërhynë në këtë mes faktorë të rinj politikë që shënuan një kthesë në ndërgjegjen popullore, që i shtynë rilindasit të lidhen ngushtë me masat e të veprojnë së bashku me to duke i shpejtuar në mënyrë të jashtzakonshme ritmet e këtij procesi. Këta faktorë ishin ngjarjet e stuhishme të brendshme e të jashtme të krisës lindore.

«I sëmuri i Bosforit», siç quhej Perandoria Osmane në atë kohë, edhe pse kishte pësuar goditje të forta nga lëvizjet çlirimtare të popujve të shtypur, vazhdonte të ruante ende forca të mjaftueshme dhe bënte çmos ta zgjaste jetën e sundimin e tij në Ballkan. Ekzistencën e saj e mbronin edhe Fugitë e Mëdha perëndimore. Të nisura nga interesat e tyre imperialiste dhe për shkak të kontradiktave midis tyre ato kishin gjetur në formulën e ruajtjes së «ekuilibrit të forcave» dhe në politikën e ruajtjes së tërësisë territoriale të Turqisë rrugën e mjetin pér të vendosur mbi të kontrollin e plotë ekonomik e politik dhe pér ta grabitur atë sistematikisht. Një rrugë tjetër, rrugën e luftës e të shembjes së Perandorisë Osmane ndiqte Rusia cariste pér t'u zmadhuar në kurri zë saj dhe, me pretekstin e mbrojtjes së interesave të popullsive sllave e të krishtera të Gadiashullit Ballkanik, të vendoste hegemoninë e saj në këtë zonë.

Brenda këtij kuadri vepronin edhe monarkitë ballkanike të mbështetura nga Rusia. Borgjezitë e këtyre vendeve kishin hequr dorë me kohë nga idealet çlirimtare e demokratike që frysmezuan revolucionet kombëtare në këto vende dhe kishin hartuar, qysh në vitet 40 të shekullit XIX projektet e një politike shoviniste e ekspansioniste që i kalonte caqet e bashkimit të tyre kombëtar dhe që synonte të krijonte shtete të mëdha në kurri zë popujve të tjerë të shtypur e sidomos të popullit shqiptar. Një politikë e tillë ishte e destinuar t'i përshtatej në një mënyrë ose në një tjetër lojës së madhe të interesave imperialiste që zhvillohej në këtë zonë.

Me këtë konstelacion forcash dhe interesash kontradiktore do të ndesheshin lëvizjet e popujve të shtypur, të cilat çuan në krisën lindore të viteve 70. Kryengritjet e popullit shqiptar ishin pjesë aktive e lëvizjeve popullore ballkanike të drejtuar kundër armikut të përbashkët shekullor. Objektivisht ekzistonin mundësitetë pér krijimin e një fronti të bashkuar anti-ottoman, lufta e të cilit do të shpejtonte çlirimin e bashkimin kombëtar të popujve të Ballkanit. Por kjo nuk ndodhi. Lufta

e Malit të Zi dhe e Sërbisë kundër Turqisë që filloi në korrik 1876, lufta ruso-turke e viteve 1877-1878 dhe përzjerja në çështjen lindore të Fuqive të tjera të Mëdha i dhanë krizës një drejtim tjetër, në përputhje me synimet ekspansioniste të shteteve borgjeze dhe në kundërshtim sidomos me interesat e popullit shqiptar.

Kriza lindore, me drejtimin e ri që mori krijoi për kombin shqiptar rrrethana kontradiktore. Lufta e shteteve ballkanike kundër Turqisë e dobësonte armikun shekullor, kurse fitoret e ushtrisë ruse paralajmëronin shembjen e Perandorisë Osmane. Për këtë arsyesh që shqiptarët nuk pranuan të shkonin si vullnetarë në radhët e ushtrisë turke me gjithë thirrjet e administratës osmane dhe masat që mori ajo për t'i dërguar në frontin malazez e rus. Por lufta kundër Turqisë dhe fitoret ruse, ndonëse mund të dukeshin pozitive për një popull të shtypur siç ishte populli shqiptar, do t'i sillnin atij jo vetëm një zhgënjim të hidhur por edhe rrezikun e tmerrshëm të copëtimit të territoreve të tij, me gjithë pasojat katastrofike që sillte me vete ky copëtim.

Veprimet luftarake të Serbisë, të Malit të Zi në territoret e banuara nga shqiptarët, të shoqëruara nga deklaratat zyrtare të qeverive përkatëse, tregonin qartë se për këta shtete kishte ardhur koha t'i realizonin me forcën e armëve projektet e tyre jo vetëm të çlirimt e bashkimit të tyre kombëtar por edhe të pushtimit e të copëtimit të Shqipërisë. Ky rrezik u ndje thellë, u prek, u përjetua atëherë kur vërvshuan dhjetra mijë shqiptarë të shpërngulur me forcë nga vatrat e tyre. Ushtritë serbe e malazeze të verbuara nga urrejtja kombëtare e fetare kundër shqiptarëve kishin zbatuar me fanatizëm porosinë e shtabit të komandës supreme serbe «Sa më tepér shqiptarë të shpërngulni me forcë, aq më të mëdha janë meritat tuaja para atdheut».³

Në këtë gjendje të elektrizuar bëhen të njoitura në Shqipëri nenet e traktatit preliminar ruso-turk të Shën-Stefanit sipas të cilave shteteve sllave të Ballkanit u kalonin vise të tërë shqiptare. Malit të Zi: Gucia, Plava, Vermoshi, Kelmendi, Kraja, Anamali, Hoti, Gruda, Tivari, Ulqini; Serbisë një pjesë e sanxhakut të Prishtinës deri në afersitë e Gjilanit e të Mitrovicës; Bullgarisë, Kumanova, Kaçaniku, Tetova, Gostivari, Dibra, Struga, Pogradeci, Korça etj. Viheshin në rre-

3) Jovan Haxhi — Vasiljević, *Arbanska Liga*, Beograd 1909, f. 14.

zik pra jo zona të veçanta kufitare por një pjesë e madhe e trevave shqiptare. Nuk mbetej veçse një hap i vogël për të bërë copëtimin e plotë të tyre.

Të gjitha këto krijuan në Shqipëri bindjen se tani ishte fjala për jetën e vdekjen e kombit shqiptar, për qënien apo zhdukjen e tij nga harta e Ballkanit. Nga kjo bindje shpërthyen manifestimet e protestat e fuqishme nga të katër anët e vendit dhe u realizua në mënyrë spontane mobilizimi popullor për vetëmbrojtje.

Gjendja e re që u krijua, vërtetë i dha një shtytje të fuqishme lëvizjes kombëtare shqiptare, por i ndërlidhi së të-përmë detyrat që qëndronin para saj. Krahës Perandorisë Osmane që mbetej armiku shekullor, populli shqiptar duhej të përbollonte në praktikë, në fushën e luftës, armiq të rinj e të fuqishëm. Lufta në dy fronte shtroi detyra të reja politike dhe organizative dhe nevojën e formulimit të një strategjje e taktkë politike të tillë që të merrte parasysh raportin e ri të forcave dhe të lejonte manovrimin me shkathtësi në labirintin e interesave kontradiktore të krizës lindore.

Kjo kërkonte, në radhë të parë, të bëhej hapi i ri i domosdoshëm që kishte munguar më parë: të krijohej një forum drejtues që të përfaqësonë gjithë kombin për të zhvilluar veprimtarinë e nevojshme politike brenda dhe jashtë vendit. Këtë detyrë e kreua «Komiteti Qëndror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare» që u formua në Stamboll më 1877 dhe ku morën pjesë mendjet më të ndritura shqiptare të kohës si Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Sami Frashëri, Jani Vreto, Zija Prishtina etj. Memorandumet e tij drejtuar Fuqive të Mëdha i bënë të ditur botës interesat dhe aspiratat e kombit shqiptar, kërkesat për njohjen e tij, për mos prekjen nga askush të trojeve të tij dhe për t'i bashkuar këto në një njësi të vetme administrative autonome shqiptare.

Lufta në dy fronte kundër armiqve të shumtë shtroi me forcë përparrë Komitetit problemin e aleatëve të mundshëm të popullit shqiptar në luftën e tij për clirim e bashkim kombëtar. I vetmi nga shtetet fqinjë ballkanike që nuk kishte hyrë zyrtarisht në luftë me Turqinë, që ndodhej jashtë sferës ruse dhe që ndjehej i kërcënuar gjithashtu nga eksplisioni i shtetëve borgjeze sllave, ishte Greqia. Por bisedimet e Komitetit me përfaqësuesin e qeverisë greke, që vazduan me ndërprerje disa muaj (korrik-dhjetor 1877) nuk patën sukses. Dëshira e shqiptarëve për të pasur në jug krahë të sigurta dhe ndihmën me armë nga ana e qeverisë së Athi-

nës, në luftën për t'u çliruar përfundimisht nga zgjedha osmane, luftë që do t'i lejonte edhe Greqisë të çlironte tokat greke nën sundimin osman, ndeshi në politikën e vendosur greke të «Idesë së Madhe». Zbarkimi në shkurt 1878 i çetave të andartëve grækë në tokat shqiptare afër Sarandës hoqi çdo shpresë për një aleancë shqiptaro-greke.

Ishte koha kur thirrjet për bashkëpunim nuk mund të gjennin jehonë pozitive, kur politikën në Ballkan e bënин Fuqitë e Mëdha dhe monarkitë reaksionare ballkanike.

Mbetet vetëm një mbështetje në luftën për realizimin e programit kombëtar — forcat patriotike e luftarake të popullit shqiptar. Në këto kushte, qendra e gravitetit të lëvizjes do të kalonte brenda në Shqipëri, ku duhej bërë një organizim i ri modern i forcave popullore, duheshin nxjerrë nga gjiri i tyre një udhëheqje e vetme kombëtare si edhe organizmat lokale për të krijuar atë armaturë të njësuar të lëvizjes që do të bashkërendonte veprimet politike, ushtarake dhe administrative dhe do të përfaqësonte në arenën ndërkombe të vullnetin e gjithë kombit shqiptar. Për këtë qëllim, u themelua në Prizren më 10 qershori 1878 Lidhja Shqiptare me përfaqësues të shtresave e të viseve të ndryshme të atdheut. Shpejtësia me të cilën u ngrit në këmbë kjo organizatë, rrjeti i dendur i komiteteve krahinore që mbuluan gjithë territorin e vendit dhe formacionet ushtarake vullnetare që u vunë në dispozicion të Lidhjes, dinamizmi dhe efikaciteti i saj gjatë gjithë periudhës së krizës lindore shpjegohen vetëm me faktin se ajo gjeti në Shqipëri një truall të përgatitur, një lëvizje masive që e mbështeti.

Në këtë lëvizje shkriheshin interesat kombëtare dhe ekonomiko-shoqërore të masave të gjera popullore nga njëra anë dhe të borgjezisë e të çifligarëve shqiptarë nga ana tjeter, të shqetësuar nga planet e copëtimit të vendit, nga pa-aftësia e Perandorisë Osmane për t'i mbrojtur trojet e kercënura dhe nga politika e saj antishqiptare. Ky front i gjerrë patriotik i ngritur mbi dallimet klasore, fetare e krahinore kishte anët e forta e të dobëta të tij.

Pjesëmarrja aktive në të e masave popullore dhe e përfaqësuesve të përparuar të borgjezisë kombëtare e të çifligarëve i jepte këtij fronti forcë e vitalitet dhe krijonte bazën për ta zhvilluar programin e vet çlirimtar e demokratik. Por Lidhja përfshiu në gjirin e vet edhe elementë çifligarë e klerikalë turkomanë që përqafonin platformën kombëtare vetëm në rastin e në atë masë kur kjo përputhej me interesat

e ruajtjes nga copëtimi të tokave shqiptare pra edhe të kufijve të Perandorisë Osmane. Mentaliteti e lidhjet e tyre shekulllore me Turqinë i bënин ata një faktor thellësisht konzervator në luftën për zhvillimin autonomist e demokratik të vendit.

Me formimin e Lidhjes mori një shtytje e zhvillim të mëtejshëm edhe mendimi politik shqiptar. Lidhja nuk mbeti thjesht një shtab operativ i lëvizjes. Është krijuar me nismën e Komitetit të Stambollit për të drejtuar lëvizjen në vend. Lidhja ishte vazhdëmisht nën kujdesin e tij. Me zhvillimin e stuhishëm të ngjarjeve, duke u shkrirë gjithnjë e më tepër me masat patriotike, në ndeshje me armiq të jashtëm e të brendshëm, Lidhja Shqiptare u forcua organizativisht e fitoi një autoritet të padiskutueshëm në mbarë vendin. Ajo u shndërrua në një organizatë të pavarur politike dhe ushtarake që i kishte rrënjet thëllë në tokën amtare e që populli e quajti thjesht «milet» d.m.th. «komb» duke mishëruar me këtë fjalë karakterin e saj. Në zjarrin e luftës e në kuvenet popullore ajo e pasuroi dhe e thelloi programin e vet politik. duke ia bërë atë të njojur edhe botës së huaj me vendimet e memorandumet e shumta dërguar Fuqive të Mëdha dhe Turqisë. Në emër të kombit shqiptar ajo paraqiti tri kërkesa themelore: a) njojen e kombit shqiptar si një e të pandarë dhe respektimin kundrejt tij të parimit të kombësisë në të gjitha drejtimet; b) ruajtjen e paprekshmërisë e të tërësisë së trojeve kombëtare shqiptare dhe c) bashkimin e tokave të Shqipërisë në një njësi të vetme me administratë shqiptare, gjuhë shqipe e kryeqendrën e vet.

Kongresi i Berlinit që u mblodh për të rishikuar traktatin e Shën-Stefanit në favor të Fuqive të Mëdha perëndimore, jo vetëm e mohoi qenien e kombit shqiptar e çështjen kombëtare shqiptare, por edhe vendosi copëtimin e pjesëve të truallit amtar në favor të shteteve fqinjë. Perandoria Osmane nga ana e vet, e mundur në frontet e luftës dhe e ndodhur përballë presionit të fuqive që synonin ta grabitnin atë, ishte e paafëtë për të mbrojtur kufijtë e veta dhe aq më pak për të mbrojtur nga copëtimi tokat e Shqipërisë. Për më tepër ajo ndiqte me këmbëngulje e fanatzëm një politikë të tërbuar antishqiptare duke mos i njojur popullit tonë as të drejtat kombëtare më elementare.

Në këto kushte Lidhja mori një duart e veta fatin e kombit duke deklaruar në arenën ndërkombëtare se kurkush nuk kishte të drejtë të vinte dorë mbi tokat e banuara prej shqip-

tarëve e t'i bënte ato monedhë këmbimi dhe se zot i vetëm i tyre ishte populli shqiptar.

Problemi i njohjes së kombit shqiptar, i tërësisë së tij territoriale d'he i luftës për mbrojtjen e saj zë një vend të rëndësishëm në mendimin politik dhe në gjithë veprimitarinë e Lidhjes. Shqyrtimi i tij nëpërmjet akteve të Lidhjes paraqet dy aspekte themelore: atë të vendit të territorit në konceptin që kishte Lidhja për kombin shqiptar dhe aspektin e zgjidhjes praktike të këtij problemi.

Territori kombëtar ishte për Lidhjen dhe për gjithë Rilindjen tonë një komponent i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i kombit shqiptar. Idetë e formuluara nga rilindasit e parë N. Veqilharxhi, Th. Mitko, Z. Jubani mbi kombin shqiptar gjetën një zhvillim të mëtejshëm në periudhën e Lidhjes së Prizrenit në shkrimet e S. Frashërit, P. Vasës, J. Vretos etj. kur u vu në rend të ditës çështja e njohjes së tij dhe e të drejtave të tij. Më 1879 Sami Frashëri shkruante se «gjithë ata njerëz që gjenden në një vent, e flasin një gjuhë edhe kanë një palë zakone e një farë të rojtur, thuhenë një komp».⁴⁾

Përkatësia kombëtare e territoreve të banuara nga shqiptarët mbështetej në konsiderata historike dhe aktuale. Tre elementët bazë që e përbënë atë ishin: karakteri historik, shumica e popullsisë që e banonte e që fliste të njëjtën gjuhë dhe kompaktësia e saj.

Në përcaktimin e karakterit historik të territoreve shqiptare Lidhja nisej me të drejtë nga fakti i pamohueshëm se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve. Si të tillë ata janë autoktonë në territoret e banuara prej tyre dhe pra zotër të pakontestueshëm të këtyre territoreve. Argumentimi i karakterit historik shqiptar të këtyre territoreve ishte i domosdoshëm për të hedhur poshtë teoritë e propagandën e çfrenuar antishqiptare të rretheve shoviniste të shteteve fqinjë që ose ua mohonin kombësinë shqiptare popullsive të krahinave jugore të vendit ose i konsideronin krahinat verilindore të atdheut si të pushtuara vonë nga fise shqiptare.

Karakteri historik shqiptar i këtyre territoreve përfokohej me dy argumentet e tjera: që në to shqiptarët përbënën pjesën më të madhe dhe kompakte. Të dhënat e akteve të Lidhjes mbi numrin e popullsisë shqiptare, të cilat konfirmo-

4) S. Frashëri, *Allfabetare e gjuhesë shqip*, Kostandinopojë 1879. f. 24.

hen edhe nga burime të tjera e çojnë numrin e shqiptarëve në territoret hisorike të tij në rreth 2 milionë.

Duke argumentuar teorikisht përkatësimë kombëtare të territoreve të banuara prej shqiptarëve Lidhja formuloi edhe zgjidhjen praktike të problemit. Kufijtë e territoreve shqiptare, sipas saj, përfshinin katër vilajetet e atëhershme: të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës.

Në këto vilajete pranë ose midis shqiptarëve që përbënë shumicën kishte edhe popullsi të huaja. Kërkesa e Lidhjes për të përfshirë në konceptin Shqipëri katër vilajetet nisej nga praktika e ndjekur në politikën ballkanike, e cila në përcaktimin e përkatësisë kombëtare të territoreve merrte përbazë ndarjen më të madhe administrative të Turqisë — vilajetin.

Duke u nisur nga fakti që në zonat periferike të këtyre vilajeteve ekzistonin popullsi jo shqiptare, Lidhja me të drejtë kërkonte që si kriteri vendimtar në përcaktimin e përkatësisë së tyre të merrej elementi që përbënte shumicën. Duke u siguruar pakicave të drejtat e tyre në bazë të normave ndërkombëtare dhe jo kriteri që i shërbente diplomacisë së monarkive fqinje dhe të Fuqive të Mëdha, sipas të cilit territoret shqiptare duhej t'u kalonin shteteve fqinje vetëm sepse kishte në to pakica të tyre kombëtare. Fakti që Lidhja luftoi në disa raste për të mos lejuar cënimin edhe të ndonjë territori me popullsi të huaj të përfshirë në një vilajet me shumicë shqiptare, shpjegohet, siç del prej akteve të saj me konsiderata ekonomike, e në mënyrë të veçantë me konsiderata politiko-strategjike të karakterit mbrojtës, përballë synimeve ekspasioniste të shteteve borgjeze fqinje për të copëtuar territoret shqiptare. E megjithatë, kjo nuk e mbyllte shtegun për një saktësim të mëtejshëm të kufijve me traktativa dypalëshe eventuale, me kusht që të sigurohej tërësia dhe paprekshmëria e trojeve shqiptare, siç e shfaqte shprehimi i Abdyl Frashëri në bisedimet shqiptaro-greke të vitit 1877. Rryma që i çonte kufijtë e territoreve shqiptare tej këtyre caqeve, megjithëse përkrahej nga disa rrethe me influencë e u pasqyrua edhe në ndonjë akt, si lëshim nacionalizmit shovinist të feudalëve, nuk arriti t'i imponohej vijës së përgjithshme të Lidhjes.

Duke i njojur territoret shqiptare si pjesë përbërëse e të paprekëshme të kombit, Lidhja luftoi me pushkë e me vendë për të mbrojtur tërësinë, paprekshmërinë e këtij territori nga orvatjet e shteteve fqinje, të përkrahura nga Fuqitë e

Mëdha, për ta copëtuar atë. Një veprim i tillë i ligjshëm buronte nga një kuptim i drejtë i realitetit shqiptar të kohës. Në gjysmën e dytë të shek. XIX kombi shqiptar po konsolidohej si një bashkësi territoriale, gjuhësore, ekonomike e shpirtërore. Është meritë e Lidhjes së Prizrenit që e konsideronte cënimin e një komponenti të rëndësishëm të kombit siç ishte territori si një shkelje të rëndë të së drejtës së tij për ekzistencë. Prandaj është pa bazë pohimi që është bërë në ndonjë vepër kushtuar Lidhjes se në luftën për tërësinë territoriale ishin të interesuar vetëm disa çifligarë të cilëve u prekeshin pronat e tyre ose disa fise anësore.

Për ruajtjen e tërësisë së këtyre territoreve shqiptare që bënин pjesë në Perandorinë Osmane ishte e interesuar edhe Porta e Lartë. E pafuqishme për t'i bërë ballë presionit të Fuqive dhe e lidhur nga traktatet ndërkombëtare të nënshkruara prej saj ajo u pérpoq t'i nxirrte gështenjat nga zjarri me duart e shqiptarëve. Duke u nisur nga ky interes Porta e Lartë në fillim kishte pranuar t'u jepte armë formacioneve ushtarake vullnetare të Lidhjes duke u orvatur në të njëjtën kohë të aktivizonte elementët turkomanë çifligarë e ikonikë për t'i dhënë lëvizjes karakter panislamiq, për ta mbajtur atë nën kontrollin e saj.

Duke parë në mënyrë të njëanshme vetëm interesin e përbashkët të Lidhjes dhe të Portës së Lartë për të mos lejuar lëshimin shteteve fqinje të territoreve të Perandorisë që ishin troje shqiptare, autorë të ndryshëm e kanë konsideruar Lidhjen e Prizrenit një vegël të Turqisë e lëvizjen e saj si një lëvizje turmash fanatike myslimanane. Si rrjetësimi është deformuar krejtësisht e në mjaft raste me qëllime të caktuara politike antishqiptare, gjithë luftha patriotike e popullit tonë e udhëhequr nga Lidhja në vitet 1878-1881. Në të vërtetë, me luftën e saj për të ruajtur të pâprekur tërësinë e territoreve shqiptare, Lidhja ia hoqi formalisht të drejtën Portës së Lartë dhe Sulltanit për të disponuar mbi to duke ia kthyer atë zotit të tyre të vërtetë – popullit shqiptar.

Lidhja shqiptare luftoi me të gjitha mjetet për të kundërshtuar vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit që i jepnin Malit të Zi e Greqisë toka shqiptare dhe i njihnin Serbisë ato që kishte pushtuar. Formacionet e armatosura të Lidhjes i vunë gjoksin Plavës e Gucisë dhe Hotit e Grudës duke i thyer ushtritë malazeze që kërkonin t'i pushtonin. Me po aq sukses Lidhja i mbrojti tokat shqiptare në jug që Kongresi i Berlinit rekomandonte t'i jepeshin Greqisë dhe bëri

që problemi kufitar këtu të mbetej i hapur e të përfundonte me heqjen dorë nga lëshimi i tyre.

Kur Fuqitë e Mëdha, pas dy dështimeve që pësuan vendosën t'i jepej Malit të Zi qyteti shqiptar i Ulqinit dhe dërguan flotën e tyre për t'i përkulur shqiptarët, Lidhja nuk ngurroi të ndeshej përsëri me armë kundër forcave të bashkërenduara të Malit të Zi, të Turqisë dhe të Fuqive të Mëdha.

Kërkesa tjetër themelore e programit të Lidhjes ishte, bashkimi i tokave të Shqipërisë në një njësi të vetme administrative autonome. Një kërkесë e tillë që ka qenë e pranishme në të gjitha aktet e Rilindjes sonë deri më 1912, buron te jo thjesht nga konsiderata të karakterit etnik.

Territori dhe popullsia shqiptare ishin ndarë në katër vilajete. Një ndarje të tillë të popullsisë shqiptare Porta e Lartë e zbatonte me qëllim që ta copëtonte administrativisht atë, të largonte rrezikun që mund t'i vinte nga një bashkim i saj dhe ta kishte më lehtë të provokonte kur ia donte nevoja konflikte midis elementeve të ndryshëm etnikë brënda një vilajeti ose midis tyre. E provon këtë më së miri fakti që gjatë periudhës së Lidhjes së Prizrenit, me qëllim që ta mposhtë më lehtë qëndresën shqiptare, Porta e Lartë bëri ndryshime administrative të vilajeteve shqiptare e sidomos të vilajetit të Kosovës që në këtë periudhë ishte një vatër e rëndësishme e lëvizjes shqiptare.

Bashkimi administrativ tërësor i territoreve shqiptare në një vilajet, provincë apo shtet të vetëm ishte kushti i parë i domosdoshëm për bashkinin kombëtar dhe për njësinë kombëtare. Duke folur për bazën ekonomike të lëvizjeve kombëtare. V. I. Lenini theksonte se: «për fitoren e plotë të prodhimit të mallrave, është i domosdoshëm pushtimi i tregut nga borgjezia, është i domosdoshëm bashkimi i territoreve me popullsi që flet të njëjtën gjuhë»⁵⁾. Pra bashkimi ishte njëkohësisht një kërkësë objektive që rridhte nga vetë zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit, nga vendosja e lidhjeve të ngushta ekonomike mids trevave shqiptare që kishin çuar në formimin e një tregu të përbashkët kombëtar. E ndodhur përballë qëndresës popullore gjithnjë në rritje dhe për ta neutralizuar atë, Porta e Lartë harto edhe një projekt për të plotësuar vetëm një kërkësë të Lidhjes duke krijuar një

5) V. I. Lenin, *Veprat*, vëll. 20, f. 452-453.

vilajet të Rumelisë ku do të përfshiheshin tokat shqiptare. Por ajo nuk guxoi ta vinte në jetë as këtë projekt dhe hoqi shpejt dorë prej tij.

Pjesë përbërëse e kërkesës për një vilajet ose shtet shqiptar ishte përcaktimi i karakterit të marrëdhënieve të tyre me Portën e Lartë e Sulltanin. Problemi është nga më të rëndësishmit. Trajtimi i drejtë e objektiv i tij hedh poshtë gjithë atë bagash shtrembërimesh të një pjese të dokumentacionit të huaj bashkëkohor e të historiografisë së mbështetur në të, autorët e të cilëve ose kanë qenë të verbuar nga paragjykimet mbi popullin shqiptar e nuk kanë pasur besim në zgjimin kombëtar të tij ose kanë qenë të interesuar politikisht të mbulonin të vërtetën.

I gjithë dokumentacioni i Lidhjes, ai osman dhe pjesërisht ai perëndimor flet për synimet herë të maskuara e herë të hapura të Lidhjes prej krijimit të saj e deri në fund, përt'i ndryshuar marrëdhëniet me Stambollin, për të fituar autonominë ose pavarësinë e vendit, pa hequr dorë për asnjë çast nga lufta për mbrojtjen e tërësisë së territoreve shqiptare. Autonomia për më tepër konsiderohej nga Lidhja si kusht i domosdoshëm për të zhvilluar me sukses luftën për mbrojtjen e tërësisë territoriale e për bashkimin kombëtar.

Në gjirin e Lidhjes ishin të pranishme të dy konceptet, si ai i autonomisë ashtu edhe ai i pavarësisë. Udhëheqësit më të ndritur e të përparuar të saj si Abdyl Frashëri, Sami Frashëri etj., shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Turqia e shihnin si variantin që mund e duhej të realizohej menjëherë në rast se krijojeshin kushte të favorshme. Këtë idë e kishte shprehur Komiteti i Stambollit qysh gjatë vitit 1877 në bisidimet me përfaqësuesin e qeverisë së Athinës për një aleancë shqiptaro-greke. Edhe pse këto bisedime dështuan, ideja e pavarësisë kumboi fuqishëm në memorandumin e 13 qershorit 1878 drejtuar kryeministrit anglez Bikonsfill dhe mbeti në rend të ditës edhe pas formimit të Lidhjes së Prizrenit. «Shqiptarët, i deklaronte një përfaqësues i Lidhjes gjeneralit rus E. Totleben, nuk dëshirojnë gjë tjetër veçse të bëhet për ta ajo që është bërë për kombësitë e tjera të Gadi-shullit Ballkanik: t'u njihet pavarësia dhe është drejta të krijojnë një principatë më vete»⁶. Shkëputja e plotë nga Turqia do të realizohej «pas punës» siç shprehej Sami Frashëri në let-

6) Arhiv Vnieshniei Politiki Rosii, F. «SPb gl. Arhiv, V-A2», fl. 605-606.

rën e vet drejtuar De Radës në shkurt 1881. Bindja e S. Frashërit në mundësinë e «shkëputjes fare» të Shqipërisë nga Turqia ishte aq e thellë sa ai mendonte edhe mënyrën si do të organizohej shteti i pavarur demokratik shqiptar. Por ndërsa kjo ide mbetej si një variant për t'u shpallur kur të plotësoheshin disa kushte optimale, autonomia territoriale e provincës së bashkuar shqiptare u bë platforma zyrtare e Lidhjes, e shprehur në pothuajse të gjitha aktet e saj, si etapë për të kaluar në pavarësinë e plotë.

Kërkesa e Lidhjes për autonominë kombëtare të Shqipërisë nën sovranitetin apo suzeranitetin e Turqisë, e cila mbeti e pandryshuar gjatë gjithë Rilindjes sonë kombëtare deri në pragun e shpalljes së pavarësisë, kushtëzohej nga faktorë të brendshëm e të jashtëm.

Lëvizja e viteve 1878-1881 ishte një lëvizje për çlirimin e bashkimin kombëtar, pra një lëvizje patriotike e interesuar të përfshinte në gjirin e vet të gjitha klasat e shtresat shoqërore të vendit. Lidhja u përpoo që frontin e bashkuar të këtyre forcave, ta ruante jo vetëm në luftën për mbrojtjen e tërësisë tokësore, por edhe në luftën për ndryshimin e raporteve me Portën e Lartë. Krijimi i një Shqipërie autonome gjente mbështetje në radhë të parë në masat popullore, të cilat, kishin luftuar për disa dhjetra vjet kundër vendosjes së administratës së huaj centraliste e burokratike osmane për të ruajtur vetëqeverisjen e tyre e administrimin me njerëzit e vet. Kjo mbështetje i dha fuqinë, sigurinë e besimin Lidhjes e sidomos krahut më të përparuar të saj për të ecur me guxim në realizimin e kësaj kërkesë.

Idenë e autonomisë duke ruajtur lidhjet e sovranitetit me Turqinë e mbështesnin përvçë borgjezisë kombëtare edhe një pjesë e çifligarëve që po lidheshin gjithnjë e më shumë me ekonominë e tregut dhe ishin të interesuar për zhvillimin e lirë të forcave të vendit.

Lidhja e konsideronte autonominë kombëtare një zgjidhje realiste të çështjes shqiptare, sepse kishte parasysh edhe veprimin e faktorëve të jashtëm. Në radhë të parë duhet thënë se vetë Porta e Lartë do ta pranonte më lehtë, në rast se do të ishte e detyruar ta bënte këtë, një autonomi të Vilajetit shqiptar duke ruajtur sovranitetin e saj në këtë zonë se sa një shkëputje të plotë të tij. Por faktori i jashtëm kryesor që e bëri Lidhjen dhe lëvizjen kombëtare shqiptare në përgjithësi të qëndronte në platformën e autonomisë ishte reziku serioz e i vazhdueshëm i copëtimit të tokave shqiptare nga

ana e shteteve borgjeze fqinje, rrezik që i qëndroi mbi kokë popullit tonë si shpata e Damokleut deri sa kjo u lëshua e pamëshirshme mbi të më 1913 nga fuqitë imperialiste duke e ndarë trungun shqiptar më dysh. Në këto kushte autonomia e Shqipërisë në kuadrin e Perandorisë Osmane mund të përfitonte përsa i përkiste tërësisë territoriale të atdheut qoftë nga interesi i Portës së Lartë për t'i ruajtur të paprekur kufijtë e Perandorisë, qoftë nga garancitë e Fuqive të Mëdha për të ruajtur statu-kuonë e saj.

Koncepti autonomist i Lidhjes ka pësuar evolucionin e vet, që nga Kararnameja, akti kushtetues i Lidhjes, e deri te formimi i qeverisë së përkohshme e lufta e hapur kundër Turqisë në etapën e fundit të saj. Ky evolucion ka qenë përcaktuar nga rrjedha e ngjarjeve, nga rritja e mobilizimit dhe e luftës popullore dhe nga zhvillimi i përgjithshëm i ndërgjegjës kombëtare. Megjithëse Komiteti i Stambollit kishte qenë për autonominë ose pavarësinë e vendit qysh para themelimit të Lidhjes, Kararnameja nuk e formuloi atë në mënyrë të qartë e të plotë.⁷ Detyra e saj ishte të organizonte në luftrën për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Atdheut që ishte detyra themelore imediate, të gjitha forcat shoqërore të intresuara, duke shfrytëzuar edhe interesin që kishte Porta e Lartë në ruajtjen e kufijve të Perandorisë dhe sidomos duke mos provokuar një reagim të menjëherëshëm të administratës osmane dhe të atyre elementëve lokalë cifligarë e klerikalë turkomanë që mund ta shtypnin Lidhjen që në vezë. Por qysh në këtë akt, duke mos lejuar Portën e Lartë të përzihej në asnjë mënyrë në punët e Lidhjes, sanksionohej e drejta e vërvëprimit të Lidhjes pa pyetur Portën e Lartë, dhe siç u vërtetua më vonë, në kundërshtim me të. Ngjarjet që e pasuan menjëherë 10 qershorin, shpërthimi i patriotizmit populor kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit, e rritën së tepërmë brenda pak javësh autoritetin e Lidhjes dhe i dhanë asaj mundësinë që të dilte qysh në muajin korrik me kërkesa të karakterit autonomist për t'i formuluar ato në një kuvend të përgjithshëm në Dibër, në nëntor 1878. Programi i Dibrës parashfronte bashkimin e Shqipërisë në një vilajet të vetëm me qendër në mes të Shqipërisë, me nëpunës që të dinin gjuhën shqipe, me shkolla të shtrira në të gjitha anët ku të

7) *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, Tiranë 1978, f. 40-42.

mësohej edhe gjuha shqipe, me një kuvend të përgjithshëm që do të zbatonte reforma të dobishme pér vendin e që do të kishte të drejtën të përdorte një sasi të mjaftueshme të të ardhurave të vilajetit pér nevojat lokale.⁸ Ky ishte programi i krijimit të një vilajeti apo province autonome shqiptare.

Evolucioni i konceptit autonomist të Lidhjes është i lidhur ngushtë me luftën e brendshme ideologjike e politike që bëhej në radhët e saj, në organizatat qëndrore e lokale. Edhe pse autonomia, me ruajtjen e sovranitetit osman, tërhiqte përvëç masave popullore edhe kategori të tjera shoqërore, ajo nuk mund ta ruante të paprekur atë front të gjerë që u krijuat atëherë kur ishte fjala pér ruajtjen e tërësisë territoriale të atdheut. Rrethet borgjeze, çifligare e klerikale turkomane me influencë, si edhe ato rrethe shqiptare të burokracisë osmane të lidhura me Portën, të cilat e përfqafonin këtë platformë vetëm në rastin e prishjes së Perandorisë Osmane, ishin gati të hiqnin dorë nga kjo kur të konsolidohej pushteti osman dhe Porta të ishte në gjendje të kundërvepronte. Lëkundjet e këtyre rretheve u bënë shkak pér diferençimin në radhët e Lidhjes që u manifestua qartë qysh në muajt e parë dhe vazhdoi të thellohej në vitet e mëvonshme e të bëhej shkak pér ndryshime të herëpasherëshme në përbërjen si të Komitetit Qendror të Lidhjes ashtu edhe të komitetetve lokale të saj. Ardhja e elementeve «radikalë», të aksionit dhe autonomistë në këto komitete, të cilët përfaqësonin kryesisht «shtresat e ulta», siç e venë në dukje dokumentet e kohës, apo krijimi i komiteteve të reja nga këta elementë i shtyu bashkëkohësit ose disa autorë të mëvonshëm ta krahasonin Lidhjen me «Komitetin e Shpëtimit Publik» apo me «Komunen e Parosit». Ata donin me këtë të theksonin jo analogjité historike por karakterin radikal të vendosur të veprimtarisë së krahut më të përparruar të saj e sidomos të fshatarëve e të vegjëlisë qytetare, të cilët, sipas shprehjes së J. Jastrebovit, «s'kishin q'të humbisnin në rast se veprimet e tyre ndëshkoheshin»⁹ dhe të cilët nuk u ndalën para asgjëje pér të realizuar qëllimet që i kishin vënë vetes. Kjo përtëritje sociale i dha mundësinë Lidhjes në tërësi të vepronë më energjikisht në të gjitha drejtimet, të

⁸⁾ *Akte të Rilindjes kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, Tiranë, 1978, f. 69-70.

⁹⁾ *Arhiv Vnieshniei Politiki Rosii*, F. «Posolstvo v Kostandinopole» d. 2079, fl. 10.

zhvillonte në shkallë të gjërë luftën politike dhe diplomatike për mbrojtjen e tokave shqiptare në jug në janar-mars 1879 dhe luftën e armatosur për mbrojtjen e tokave shqiptare në veri në tetor 1879 – prill 1880 dhe të bënte një hap më tej e ta ngrinte në një shkallë më të lartë platformën e autonominisë. Kuvendi i Gjirokastrës i 23 korrikut 1880 ku morën pjesë përfaqësues të krahinave të ndryshme të jugut dhe të veriut, miratoi programin e ri të paraqitur nga Abdyl Frashëri që kërkonte krijimin e një shteti autonom shqiptar me një qeveri të përkohëshme të vetën, me qendër në një qytet në mes të Shqipërisë, me një administratë krejt shqiptare ku do të merrnin pjesë nëpunës pa dallime fetare, e cila do të kishte të drejtën, përveç një detyrimi vjetor në të holla ndaj Portës së Lartë, të përdorte për nevojat e vendit pasuritë dhe të ardhurat shtetërore, me ushtrinë e vet që do të vihej në shërbim të Perandorisë vetëm në rast lufte etj.¹⁰

Programi autonomist i Gjirokastrës shënon etapën e dytë në luftën e Lidhjes për autonominë territoriale e administrative të Shqipërisë.

Për Komitetin e Stambollit dhe për udhëheqësit e përpunuuar të Lidhjes autonomia shqiptare jo vetëm mbësh-tetej mbi një territor të caktuar kombëtar por edhe kishte një përbajtje ekonomike shoqërore e kulturore që u përgjigjet interesave të zhvillimit kapitalist të vendit. Ky koncept i autonomisë që përshkohej fund e krye nga një frymë kombëtare e demokrtike ngrihej jo vetëm mbi krahinarizmat e interesat e ngushta lokale që binin në kundërshtim me idenë e bashkimit e të njësisë kombëtare, por edhe mbi prirjet për t'u kthyer tek institucionet shoqërore të së kaluarës (te kanuni i Lekë Dukagjinit, Sheriati etj.), të cilat, megjithëse ishin shprehje e rezistencës ndaj legjislativit të ri e administratës së sundimitarëve të huaj osmanë, e tërhiqin shoqërinë shqiptare prapa. Lidhja pati meritën historike t'i ngrejë kërkesat e masave popullore në shkallën e kërkesës për autonominë kombëtare e demokratike, për t'i dhënë Shqipërisë, siç shkruante Pashko Vasa më 1879 «... një riorganizim të fortë, homogjen, kompakt në përputhje me nevojat e saj dhe me karakterin e popullsive të saj, që ajo të vihet, me anë reformash rrënjosore, në gjendje të zhvillojë zgjuarsinë, pasurinë dhe fuqinë

10) Akte të Rilindjes kombëtare Shqiptare (1878-1912), Tiranë 1978, f. 112.

e vet ushtarake»,¹¹ platformë kjo cilësisht e re dhe e përparruar.

Realizimi i autonomisë kushtëzohej me njohjen formale të saj nga ana Portës së Lartë. Po kjo njohje nuk i erdhë Lidhjes asnjëherë. Qeveria e Stambollit, e cila shpresonte me fanatizëm ta përdorte popullsinë myslimanë shqiptare në Perëndim ashtu si arabët në Lindje si bastion të shtetit teokratik osman, përdori të gjitha mjetet për të mos u njohur shqiptarëve jo vetëm autonominë e kërkuar por edhe të drejtat më elementare kombëtare dhe për të shtypur e likuiduar çdo përpjekje e veprim të tyre në këtë drejtim. Në qoftë se Lidhja megjithatë guxoi të ngrihej hapur kundër kësaj politike e të kërkonte autonominë, kjo flet për autoritetin e madh të saj, për mbështetjen e fuqishme që kishte në popull dhe për fizionominë e saj politike si organizatë që ishte vënë në shërbim të interesave kombëtare të atdheut, e vendosur t'i mbronte ato me gdo kusht.

X Lufta e Lidhjes për njohjen e kombit shqiptar si një e të pandarë, për ruajtjen e tërësisë së trojeve kombëtare dhe për bashkimin e tyre në një njësi të vetme shtetërore, i përgjigjej një kërkese të ligjëshme objektive e subjektive të zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Tri detyrat themelore të platformës së saj përbën tri hallka të pa-nashme nga njëra-tjetra. Njohja zyrtare e kombit shqiptar nuک ishte një akt i thjeshtë regjistrimi. Në rrethanat kur ekzistencën e tij e mohonin si Turqia ashtu edhe Fuqitë e Mëdha e aq më tepër shtetet borgjeze fqinje ajo merrte një kuptim të madh politik. Me njohjen e kombit shqiptar lidhej domosdoshmërisht njohja e territorit të shtrirjes së tij, e kufijve të tij. Me këtë bëhej hapi i nevojshëm për të dalë te ideja po aq e rëndësishme e ruajtjes së tërësisë dhe të njësisë së këtyre territoreve si një kusht themelor për njësinë kombëtare. Në bazë të luftës që bëri Lidhja përmbrojtjen e tërësisë së tokave shqiptare dhe për bashkimin e tyre në një njësi të vetme administrative qëndron koncepti i drejtë se nuk mund të ketë komb pa territor të vetin dhe nuk mund të ketë njësi kombëtare pa njësi territoriale. Këto ide të Lidhjes gjenin plotësimin logjik të tyre në detyrën e tretë, në atë të realizimit të kësaj njësie territoriale kombë-

11) Vassa Effendi, *La Verité sur l'Albanie et les Albanais*, Paris 1879, f. 92.

tare në kuadrin e një shteti kombëtar shqiptar autonom ose të pavarur.

C'taktikë ndoqi Lidhja sa kohë që priste njohjen zyrtare të autonomisë shqiptare nga ana e Turqisë? T'i përgjigjesh kësaj pyetjeje do të thotë të vesh në dukje një veçori dalluese thelbësore të veprimtarisë së Lidhjes dhe pikërisht ushtrimin nga ana e saj e me nismën e vet të funksioneve qeverisëse, duke realizuar në praktikë, në një masë të caktuar, autonominë. Me përforcimin e pozitave të saj, duke shfrytëzuar atmosferën e ndezur patriotike, kërkesat që impononte mbrojtja e nismat e shumta popullore përvetëgoverisje si edhe faktin që ajo kishte përballë saj një administratë osmane sa të interesuar përmbytjen e kufijve të Perandorisë aq edhe të paralizuar e të paaftë për të kundërshtuar aspiratat e veprimet autonomiste të shqiptarëve, organet e Lidhjes, duke vepruar «në emër të popullit shqiptar», u shndërruan dora dorës diku më shumë e diku më pak, diku me dublim e diku me zëvendësim në organe qeverisëse që zëvendësuan në fakt administratën osmane në plan të brendshëm e të jashtëm.

Organet e Lidhjes, duke e njohur Sultanin si kryetar të fesë islamike, nuk i nënshtrohen në atij të cështjet civile dhe ushtarake. Të gjitha vendimet e Valiut osman i kalonin per miratim Komitetit Qendror të Lidhjes dhe të gjitha urdhërat e administratës osmane konsiderohen nga organet e Lidhjes vetëm si këshilla. Ky dypushtet i fazës së parë u zëvendësua gradualisht me pushtetin e Lidhjes. Ajo filloi t'i shkarkojë nëpunësit turq e t'i zëvendësojë ata me shqiptarë, krijoj e vuri nën urdhërat e veta formacionet ushtarake vullnetare dhe repartet e xhendarmërisë, shpërndau gjyqet turke dhe krijoj gjyqet shqiptare me anëtarë të besimeve të ndryshme. Lidhja zbatoi një politikë ekonomike në përshtatje me kushtet e luftës e me nevojat e saj duke kërkuar kontributet veçanërisht nga klasat e pasura e duke i neutralizuar ngurrimet e tyre «me anë të vegjëlisë», zbatoi rekrutimin e detyrueshëm përmbytjen e vendit duke mos pranuar sistemin e vjetër të bedelave që nuk përputhej me konceptin patriotik të detyrës së mbrojtjes së atdheut si detyrë për të gjithë, pavarësisht nga gjendja ekonomike etj. Në trevat ku Lidhja vendosi autoritetin e saj e vendos qëtësia që u detyruan ta vinin në dukje edhe kundërshtarët e saj, u ndalua hakmarrja, u ndoqën keqbërësit etj., me një fjalë u vendos ai rregull që nuk e kishin njohur asnjëherë

këto treva nën pushtetin osman. Në gjithë veprimtarinë e tyre, komitetet e Lidhjes iu përbajtën parimeve të shpalitura qysh në memorandumet e para mbi respektimin e të drejtave të barabarta midis elementeve me fe e kombësi të ndryshme në territoret shqiptare dhe i zbatuan këto parime në praktikë. Ato dënuan ashpër rastet e keqpërdorimeve e të krimeve të kryera kundër elementeve jo shqiptarë dhe ndaluan rekrutimin e shqiptarëve në repartet turke të destinuara për të shtypur lëvizjen qirimtare maqedonase.

Por Lidhja veproi si organ përfaqësues i interesave të kombit shqiptar edhe në arenën ndërkombëtare. Politika e saj e jashtme për njohjen nga ana e Fuqive të Mëdha dhe e shteteve fqinje e kombit shqiptar dhe e të drejtave të tij përbën një kapitull të veçantë të veprimtarisë së Lidhjes. Memorandumet e protestat e saj pranë këtyre shteteve si edhe veprimtaria e delegacionit zyrtar të saj të kryesuar nga Abdyl Frashëri pranë kancelerive të Fuqive të Mëdha në pranverë 1879 janë akte të pavarura të veçuara nga Porta e Lartë e në kundërshtim me politikën e saj.

Këto veprime të pavarura, vetëqeverisëse të Lidhjes i kishin acuar shumë marrëdhëni e saj me Portën e Lartë. Kthesën e fortë në këto marrëdhënie e shënuan ngjarjet që u zhvilluan në gjysmën e dytë të vitit 1880. Ato e vunë Lidhjen jo vetëm përballë presionit gjithnjë më të madh të Fuqive të Mëdha e të shteteve fqinje por edhe përballë konfliktit të hapur ushtarak me Turqinë, e cila kishte vendosur ta shtypte me armë qëndresën shqiptare për t'i dorëzuar Ulqinin Malit të Zi.

Ndeshjet e përgjakëshme të Lidhjes me ushtrinë osmane për mbrojtjen e Ulqinit dhe dorëzimi i tij Malit të Zi nga Dervish Pasha hapën rrugën për të bërë hapin tjetër të guximshëm drejt autonomisë. Armiqësia e hapur me Portën e Lartë që shpërtheu e u shtrit në krahina të ndryshme të vendit sidomos në Kosovë i lejuan Lidhjes të realizonte atë që kishte kërkuar në Kuvendin e Gjirokastrës. Në janar 1881 Komiteti i ri qendror që ishte formuar në Prizren me përfaqësuesit më të pérparuar e luftarakë të Lidhjes u shpall «qeveri e përkohëshme» («kuvernë e përdorme» siç e quante atë Sami Frashëri) e kryesuar nga aktivisti i shquar i Lidhjes Ymer Prizremi.

Ky akt i rëndësishëm historik, masat e mëtejshme administrative që mori qeveria autonome shqiptare, përpjekjet për të shtrirë autoritetin e vet në të gjitha trevat shqip-

tare dhe sidomos lufta e saj e hapur me armë kundër Turqisë për ta mbrojtur autonominë e shpallur, shënonin etapën më të lartë të luftës së popullit shqiptar për autonominë territoriale e administrative të vendit.

Autonomia shqiptare në këtë etapë u krye me dhunë të shpallur publikisht. Ajo shkoi «tepë larg», siç thonë vëzhguesit e atëhershëm dhe i dha fund edhe formalisht ekzistencës e administratës osmane në territoret e kontrolluar nga qeveria e përkohëshme. Pikërisht në këtë etapë kur Lidhja mori plotësish në duart e veta drejtimin e vendit, kur Abdyl Frashëri lëshoi thirrjen: «... të bëjmë Shqipërinë e bashkuar» u zhvilluan në dimensione të reja aftësitë organizuese administrative dhe ushtarake të Lidhjes. Pranvera e vitit 1881 ishte një pranverë edhe në jetën politike e shoqërore kur masat shijuan lirinë e vërtetë të veprimit si zotër të atdheut të tyre. Energitë e pashtershme të popullit, patriotizmi i tij i flaktë e disiplina e ndërgjegjshme, kushte këto të domosdoshme për një jetë të përparuar shtetërore, i dhanë Lidhjes forcën e guximin për t'u ngritur e vetme kundër Perandorisë Osmane e për t'u ndeshur me ushtritë e panumërtë të saj.

Me krijimin e qeverisë së përkohëshme komitetet lokale të Lidhjes shndërrohen në organe vartëse administrative të saj dhe formacionet e armatosura në ushtri kombëtare. Po viheshin në jetë vendimet e Kuvendit të Gjirokastrës. Në këtë kohë zë fill formimi i shtetit autonom kombëtar shqiptar.

Qeveria e përkohëshme e shtriu autoritetin e vet brenda një kohe të shkurtër në vilajetin e Kosovës e në një pjesë të vilajetit të Manastirit ku gjeti një truall të përgatitur nga veprimtaria e dendur që kishte zhvilluar Lidhja në këto treva dhe një popullsi liridashëse, të gatëshme për ta mbështetur atë. Por ajo nuk arriti të përfshinte nën autoritetin e plotë të saj të gjithë territoret kombëtare e të realizonte edhe detyrën po aq të rëndësishme të bashkimit të tyre nën udhëheqjen e qeverisë së përkohëshme. Ushtritë Osmane e detyruan qeverinë e re e të pamëkëmbur plotësisht ta bënte pagëzimin në zjarr e të mbronte me luftë ekzistencën e shkurtër të saj derisa u shtyp egërsisht prej tyre.

*
* *

Për herë të parë në historinë e vendit, pas epokës së lavdishme të Skënderbeut, Lidhja i drejtoi e i bashkoi përrënjtë e lëvizjeve çlirimtare shekullore në lumin e gjéré të lëvizjes kombëtare që vërshoi i fuqishëm e i pandalshëm duke çarë shtigje të reja e duke kapërxyer pengesa të panumurta që gjatë më shumë se katër shekuj robërie të rëndë ishin ngritur në rrugën historike të popullit shqiptar. Duke bërë të vetin trashëgimin pozitiv që kishin lënë dhjetëvjeçarët e mëparshëm, ajo e ngriti luftën e popullit tonë në një shkallë të re më të lartë, në të gjitha fushat — në atë ideologjike, politike, kulturore, organizative, ushtarake dhe diplomatike.

Gjatë historisë së saj trevjeçare, Lidhja afirmoi parime e konsakroi praktika të tilla revolucionare të luftës për çlirim e bashkim kombëtar që i bëjnë asaj nder dhe që mbeten në themel të gjithë Rilindjes sonë kombëtare.

Lidhja vërtetoi se populli shqiptar, ashtu si gjithë popujt e tjerë, ruante energji të pashterrshme dhe një vetëdije kombëtare që e ngriten atë në piedestalin e historisë si një komb me histori, tradita, gjuhë e kulturë të vetën, si një komb që me armë e me pendë, me patriotizmin, vitalitetin, e vendosmérinë e tij iu imponua, edhe pse i vogël dhe i vetëm, Fuqive të Médha kapitaliste e monarkive ballkanike fqinje.

Lidhja si lëvizje kombëtare, për nga karakteri e përbajtja e saj nuk ishte një dukuri e veçuar as në rrafsh ballkanik dhe evropian. Edhe pse kishte tipare dalluese që përcaktoheshin nga kushtet konkrete historike në të cilat ajo u zhvillua, Lidhja ishte pjesë përbërëse e lëvizjeve çlirimtare kombëtare që karakterizonin historinë e Evropës dhe të Ballkanit në shek. XIX. Lëvizjet kombëtare kishin bërë që në skenën politike të dilte me forcë problemi i çlirimtë kombeve të shtypur dhe i bashkimit të tyre, i shoqëruar me një literaturë të tërë politike e shoqërore demokratike përparimtare mbi parimet e kombësisë. Rilindasit që udhëhoqën lëvizjen kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe Lidhjen e Prizrenit në veçanti ishin ndriçuar nga këto ide të demokracisë revolucionare evropiane. Zbatimi i tyre në kushtet e vendit, i pasuruar me përvojën shqiptare i dha Lidhjes një orientim të drejtë përparimtar e kombëtar. Këto ide patën sukses në Shqipëri sepse gjetën këtu një truall të preqatitur nga

lëvizjet e gjëra populllore antiosmane dhe forca ekonomiko-shoqërore të tilla në radhët e borgjezisë kombëtare që po zhvillohej dhe të çifligarëve të lidhur me tregun që i përvetësuan ato si ide të cilat u përgjigjeshin interesave të tyre klasore e kombëtare.

Për të realizuar këto synime të saj Lidhja ndoqi rru-gjen e luftës së armatosur që ishte rruga e vetme e efektëshme e afirmimit kombëtar dhe e mbrojtjes së qënies së saj në kushtet kur Fuqitë e Mëdha kapitaliste, Perandoria Osmane dhe shtetet borgjeze fqinje ndiqnin politikën e mohimtë kombësisë shqiptare dhe të të drejtave të saj.

Nëpërmjet kësaj lufte Lidhja realizoi bashkimin e popullit shqiptar nën një udhëheqje të vetme dhe me një program të përbashkët kombëtar duke u ngritur mbi ndarjet krahinore e fetare dhe kundër ideologjisë së unititetit panislamik, hap ky shumë i rëndësishëm në kushtet e Shqipërisë së atëherdhme.

Në viset imediatishët të kërcënua dhe ku Lidhja zhvilloi luftime me armë kundër armiqve bashkimi i popullit arriti një shkallë veçanërisht të lartë, siç u manifestua sidomos në viset e Kosovës, Dibrës, Shkodrës, Malësisë së Veriut dhe Çamërisë.

Luftha çlirintare e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit frymëzoi mendjet më të ndritura të kulturës shqiptare, të cilat u vunë në shërbim të saj, jo vetëm për të argumentuar e mbrojtur programin kombëtar, por edhe për të zhvilluar me ritme më të shpejta lëvizjen kulturore si pjesë përbërëse e të pandarë të lëvizjes kombëtare.

Në vitet e stuhishme të Lidhjes qëllimi i madh bëri të lindin energji të mëdha e njerëz të mëdhenj. Nga gjiri i saj dolën udhëheqës të shqar të pushkës e të penës, organizatorë e statistë, diplomatë e shkrimitarë si Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi dhe Ymer Prizreni, Sami Frashëri e Pashko Vasa, Jani Vreto e Iljas Dibra, Shuaip Spahiu e Thimi Mitko, Mic Sokoli e Ali Ibra dhe dhjetra e dhjetra të tjera që historia jonë do t'i përmendë me respekt e dashuri për kontributin e tyre në shërbim të interesave të larta të kombit.

Edhe pasi u shtyp Lidhja shqiptare e Prizrenit la gjurmë të pashlyera në vetëdijen e kujtesën popullore dhe ushtroi një ndikim të thellë në ngjarjet e mëvonshme të Rilindjes sonë kombëtare, të cilat vërtetuan atë që thoshte Thimi Mitku

në qershor të vitit 1881 «Shqipëria nuk fitoi dot në luftë por nuk u prish, nuk u fal, nuk i dha armët».¹²

Shqipëria nuk i dha armët. Populli e vazhdoi pandërprerje luftën për çlirimin e bashkimin e tij kombëtar duke iu referuar në momentet kyçë Lidhjes Shqiptare të viteve 1878-1881, shembullit e programit të saj.

Akti historik i Kuvendit të Vlorës me shpalljen e pavarësisë dhe formimin e shtetit kombëtar në nëntor të vitit 1912 e coi deri në fund një nga detyrat themelore të Lidhjes, atë të çlirimt kombetar por Fuqitë e Mëdha imperialiste dhe monarkitë fqinje, me të cilat Lidhja ishte ndeshur qysh në periudhën e krizës lindore të viteve 1878-1881, nuk e lejuan të zgjidhë detyrën tjetër të rëndësishme — atë të bashkimit të territoreve shqiptare në një njësi të vetme shtetërore. Gjysma e tyre, me vendim të këtyre fuqive kaloi nën zgjedhën e huaj.

Gurët që vunë në themelet e pavarësisë shqiptare Lidhja e Prizrenit dhe Kuvendi i Vlorës u cimentuan me gjakun e mijra dëshmorëve, me mundin e djersën e një populli të tërë në vitet e paharruara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në epokën e ndritur të socializmit kur nën udhëheqjen e Partisë shqiptarët shkruan e vazhdojnë të shkruajnë faqet më të lavdishme të historisë së tyre, kur ata ruajnë sytë e ballit lirinë e pavarësinë për ta bërë atdheun shumë më të fortë e të begatshëm nga ç'e patën ëndërruar edhe mëndjet më të ndritura të së kaluarës.

12) AQH i RPSSH, F. Jeronim De Rada, d. 54/5.

ARBEN PUTO

LIDHJA SHQIPTARE PËR MBROJTJEN E TË DREJTA- VE TË KÖMBIT NË VITET E KRİZËS LINDORE

I.

Në marrëdhënet e Perandorisë otomane me popujt dhe kombësitë që përfshihen brënda saj, si dhe me fuqitë evropiane, lufta ruso-turke e ytit 1877 dhe Kongresi i Berlinit i vitit 1878 përbëjnë një pikë kulminante. Ndër të gjitha «edicionet» e krizës lindore, ai i viteve 1875-1881 për nga rënësia dhe pasojat zë vendin e parë.

Cerekut i fundit i shek. XIX është periudha kur kapitalizmi i konkurençës së lirë shndërrohet në kapitalizëm monopolist, në imperializëm. V.I. Lenini zhvillimin maksimal të kapitalizmit paramonopolist e lidhte me vitet 60 e 70, ndërsa si pikën më të lartë të kurbës quante vitin 1876.¹ Kjo hap periudhën e aktivizimit të jashtëzakonshëm në politikën e jashtme të Fugive të Mëdha. Zhvillimi i ngjarjeve në Ballkan ka vënë aty një vulë të qartë. Tani asnjë politikë evropiane nuk mund të ndërtohet pa llogaritur çështjen kombëtare në Ballkan. Planet e mëdha e të vogla të diplomacisë kanë atë si strumbullar. Termat e ballafaqimit janë ndërlikuar mjaft: më parë Perandoria ishte e vetmja kundërpale, kurse tani janë shifaur popujt e kombeve të shtypur që duan të kenë zërin e vet, në «hapjen e trashëgimisë» së Turqisë. Rjedhimisht edhe çështja lindore ka pësuar një evolucion thelbësor në krahasim me periudhën pararendëse: në vitet 50 ajo ishte e lidhur me ngushticat dhe Detin e Zi, 20-vjet më vonë ajo ka një përbajtje kombëtare të theksuar, përderisa ka të bëjë kryesisht me të ardhmen e kombësive nën Turqinë.

1) V. I. Lenin, «Imperializmi, faza e fundit e kapitalizmit», Veprat, vell. 22 (botim shqip) f, 241.

Sigurisht një përmbajtje e tillë e re e krizës lindore bëhet shkak për ndryshimet përkatëse në strukturën e marrëdhënieve ndërkombëtare: disa interesa evropiane dalin më në pah, disa të tjera kalojnë në radhë të dytë. Por këtu nuk ka vend për asnjë keqkuptim: metodat e trajtimit të problemeve që shtron gjendja e re në Gadishull janë po ato, janë metodat e vjetra të diplomacisë. Secila prej fuqive të mëdha e shikon edhe këtë krizë lindore në funksion të politikës së vet ekspansioniste në Ballkan dhe akoma më gjërë.

Eshtë e qartë se interesimi i politikës evropiane për Ballkanin është më i hershëm së kaq: synimet në këtë zonë kanë qënë një faktor i përhershëm gjatë gjithë shekullit 19-të. Por nuk mund të mos vihet re se pikërisht në këtë periudhë politika evropiane bën një ndryshim të dukshëm, në kuptimin që bëhet më dinamike, më agresive e më brutale në ndjekjen e qëllimeve të saj. Që këtu nis roli i Ballkanit si «fuçi baruti» në politikën evropiane. Natyrisht elementët eksplozivë lokalë nuk kanë munguar asnjëherë, porse tani Evropa ka vënë «fitila» me shumicë.

Çështja lindore është quajtur herë-herë «çështje diplomatike par excellence», tipike e shekullit 19-të. Kjo do të thotë se «çështja lindore» përbën boshtin kryesor të të gjitha aleancave më të mëdha diplomatike në Evropë gjatë gjithë shek. 19-të, madje edhe më parë. Në mënyrë paradosale kjo e deformoi problemin e vërtetë, sepse çështja e Ballkanit, në thelb një çështje kombëtare, u inkadrua në vijat më të gjëra të interesave politike e strategjike të Fuqive në Lindje përgjithësisht, u shkri dhe u errësua në «çështjen lindore» si «çështja më e madhe» e diplomacisë evropiane, me pasoja dëmprurëse për procesin e emancipimit të plotë të kombeve ballkanike nën Turqinë.

Ndërmjet karakteristikave të tjera, që e dallojnë krizen e re lindore, është edhe fakti se çështja kombëtare në Ballkan përfshin tani si një pjesë përbërëse edhe çështjen shqiptare. Lidhur me këtë, roli i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në arenën ndërkombëtare merr një rëndësi të veçantë. Asaj i detyrohet fakti se çështja kombëtare në Ballkan del më e plotë se kurdoherë, duke përfshirë të gjitha kombësitë.

Një mënyrë «tradicionale» e trajtimit të Lidhjes Shqiptare, që identifikohet me historiografinë borgjeze, dhe jehonën e së cilës e gjejmë edhe sot, është cilësimi i saj si një

«fenomen» vetëm e vetëm «i brendshëm» i Perandorisë otomane. Janë tepër të njohura versionet mbi instrumentalizimin e Lidhjes nga ana e Portës së Lartë për të mund të ndihet nevoja për t'u zgjatur mbi këtë temë. Mund të mjaftoheni të theksojmë se po ajo metodë e minimizimit të faktorit të brendshëm dhe e ekzalmit të faktorit të jashtëm në gjithë historinë e Ballkanit është çuar deri në ekstrem në rastin tonë. Çështja shqiptare në pikpamje diplomatike është quajtur e paqenë, kriteret formale-juridike janë absolutizuar dhe janë marrë për bazë qëndrimet injoruese të kancelerive evropiane, të cilat nuk kanë njohur de iure ekzistencën e një çështjeje shqiptare në këtë kohë.

Mund të duket përsëri një paradoks por është një fakt real, se kjo e nxjerr më shumë në dritë vlerën e veprës së Lidhjes së Prizrenit në aspektin diplomatik. Me veprimtarinë e saj Lidhja ia imponoi çështjen shqiptare vëmendjes së diplomacisë. Është e vërtetë se çështja shqiptare nuk figuroi si e tillë në traktativat rrëth krizës lindore, as nuk u përfshi në vendimet e Kongresit të Berlinit të korrikut 1878. Por Lidhja iu kundërvu haptazi vendimeve të Fuqive dhe tregoi qartë se në veprën e tyre kishte një zbrazëtirë. Asnjë nga Fuqitë, as Rusia në Shën-Stefan dhe as «koncerti evropian» në Berlin si një e tërë, nuk e prisnin që dispozitat e marrëveshjeve të tyre lidhur me tokat shqiptare të ngjallnin një kundërveprim të tillë masiv si ai që i dha jetë e hov lëvizjes më të madhe politike të shqiptarëve gjatë gjithë shek. 19-të. Kjo shkaktoi zgjatjen e krizës lindore aq sa në gjithë historinë e çështjes së Lindjes ajo përfaqëson padyshim krizën më të gjatë. Në literaturën historike si caqe kronologjike të saj janë pranuar përgjithësisht vitet 1875 dhe 1878. Kjo lë të kuptohet sikur Kongresi i Berlinit shënon mbylljen e saj, «zgjidhjen» e të gjitha problemeve të shtruara në këtë fazë të re nga kontrasti turko-ballkanik dhe lufta ruso-turke. Në të vërtetë kjo nuk është e saktë. Ajo është një shprehje e kultit të «gjithëfuqisë» (omnipotencës) së Fuqive të Mëdha. Në një pikëpamje vepra e Fuqive në Berlin mbeti e «pakryer» njësoj si diktati i Rusisë në Shën-Stefan. Nuk është vënë sa duhet në dukje se shkaku ka qenë injorimi i problemit shqiptar. Si pasojë, Evropa u detyrua t'u rikthehej vendimeve disa herë dhe kriza (ndonse në ton minor) vazhdoi gati edhe tre vjet të tjera, deri në fund të vitit 1880 e në fillim të vitit 1881.

Në dokumentacionin zyrtar të kohës shpesh faktet janë

mjegulluar duke ia atribuar zigzaket që pësuant vendimet «e larta» evropiane, «taktikës zvaritëse» të Turqisë. Por shumësia e bürimeve, e të dhënave, dhe distanca historike që na ndan nga ngjarjet që ndodhën 100 vjet më parë, na lejojnë të pohojmë pa pikë mëdyshjeje se faktori shqiptar nuk mund ta tregonte veten më mirë dhe se pasojat e tij në planin diplomatik nuk mund të delnin më qartë. Lëvizja Shqiptare në kohën e krizës lindore të viteve 1875-1881 është një rast tipik që hedh dritë mbi një fakt kuqimplotë: se si edhe një shekull më parë, në shek. 19-të aspiratat edhe të drejtat e një kombi të vogël i bënin sfidë «vullnetit ligj» të Fuqive të Mëdha të mbledhura në «koncertin evropian», si instanca supreme diplomatike në këtë periudhë. Kundërshtimi i popullsisë shqiptare, edhe pse të paorganizuar në një shtet të vetin, të kushtëzuar në mundësitet dhe veprimet e saj nga një varg faktorësh negativë, u bë shkak ndërlirimësh të reja në Evropë dhe kjo u mësua ta përfillë, u shty ta njohë çështjen shqiptare si të qënë.

Ky është edhe përgjënjeshtrimi më i mirë i «mënyrës tradicionale», «klasike» në trajtimin e problemeve të historisë diplomatike, që e shikon paraqitjen objektive të fakteve dhe ngjarjeve vetëm në lidhjen e tyre me qëndrimet dhe veprimet e kancelerive, që e quan diplomacinë dhe politikën e jashtme si një fushë tërësish «të rezervuar» të kabineteve. Nuk bëhet historia duke e mbërthyer vështrimin te «politika e madhe» e Fuqive qoftë edhe kur është fjala për ngjarjet e një shekulli më parë. Sepse kjo është po ashtu një sferë në të cilën shfaqet drejtpërsëdrejti apo tërthorazi edhe veprimitaria e masave populllore, veçanërisht lëvizja kombëtare si një shprehje e saj e veçantë, e lidhur me një detyrë historike të dhënë.

II.

Cdo lëvizje e vërtetë kombëtare përmban në vetvete dy momente të rëndësishme të lidhura ngushtë. Nga njera anë, janë përpjekjet me dhunë, veprimet me armë për të hedhur zgjedhën e huaj dhe këto sigurisht përbëjnë vetë boshtin e lëvizjes kombëtare. Nga ana tjeter, janë orvatjet në drejtim të preqatitjes së shkëputjes nga shteti shtypës, të hedhjes së themelive, të organizimit të ri, gjithë veprimitaria që ka si piksynim krijimin e kushteve të jashtme të favorshme për realizimin e objektivave kryesore të përcaktuara me kohë.

Megjithë karakterin sekondar e të prejardhur përkundrejt luf-tës së armatosur për çlirim, ky moment i dytë është shpesh një tregues me rëndësi vendimtare për të gjykuar mbi shka-llën e pregatitjes e të pjekurisë politike të lëvizjes, të aftësisë së kombit për t'i dalë zot së ardhmes së tij.

Në këtë ndërlihdje të dyanshme duhet parë edhe lëvizja kombëtare shqiptare në përgjithësi, ajo e periudhës së Lidh-jes së Prizrenit në mënyrë të veçantë. Pa dyshim, në rastin e Lidhjes të dhënët janë ndërlikuar dhe detyrat janë ndër-thurur në një mënyrë të tillë që përbëjnë një specifikë. Përkatësisht ajo është e detyruar të përpunojë një taktkë, të përcaktojë objektiva të ndërmjetme që e «shtyjnë» për më tej por nuk është mohojnë qëllimin final që është shkëputja nga Turqi-a dhe sigurimi i pavarsisë. Strategjia e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ka qenë një e vetme dhe evolucioni i vetë Lidhjes së Prizrenit tregoi qartë se ajo është pjesë e pandarë e këtij kuadri të tërë.

Në përputhje me këto detyra Lidhja ka përpunuuar një platformë të saj si për politikën e brëndshme ashtu edhe për politikën e jashtme. Sigurisht, nën prizmin e së drejtës ndër-kombëtare Lidhja nuk i përbushi të gjitha kushtet për të qenë një subjekt i përkryer, palë më vehte në marrëdhëniet e jashtme. Nuk mund të themi as edhe se asaj iu akordua njohja *de facto* apo *de jure*, qoftë edhe një nga format e ndërmjetme të njohjes ndërkomëtare që do t'i lejonin të hynte në disa marrëdhënie zyrtare me pjesëtarët e tjere të jetës ndërkomëtare të kohës. Nuk duhet harruar se është koha kur «njohja» shërbente në arsenalin diplomatik të Fuqive si një mjet i preferuar për të bllokuar çdo ndryshim të «papël-qyer» të statu kuo-së politikë e juridike që mund të conte në një prishje sado të vogël të «ekuilibrit të forcave», rolin e të cilët në historinë e Evropës shoku Enver e ka karakterizuar si «një armë në duart e klasave shfrytëzuese për shtyp-jen e lëvizjes nacionalçlirimitare dhe revolucionare».²

Në një kohë kur diplomacia evropiane nuk njihte formalisht as ekzistencën e një çështjeje shqiptare, nuk mund të pritej që ajo të njihte në çfarëdolloj forme vetë Lidhjen, si bartëse dhe shprehëse e saj zyrtare. Megjithatë Lidhja e Prizrenit ishte një Organizatë politike-ushtarake që në evo-

2) E. Hoxha, *Raport në Kongresin VII të PPSH*, Tiranë, 1976, f. 215.

lucionin e vet arriti deri në mveshjen me atribute qeveritare dhe në ushtrimin e funksioneve pushtetore duke dubluar dhe bille duke mënjanuar ato të Perandorisë otomane. Krahas veprimeve të saj luftarake në frontet e mbrojtjes së tokave shqiptare, krahas aksionit të brendshëm politik për sqarimin dhe mobilizimin e masave popullore Lidhja ka gjithashtu në aktivin e saj një veprimtari të caktuar në fushën e politikës së jashtme. Shoku Enver është ndalur posaçërisht në karakterin e ndërlikuar e të shumanshëm të Rilindjes Kombëtare, e cila është shfaqur në disa sfera veprimtarie, jo vetëm në luftën e armatosur e në atë politike, por edhe në betejën përkulturën, shkollën e gjuhën shqipe, edhe në përpjekjet diplomatike. «Të gjitha këto, — thekson shoku Enver, — i bashkoni një vijë e vetme, vija e mendimit politik dhe aksionit revolucionar gjithnjë në zhvillim e ngritje që kanë patur si objektiv lirinë e Atdheut, pavarësinë e tij të plotë e të pacunguar nga ana territoriale».³ Ka rëndësi të madhe të ngrihet një tablo sa më e plotë e sintetike e kësaj veprimtarie, sepse ajo është një provë tjetër bindëse e karakterit të theksuar politik të Lidhjes, e qëllimeve të saj të afërtë e të largta, e këmbënguljes dhe efikasitetit të aksionit të saj për realizimin e tyre. Nëpërmjet qëndrimeve ndaj ngjarjeve më të mëdha që tronditën Ballkanin e asaj kohe, ndaj vendimeve të Fuqive, nëpërmjet përcapjeve diplomatike pranë kësaj apo asaj qeverie apo edhe forumeve të larta të diplomacisë evropiane, nuk është vështirë të përvijohet, sado në vija të përgjithshme, platforma e Lidhjes për politikën e saj të jashtme. Doemos është e tepërt ta kërkosh atë të shprehur në mënyrë koharente në deklarata solemne e të tërësishme, as mund të gjendet ajo në zbatimin konkret përmes një veprimtarie diplomatike sistematike. Porse ka një varg dokumentesh të Lidhjes dhe burimesh të tjera rrëth saj, të cilat tregojnë se problemet e politikës së jashtme kishin vendin e tyre.

Kur bëhet fjalë për aktet e Lidhjes duhet pasur parasysh se ato nuk kanë dalë të gjitha nga një qendër e vetme, se shumë prej tyre u përkasin iniciativave të ndryshme të degëve të Lidhjes në rrethe ose edhe disave prej personaliteve të njobura kryesore. Duke i ndjekur ato dhe duke bërë sintezën e tyre, mund të bëhet një pasqyrë pak a shumë e saktë e koncepteve që mbizotëronin ose thjesht shpreheshin

3) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 9.

aso kohe për problemet më të mëdha që i delnin Lidhjes në fushën e politikës së jashtme.

Është me vend të vihemë në një kënd të ri vështrimi për trajtimin e kësaj teme. Historiografia jonë e re ka bërë një punë të vlefshme duke vënë në dukje pasojat e aksionit të Lidhjes së Prizrenit në planin e zhvillimeve diplomatike ballkanike dhe evropiane. Kjo është një mënyrë indirekte për karakterizimin e veprimitarise së saj në arenën ndërkombëtare. Një plotësim i rëndësishëm do të ishte që, duke i quajtur këto të njohura në vija të përgjithshme, ta kthejmë vëmëndjen drejtpërsëdrejti te përpjekjet që bëheshin në qarqe e nivele të ndryshme të botës shqiptare pér të formuluar qëndrimet më të përshtatshme dhe pér të përcaktuar mënyrën e veprimit në raport me botën e jashtme përballë problemeve të mprehta që shtronte situata delikate e asaj kohe.

III.

Një trajtim i plotë e i gjithanshëm i kësaj teme, kuptohet, i kapërcen caqet e një referati, Në kuadrin e një detyre më të ngushtë e të pjesshme vëmendja ndalet në disa probleme kyçë të politikës së jashtme të kohës, ashtu siç u trajtuan ato në rrethet e Lidhjes Shqiptare. Një nga këto probleme është ai i përkrahjes ndërkombëtare si një faktor me rëndësi pér realizimin e dy kërkesave kryesore të Lidhjes: mbrojtjen e tokave shqiptare nga copëtimi dhe sigurimin e autonomisë. Në thirrjet, peticonet, mesazhet, protestat e shumta drejtar kancelerive të mëdha të Evropës kjo çështje del me qartësi të mjaftueshme. Mund të thuhet mbi këtë bazë se Lidhja nuk e kërkoi mbështetjen vetëm në krahët e Perandorisë turke. Lidhja e shtriu veprimin e saj edhe jashtë kufijve të Perandorisë, duke u përpjekur të sensibilizonte edhe opinionin publik evropian pér çështjen shqiptare, të ndikonte edhe në selitë qendrore të diplomacisë evropiane.

Natyrisht hapja e Kongresit të Berlinit më 13 qershor 1878 ishte një rast i volitshëm pér t'i intensifikuar këto përpjekje dhe Lidhja i referohet atij drejtpërdrejt në dokumentet e saj fillestare. Është e vërtetë se Kararname-ja e datës 18 qershor është më e kufizuar nga kjo pikëpamje. Ajo është më shumë një rregullore e brendshme mbi organizimin e forcave që do të zgresin në fushën e betejës pér të kundërshtuar çdo cënim të tokave shqiptare. Për politikën e jashtme nuk gjejmë të dhëna të hollësishme, por aty ka një pohim vendosmërie

për të kundërshtuar lakmitë aneksioniste bullgare, serbe e malazeze. Lidhur me këtë, dëkë marrë shikas drejtperdrejt nga Shën Stefani dhe tirthorazi nga Kongresi i Berlinit, Kararnameja përban një deklaratë të qartë për moslejimin e trupave të huaja në tokat shqiptare dhe për mobilizimin e formacioneve vullnetare për t'a arritur zbrazjes së viseve të okupuara nga forcat serbe e malazeze.⁴⁾

Dy dokumente përbajnjë konsiderata të hollësishme për politikën e jashtme, prej nga edhe mund të gjykojmë më mirë për impostacionin që u përpoqën t'i jepnin aksionit diplomatik të Lidhjes Shqiptare disa rrethe e personalitetë të saj me një vetëdije të përparuar politike. Është fjala për memorandumin që iu dërgua nga Shkodra kryeministrat anglez, lordit Bikensfield (Beaconsfield), si kryetar i delegacionit të Anglisë në Kongresin e Berlinit më 13 qershor, ditën e hapjes së Kongresit, si dhe për telegramin që disa nga ideologët kryesorë të Lidhjes si Pashko Vasa, Sami Frashëri etj., i drejtuan ministrit të jashtëm të Austro-Hungarisë Andrashi, po në Kongresin e Berlinit më 20 qershor.

Veçanërisht i pari, memorandumi i 13 qershorit është një paraqitje e shkëlqyér e kaузës shqiptare përparrë Fuqive, e shoqëruar me një analizë të mprehtë të rrëthanave ndërkom-bëtare. Para së gjithash aty vihej në dukje mungesa e plotë e mjeteve të ashtuquajtura «legale» për t'a parashtruar zyrtarisht vemendjes së diplomacisë evropiane aspiratat dhe të drejtat e kombësisë shqiptare. Lidhur me këtë theksohej pozita inferiore në të cilin vihej ajo në krahasim me kombësitë fqinje. «Ndërsa të gjitha kombësitë e tjera nën Perandorinë Osmane kanë një qeveri dhe një diplomaci që ua shpreh dë-shirat, vetëm Shqipëria nuk ka asnijelloj përfaqësie».⁵⁾ As qeveria e Stambollit, si qeveri shtypësé dhe e mbetur gjithnjë tepër larg realitetit dhe interesave shqiptare, nuk mund të ishte përfaqësuese. («Shqiptarët si gjithë kombet e tjera të Ballkanit kanë mbetur të ndarë nga turku, si vaji nga ujet në të njejtën enë»). Në këto kushte shqiptarët duhej të vepronin si të mundnin, goftë edhe pa ndonjë cilësi zyrtare. Kë-

4) Akti i vendimeve (Kararname) dt. 18/VI/1878 në: *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, Tiranë 1978, f. 40-41.

5) Po aty: f. 21. Memorandumi drejtuar lordit Beaconsfield nga Shkodra dt. 13.VI.1878.

kesa e parë ishte që çështja shqiptare të shtrohej në tryezën e bisedimeve të Kongresit me inisiativën e qeverisë angleze.

Kjo na bie pikërisht te çështja që shtruam më lart, te çështja e përkrahjes ndërkombëtare. Është fare e qartë se përkrahja pér suksesin e çështjes shqiptare kërkohet jashtë sferës së veprimeve e të ndikimeve të Perandorisë turke, «te përfaqësuesit e ndonjë fuqie të madhe». Dhe sondazhi bëhet në drejtim të diplomacisë angleze. «Kjo (fuqi), — thuhej në memorandum, — nuk mund të jetë veçse Britania e Madhe». Një zgjedhje e tillë është e shpjegueshme, arsyet gjenden lehtë në situatën politike të kohës, në kontradiktat midis Fuqive. Ndër të gjitha fuqitë kryesore, ajo që ishte më e interesuar dhe më aktive në bllokimin e depërtimit të Rusisë në zotërimet otomane të Evropës jug-lindore ishte pikërisht Anglia. Kjo kishte të bënte me ruajtjen e interesave të saj imperialiste si fuqi koloniale detare. Çdo dalje ruse në këtë zonë rezikonte ngushticat: Mesdheun, Suezin, dhe pra rrugët e mëdha të komunikacionit pér në Lindje. Është thënë shpesh se politika tradicionale e Rusisë qysh prej kohës së Pjetrit të Madh ka qenë lufta kundër «një gjeografie inkomode», ndrydhëse, përpjekja pér të dalë nga «burgu kontinental» dhe pér «të marrë frymë lirisht» në hapsirat detare. Në vitin 1877 Fjodor Dostojevski shkruante një broshurë të posaçme me titullin «Stambolli shpejt a vonë duhet të na përkasë», në të cilën mbrojtja, justifikimi i synimeve ekspansioniste ruse përzihet me fryshtë karakteristike mistike e fetare, që nuk i ndahet as në këtë «essai» të tij politik. «Një gjigand si Rusia — thoshte Dostojevski, — duhet më në fund të dalë nga ajo dhomë e ngushtë ku koka i godet tavanin pér t'u lëshuar në botën e gjérë dhe pér të thithur ajrin e lirë të detrave e të oqeaneve».⁶ Përballë synimeve të formulara kaq qartë, një nga detyrat më të rëndësishme të diplomacisë angleze gjatë gjithë shek. 19-të, ajo që ka ndjekur më me energji dhe më me këmbëngulje ka qenë parandalimi ose anulimi i rezultateve konkrete të ekspansionit rus veçanërisht në raport me Perandorinë Osmane. Anulimi i Shën-Stefanit — kjo ishte detyra kryesore që i caktonte Kongresit të Berlinit Britania e Madhe. Në politikën evropiane të kohës kundrejt Perandorisë

⁶ Sipas J. Ancel, *Manuel historique de la question d'Orient (1792-1925)*, Paris 1926. f. 20-21.

turke Anglia ishte padyshim ajo që përfaqësonë vijën e ruajtjes së gjendjes ekzistuese. Ajo ka qenë faktori konservues kryesor gjatë një periudhe të tërë historike.

Ambasadori Layard shkruante në qershori 1877, pas fllimit të luftës ruso-turke, se «politika e përkrahjes së Turqisë (nga ana britanike) nuk është një politikë e shtyrë nga dashuria për turqit ose për fenë e tyre», se ajo, përkundrazi, e ka bazën e vet «në bindjen se Turqia ishte një barierë përballë planeve ambicioze të Rusisë në Lindje».⁷ Por kjo vijë, vija e integritetit të Perandorisë turke, nuk ishte absolute. Qarqet drejtuese të Anglisë nuk linin rast t'u shpëtonte pa nxjerrë përfitime për vete, ishin gjithnjë në pritje për të marrë «copën që u përkiste». Benjamin Disraeli, që në kohën e rinisë të tij kur ishte i pushtuar nga pasionet letrare-artistike dhe shkruante romane, kishte thënë (në një nga këto romane) në vitin 1847 se «anglezët kanë nevojë për Qipron dhe duhet t'ua marrin si kompensim turqve». 30 vjet më vonë, më 1877 Disraeli, burrë shteti, (alias lordi Beaconsfield), kryeministër i Britanisë së Madhe i ngarkoi vetes si detyrë që të kthente në realitet «parashikimet profetike» të romancierit me shije të theksuara perandorake. Dhe dihet se me vendim të Kongresit të Berlinit Qiproja u bë koloni angleze. Përgjithësisht mund të thuhet se Anglia atje ku s'mund të mbahej më **statu kuo-ja**, kishte synimin të komandonte procesin e dislokimit të Turqisë evropiane, ta kontrollonte dhe ta udhëhiqte.

Kjo politikë pragmatiste e Britanisë së Madhe (jo doemos e mbërthyer pas formulave integriste) nuk i shpëtonte as vëmëndjes së rretheve shqiptare. Ndaj edhe në memorandum e Shkodrës, pa përjashtuar eventualitetin e prishjes së Perandorisë (do të shikojmë më poshtë se një eventualitet i tillë merrej si një premisë kategorike) vihej theksi te rreziku «se mos një sundim tjetër më i tmerrshëm (me çka kuptohej ai i Rusisë) ia zinte vendin Perandorisë Osmane në Lindje». Në një kohë të tillë kur opinioni i gjerë në Evropë ishte mjaft i ndjeshëm kundrejt çështjes kombëtare, referimi tek «parimi i kombësisë» nuk mund të mungonte, madje ky param cilësohej në memorandum si «baza themelore e së drejtës publike evropiane» në kuptimin që çdo kombi duhej t'i njihej e drejta e daljes si shtet më vehte. Porse lidhur me

7) R. Pinon, *L'Europe et l'Empire Ottoman*, Paris 1909, f. 16.

këtë nuk bëheshin shumë iluzione. Thirrja u drejtohej më shumë interesave të Britanisë së Madhe, e cila, si thuhej në memorandum, «edhe pse nuk është e vetmja, është sigurisht më e interesuara nga të gjitha fuqitë e tjera», që sundimi turk të mos i linte vendin hegjemonisë ruse. Pikërisht për këtë theksonej shprehimisht se «pavarësisht nga çështjet e drejtësisë, Britania e Madhe ka një interes të madh që t'i vihet një ledh i fortë vërvshimit invadues sllav që shtyhet drejt Adriatikut»; dhe — duhet të shtojmë ne — jo vetëm dhe jo aq drejt Adriatikut se sa drejt Egjeut, një rrezik më i ndjeshëm për rrugët kryesore të komunikacionit të metropolit britanik me perandorinë koloniale në Lindje.

Memorandumi shkonte edhe më tej. Sidoqë ishte një dokument i adresuar tek një fuqi e vetme, aty bëheshin përpjekje për të ngritur një kuadër diplomatik të përgjithshëm të çështjes shqiptare në rrethanat historike konkrete. Bëhej fjalë edhe për Austro-Hungarinë dhe Italinë, dy fuqitë e Adriatikut që do të luanin një rol të dorës së parë në etapën e mëvonshme. Por të dyja këto fuqi në ato kushte përjashtohen si faktorë favorizues. E para për shkak të synimeve të saj «për të kthyer Adriatikun në një liqen austriak duke u vendosur edhe në brigjet shqiptare në portet kryesore». Fakti që rrethet shqiptare të Stambollit iu drejtuau vetë Andrashit me një përkujtesë të posaçme⁸ tregon se edhe në këtë anë bëheshin disa llogaritje, ushqeheshin disa shpresë për të siguruar përkrahjen e diplomacisë vjeneze. Por këto demarshe rezultuan krejt të pafrytshme, sepse Monarkia e Habsburgëve mbeti krejt refraktare kundrejt lëvizjeve shqiptare gjatë krizës lindore. Përgjithësisht Vjena e kishte përcaktuar politikën e saj kundrejt Perandorisë turke që në periudhën e Meternikut. Tani Andrahi vetë e ripohonte atë kur thoshte në janar 1875: «Turqia është e një dobie gati providenciale për Austro-Hungarinë. Sepse Turqia ruan statuko-në e shteteve të vegjël të Ballkanit, dhe pengon aspiratat e tyre kombëtare. Po të mos ishte Turqia gjithë këto aspirata do të na binin ne mbi krye». Monarkia dualiste i trembej radhës që mund t'i vinte menjëherë pas Perandorisë Osmane. Ajo shikonte tek Turqia shëmbelltyrën e vet nga shumë pikëpamje.

8) Memorandumi dt. 20/VI/1978 në Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, ff. 48-49.

Pikërisht këtë kishte parasysh K. Marks kur i shkruante V. Libnehtit në shkurt 1878: «Turqia dhe Austria kanë qenë mburoja e fundit e rendit shtetëror evropian të vjetër, që u arnua përsëri më 1815, kurse me rënien e tyre ky rend do të shkatërrohet në mënyrë përfundimtare». Dhe Marks shton te këto fjalë profetike «prishja (e tyre)... do të kryhet në një varg luftrash së pari «të lokalizuara» pastaj «të përgjithshme»⁹.

Italia, si u tha, përjashtohej po ashtu, por për arsyetë ndryshme. Pohohej tërthorazi se nuk kishte peshën e nevojshme në arenën ndërkombëtare, ndonëse i atribuheshin «qëllime bujare» doemos nën përshtypjen e parimeve që frymëzuan Rizorxhimenton italiane. Këtu sigurisht harrohej «Italia zyrtare», për të cilën Bismarku në Kongresin e Berlinit thoshte me përbuzje se «i kishte ardhur oreksi përparrë dhëmbëve»¹⁰. Fuqitë e tjera, veç Rusisë, cilësoheshin si larg interesave imediate në këtë zonë dhe pra të huaja për çdo angazhim «në mbrojtjen e kombësisë shqiptare».

Përsa i përket Rusisë, siç mund të pritej, në memorandumin e 13 qershorit ajo tërhiqte vëmendje të posaçme, pikërisht si faktor kryesor negativ i çështjes shqiptare në situatën diplomatike të asaj kohe. Pranohej se ajo (Rusia) mund të luante dhe luante objektivisht një rol përparimtar në përpjekjet për të shkallmuar themellet e Perandorisë Osmane. Në rrëthet shqiptare duket se ky fakt njihet pa shumë paragjykime, siç dëshmon një letër e Jani Vretos e prillit 1879, në të cilën «roli objektivisht clarimtar i Rusisë kundër Turqisë» i kundërvihet politikës së statu kuo-së të ndjekur nga «shtetet e qytetëruara» të Evropës perëndimore¹¹. Por po aq e vërtetë është se në këto rrëthe ishte mjaft e përhapur ndjenja se Rusia fshihte shumë më tepër rreziqe se sa shpreza për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Efthim Brandi bëhej interpret i këtyre shqetësimeve kur në vjeshtë të 1878-s shkruante nga Egjipti se «atdheun tonë të mjerë po e lufton

9) K. Marks, F. Engels, Veprat t. 34,248. (bot. rus.)

10) F. Cognasso, *La questione d'Oriente dalle origini al Congresso di Berlino*, Torino 1934, f. 334.

11) Letër e J. Vretos drejtuar Jani Koto Hoxhit nga Stambollî dt. 25-IV-1879. AQQH i RPSSH, Fondi S. Dine, D. 6 nga Letërkëmbimet e Rilindjes 1825-1881.

Rusia e tmerrshme me qëllime të këqia e pushtuese», ndërsa në anën tjetër denonconte «politikën e pamend të Evropës», sidomos të Anglisë e të Austrisë «që duan të ruajnë në Stamboll Turqinë e plasarit», gjë që do të bënte që «pas 20 a 30 vjetësh... lumi i rrëmbyeshëm i Rusisë do të na mbytë të gjithëve...»¹². Në të vërtetë gjithë politika e Rusisë në çështjen lindore, me tendencën e saj pansllaviste, ngrihej si një pengesë kolosale në rrugën e vështirë që do të duhej të bënte çështja shqiptare edhe nja tre dhjetvjetsha të tjerë.

Nuk mund të mos vihet re se në memorandumin e 13 qershorit bëhej një dallim midis ndjenjës së solidaritetit me popullsitë sllave (sllavofilia) dhe sllavizmit që cilësohej vetëm si një mjet në shërbim të idesë ekspansioniste ruse. Si një provë e kësaj përmendej diferencimi që Rusia bënte midis vetë kombeve sllave, kur dihej se gjithë preferencat e saj në Shén Stefan i shkuau «Bullgarisë së madhe», ndërsa një pjesë tjetër të popullsisë sllave nuk ngurronte të bënte fli kur ia donte interesit i saj në transaksionet diplomatike. Ky konstatim do të vërtetohej sidomos në vijim të zhvillimit të ngjarjeve, kur p.sh. Bosnja-Herzegovina u okupua nga Austro-Hungaria më 1878, ndërsa më 1908 ajo u aneksua përfundimisht prej saj me pëlqimin e drejtpërdrejtë të qeverisë cariste. Një arsyetim i tillë u duhej autorëve të memorandumit **shqiptar për të dalë përsëri në konkluzionin që i shkaktonte më shumë shqetësimë diplomacisë angleze: se nuk ishte ideja e qirimit të popullsive sllave apo ortodokse ajo që i jepte impulse aksionit të Rusisë kundër Perandorisë turke, por ishin synimet e politikës së saj hegemoniste në Lindje, dhe prë Ballkan, synime që binin ndesh me ato të Britanisë së Madhe.**

IV

Veprimtaria diplomatike pas Kongresit të Berlinit **përkundërshtimin e vendimeve territoriale që preknin tokat shqiptare** është një aspekt tjetër themelor i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pa u ndalur në listën e gjatë të telegrameve të

12) Letër e E. Brandit nga Minia (Egjipti i Sipërm), dt. 27 tetor 1878. Po aty, Fondi J. Vreto, D. 8 nga vëll. *Letërkëmbimet e Rilindjes 1828-1881*.

protestës, të thirrjeve për ndjeqjen e padrejtësive, të deklaratave për denoncimin e grabitjeve, dëbimeve në masë dhe masakrave në viset e pushtuara, duhet theksuar se këto telegrame e thirrje vinin nga shtresat dhe anët më të ndryshme, gjë që është gjithashtu një tregues i qartë se populli shqiptar ishte i ndërgjegjshëm për çastet historike që përjetonte, gjë që dëshmon nga ana tjetër për veprën e madhe emancipuese që kishin zhvilluar Degët e Lidhjes me masat e gjera popullore. Krijohet në këtë mënyrë bindja se aksioni politik, dhe bile më specifik diplomatik, shoqëron hap pas hapi rezistencën me armë të trupave të Lidhjes për mbrojtjen e integrititetit të tokave shqiptare.

Për t'iu përgjigjur kërkessës për të dhëna më konkrete, mund të përmendnim përqapjen që bëri Komiteti i Stambollit në tetor 1878 pranë ambasadorit austro-hungarez në atë qytet, që është jo vetëm një mbajtje qëndrimi kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit, por edhe një akuzë kundrejt Evropës që «nuk i njihte as Shqipërinë e as shqiptarët» e që «thirrjet e dhimbshme e dérmuese të shpirtit shqiptar vazhdonin të mos dëgjoheshin nga pushtetet botërore».¹³⁾

Kur flitet për veprimtarinë e Lidhjes në mbrojtje të tokave shqiptare, nuk mund të mos bëhet një dallim përsa i përket formave të angazhimit të saj në çështjen e kufijve në Veri dhe në Jug. Në të vërtetë, çështja e kufijve është një dhe e vetme, e megjithatë kemi dy forma të ndryshme në të cilat shfaqet kryesisht veprimi i Lidhjes Shqiptare.

Për lëshimet territoriale në Veri në favor të Malit të Zi, Kongresi i Berlinit përcaktoi disa dispozita të formës së prerë dhe ajo që shtrohej pas Kongresit ishte çështja e zbatimit të tyre. Duke u ndodhur përballë një vendimi të marrë bashkërisht në «areopagun» e Fuqive, Lidhja duhej ta zhvillonte veprimin e saj kryesisht nëpërmjet kundërshtimit me forcën e armëve. Pa mohuar, madje duke i theksuar orvatjet në drejtim të diplomacisë evropiane, duhet të pohohet pa asnjë dyshim se lufta e armatosur është momenti që mbizotëron në veprimin e Lidhjes për ruajtjen e kufirit në Veri, që nga ndeshjet e para në vjeshtën 1878 e deri në dorëzimin e Ulqinit në duart malazeze në nëntor 1880. Siç u theksua edhe më lart,

13) Letër e Komitetit të Stambollit drej'uar ambasadorit a-h dt. 22-X-1878, në Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, f. 66.

pikërisht qëndresa me armë e Lidhjes Shqiptare u bë shkak për ndërlikime të reja diplomatike në shkallë evropiane dhe, si pasojë, për zgjatjen e «paparashikuar» të krizës lindore.

Për kufirin në Jug çështja ishte ndryshe. Kongresi i Berlinit u gjend përparrë kërkosave të tepruara greke, të paraqitura nga ministri i jashtëm T. Delijanis në një seancë të tij. Megjithatë, Kongresi nuk mori ndonjë vendim të prerë lidhur me kufirin midis Turqisë dhe Greqisë. Në protokollin 13 të tij të datës 5 korrik ai bëri vetëm një rekomandim që Porta të fillonte bisedime dypalëshe me qeverinë e Athinës dhe «të merrej vesh me të për një rishqyrtim të kufijve në Thesali dhe në Epir» duke patur vijën e lumenjve Kalamas-Selenvria si orientim.¹⁴ Kjo kërcënonte disa qëndra e krahina të Jugut në të cilat popullsia shqiptare ishte një shumicë e madhe. Kështu u krijua një gjendje e nderë edhe në Jug në kufirin me Greqinë, megjithëse këtu ngjarjet nuk morën asnjëherë atë kthesë dramatike që patën në Veri.

Që gjatë Kongresit të Berlinit, por sidomos pas tij, u pa se situata diplomatike nuk ishte tepër e favorshme për realizimin e gjithë rivendikimeve territoriale greke. Bikensfildi pas kthimit nga Berlini, ku siguroi për vete Qipron, në fjalën e tij para Dhomës së lordëve pati si këshillë për Greqinë: «të mësojë të ketë durim».

Kjo nuk mund t'i shpëtonte Portës së Lartë e cila i zgjati bisedimet për një kohë të gjatë. Ky moment u kap edhe nga Lidhja Shqiptare, e cila zhvilloi një veprimtari diplomatike veçanërisht të gjerë për kufirin në Jug. Pregatitje ushtarake u bënë edhe këtu. Raportet e konsujve të huaj bëjnë fjalë përmijra trupa të Lidhjes që u organizuan dhe u vunë në gatishmëri të plotë. Kjo nuk mund të mos mbahej parasysh nga qeveria e Athinës, sikurse nuk mund të harrohej edhe dështimi i provës së forcës në Lekures në shkurt 1878, që mbaroi me tërheqjen e çetave sulmuese greke. Kështu shpjegohet që Athina zgjodhi rrugën e traktativave me Portën dhe të amkesave pranë kancelerive evropiane për realizimin e kërkosave të saj territoriale. Kësaj iu përgjigj aksioni kryesisht diplomatik i Lidhjes Shqiptare. Ai u zhvillua gjatë një periudhe 3-vjeçare, që në prag të Kongresit të Berlinit e deri në mars

14) Protokolli 13 i seancës së 5 korrikut 1878 të Kongresit të Berlinit në «Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (dorëshkrim pranë sektorit shkencor të Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike).

të vitit 1881, duke ndjekur hap pas hapi zhvillimin e traktativeve dypalëshe midis Turqisë dhe Greqisë, duke pasqyruar rikthimet dhe ndërprerjet nga koha në kohë.

Momentin kulminant në këtë drejtim e përbën pa dyshim udhëtimi i delegacionit të Lidhjes, të kryesuar nga Abdyl Frashëri, në Evropë në pranverë të vitit 1879. Delegacioni vizitoi kryeqytetet e 5 fuqive të mëdha me përjashtim të atij të Rusisë dhe u dorëzoi në maj nga një memorandum qeverive të Anglisë, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë dhe Italisë.¹⁵ Memorandumi ishte në fakt një përgjigje kundrejt kërkuesave territoriale të paraqitura nga Delianisi në Kongresin e Berlinit një vit më parë. Fillohej me dënimin e veprës së Kongresit, ku «të drejtat e shqiptarëve u shkelën keqas dhe, me gjithë protestat e shumta, Shqipërisë iu shkëputën shumë toka për t'ua dhënë Malit të Zi e Serbisë». Konsideratat historike e gjeografike ishin shkelur dhe «padrejtësi të mëdha iu bënë Shqipërisë». Por Evropa tani po i shikonte me sy pasojat e një vepre të tillë: «vështirësitetë dhe shqetësimet vazhdomin ende». Në qoftë se lëshimi i tokave në Veri, për të cilin kishte një «vendim formal të Kongresit të Berlinit», u bë shkak për kaq ndërlikime, atëhere c'mund të ndodhë po të përsëritezë e njëjtë gjë në kufirin në Jug? Në memorandum theksonej rëndësia e veçantë e problemit që ishte objekt i diskutimit në bisedimet dypalëshe turko-greke. «T'i japësh Greqisë, — thuhej aty, — viset që ajo kërkon në këtë anë do të thotë t'i japësh çelësat e Shqipërisë». Dhe përfundohej me deklaratën se, përballë lakinive të fqinjve, përballë rreziqeve që u kërcënoheshin. «popullsitetë atdhe-dashëse» shqiptare «janë bashkuar me një betim solemn (Lidhja Shqiptare) për të mbrojtur atdheum e tyre, gjuhën dhe kombësinë».

Përbledhja që hartuan A. Frashëri dhe Mehmet Ali Vrioni pas kthimit të tyre nga udhëtimi në Evropë nga fundi i qershorit 1879, është një plotësim i vlefshëm dhe një pasqyrë e qartë e pritjes që pati iniciativa shqiptare në kancerleritë. Në 3 kryeqytete delegatët shqiptarë u takuan dhe biseduan me përgjegjësit më të lartë: në Romë me

15) Memorandumi i delegatëve të Lidhjes Shqiptare A. Frashëri e M.A. Vrioni qeverive të Fuqive të Mëdha me përjashtim të asaj të Rusisë dt. 3.19.29 maj 1879, në Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, f. 83.

kryeministrin F. Krispi (F. Crispi), në Paris me ministrin e jashtëm Vaddington, në Londër me sekretarin e Forein Ofisit, lordin Salisbëri (Salisbury). Por dukej se vetëm në Romë delegacioni i Lidhjes la pak më tepër jehonë. Krispi përmendet të ketë njohur «gabimin që u bë në Kongresin e Berlinit» dhe të ketë premtuar përkrahjen për «ndreqjen e gabimit» bashkë me «kundërshtimin e Italisë ndaj pretendimeve greke në Epir», plotësimi i të cilave, — tha ai, — «mund të conte në hapjen e armiqësisë midis shqiptarëve e grekëve dhe mund të krijonte këtu një situatë të favorshme për ndérhyrjen e Austro-Hungarise që mund të përfitonte për të pushtuar gjithë Shqipërinë»¹⁶. Ky qëndrim i Romës, i diktuar më së shumti nga rivaliteti me Austro-Hungarinë, do të gjente shprehje në Konferencën e Berlinit që u mbajt një vit më vonë në qershor 1880, ku Italia do të kërkonte edhe përkrahjen e Francës (por pa sukses) për një shqyrtim më pozitiv të çështjes shqiptare të parashtuar në këtë konferencë nga përfaqësuesit e Lidhjes prej Stambolli, Shkodre si dhe nga vetë Komiteti qendror i Lidhjes¹⁷.

Në Paris, ku pretendimet greke gjenin një mbështetje të plotë. Vaddingtoni u kufizua me disa fjalë të përgjithshme dhe tha se «do t'i jepte udhëzime ambasadorit francez në Stamboll që të mos i bëhej padrejtësi asnjerës palë». Ishte bindja edhe e delegatëve shqiptarë se kjo viente sa për t'i «përcjellë». Në Londër sekretari i F. Ofisit u foli pak a shumë me të njëjtën gjuhë; ai shfaqi vetëm «shpresën se në Epir nuk do t'i jepej ndonjë gjë Greqisë». As në Berlin dhe as në Vjenë delegatët e Lidhjes nuk u pritën nga përfaqësuesit zyrtarë. Nga Sekretariati gjerman pér punët e jashtme iu komunikua, nëpërmjet ambasadorit të Turqisë, se «qeveria gjermane nuk ishte e interesuar drejtpërdrejt në çështjen e Lindjes», se ajo «nuk kishte pranuar asnjë përfaqësues nga këto vende» dhe se pra, «nuk mund të pranonit as përfaqësuesit shqiptarë». Edhe Andrashi u justifikua me pretekstin se «nuk kishte takuar as përfaqësuesit e Rumelisë lindore»,

16) Po aty. f. 83.

17) Tel. i përfaqësuesve të Lidhjes nga Stambolli (J. Vreto, S. Frashëri etj) drejtuar më 17-VI-1880 Konferencës së mbledhur në Berlin për «ndreqjen e kufirit turko-grek»; tel. i Komitetit të Lidhjes, për Shkodrën dt. 19/VI/1880 në Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912, f. 102, 104.

ndonse shtoi se «Austro-Hungaria nuk ishte për t'i dhënë Greqisë ndonjë copë tokë në Epir».

Nga relacioni i Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vrionit del përgjithësisht një pasqyrë e saktë e pozitës së Fuqive evropiane në këtë pikë. Në të vërtetë, me përjashtim të Francës, 4 fuqitë e tjera, së paku në këtë fazë, anonin më tepër nga një zgjidhje e tillë që zgjerimin territorial më të madh Greqia ta merrte në anën e Thesalisë dhe jo aq në këtë anë, në Epir, ku, siç duket, ishte edhe frika e «komplikacioneve të reja me kryengritësit shqiptarë». Jo më kot në fund të vitit 1879, Vaddingtoni dhe Salisbëri, duke marrë në shqyrtim gjendjen e krijuar pas dështimit të traktativave turko-greke që zgjatën prej gushtit e deri në nëntor, arritën në përfundimin se «duhej gjetur një zgjidhje e tillë që t'u shpëtonë vështirësive shqiptare». Kjo ishte pikërisht zgjidhja përfundimtare që, me ndërmjetësinë e Fuqive të Mëdha, iu dha në mars 1881 çështjes së «rektifikimit të kufirit midis Turqisë dhe Greqisë».

Lidhur me angazhimin e Lidhjes në frontin e luftës diplomatike pér mbrojtjen e tokave në Jug, dy konsiderata vijnë në mëndje posaçërisht.

Së pari, gjatë gjithë kohës që qëndron e shtruar çështja e kufirit me Greqinë, Lidhja del si një palë e tretë. Është e vërtetë se ajo nuk njihet zyrtarisht si e tillë, por prania e saj ndjehet qartë, edhe pse ajo nuk është në vijën e parë të ballafaqimit diplomatik midis Athinës dhe Portës së Lartë. Orvatjet pér ta paraqitur si një aneks të mekanizmit diplomatik të Turqisë kanë qenë gjithnjë një thjeshtësim i rëndomtë. Dokumentat turke të kohës mbi Lidhjen Shqiptare, të mbuluara dikur me një sekret të thellë, sot na zbulojnë të dhëna shumë të çmueshme që tregojnë se Porta e lartë, ndërsa ishte gati ta përdorte «rrezikun e Lidhjes Shqiptare» si një mjet rezervë, e ndiqte me shqetësim daljen e saj (të Lidhjes) në arenën e diplomacisë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Një temë kokëcarjesh e bezdie të veçantë ka qenë pér Portën sidomos udhëtimi i delegacionit të Lidhjes në Evropë. Që në fillim të këtij misioni në prill 1879, ministria e jashtme e Stambollit u dërgonte dy udhëzime të njëpasnjëshme ambasadorëve të saj në Romë e në Paris: ajo e cilësonte si «të pahijshme» dhe «të papajtueshme me sovranitetin e Perandorisë» «çdo përcapje të drejtpërdrejtë» të delegatëve shqiptarë pranë qeverive italiane e franceze dhe kërkonte kthimin e tyre pá vone-

së.¹⁸ Fakti që A. Frashëri e vazhdoi edhe më tej udhëtimin në Londër, Berlin e Vjenë, pa marrë parasysh udhëzimin e kundërt të Portës së lartë, është një provë tjetër bindëse se Lidhja Shqiptare synonte të kishte një vend dhe një rol të saj edhe në politikën e jashtme. Ky është edhe vetë kuptimi i përgjigjes që i jepte A. Frashëri ambasadorit turk në Romë se «qeveria perandorake është e lidhur deri në një farë mase me Traktatin e Berlinit», ndërsa «ne (përfaqësuesit e Lidhjes) vijmë t'u shpjegojmë Fuqive që kanë nënshkruar këtë akt se sa i padrejtë është vendimi që është marrë ndaj vendit tonë prej tyre».¹⁹

Së dyti, qoftë në Veri qoftë në Jug Lidhja del si një e tërë. Doemos ka një ndarje të punës, por qëllimi është një dhe i pandarë. Lidhja shënon përgjithësisht shkallën më të lartë të bashkimit të popullit shqiptar të realizuar në kushtet e sundimit otoman. Nga njëra anë, kjo është një provë e pagabueshme e zgjimit të tij politik, nga ana tjetër është parapregatitja për ngjarjet e mëdha që e presin paskëtaj. Ky unitet shfaqet në të gjithë rëndësinë e tij si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombetar. Zëri që mbërrin në Evropë për të denoncuar pадрејтеситë, për të shprehur vendosmërinë për kundërveprim, është zëri i të gjithë shqiptarëve kudo që janë, në Veri dhe në Jug, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Abdy Frashëri i bie kryq e tërthor gjithë vendit; ai është atje ku rreziku është më i madh, ku duhen marrë qëndrime dhe vendime me përgjegjësi; atë e shikojmë në Stamboll të ndërhyjë pranë Portës së Lartë, në Ballkan dhe në Evropë të zhvillojë bisedime me përfaqësues të shteteve fqinj dhe të Fuqive të mëdha. Në vetëvehte ai është një simbol, simbol i unititetit të mendimit e veprimit të Lidhjes si tërësi.

Një fakt po aq kuptimplotë është edhe vetë vepra e Pashko Vasës «E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët», që u botua në frengjisht në Paris pikërisht në vitin 1879²⁰) Vjershëtari i flaktë, zemra e të cilit qan me dhimbje për cungimet që i kanosen trupit të Shqipërisë në Veri (O Shqipni,

18) Tel. nga Stambolli dt. 10/VI/1879 për në Romë e Paris në: «*Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane (1878-1881)*», f. 31-32.

19) Po aty, f. 33.

20) Vassa Effendi, *La verité sur l'Albanie et les Albanais*, Paris 1879.

e-mjera Shqipni), prej nga del aq i fortë e i apasionuar kushtrimi për të rendur në mbrojtje të saj, është edhe publicisti i mprehëtë që argumenton me mënguri dhe urtësi mëvetësinë dhe identitetin etnik të shqiptarëve si në Veri dhe në Jug. («Populli shqiptar përbëhet nga dy familje të mëdha: gegë e toskë»), që përgënjeshtron «Megalidenë» shoviniste greke në atë kohë, e cila pretendimet territoriale mbi Shqipërinë jugore përpiquej t'i mbështeste në ngatërrimin e besimit fetar me kombësinë. Një pasazh i vogël nga ky libërth i Pashko Vasës, pasazh që i shërben atij si mbyllje, është mjافت instruktiv dhe ia vlen të jepet, edhe pse nuk i takon drejtëpersëdrejtë thelbit të çështjes që është objekt i shqyrtimit tonë. Për nga fryma që e pëershkon, i zhveshur nga qdo paragjykim apo ndjenjë armiqësore mbi bazën e nacionalizmit ekskluzivist, për nga besimi e siguria që e frysmezojnë në arsyen e shëndoshë, këto fjalë-të Pashko Vasës na kujtojnë fjalimet e famshme që do të mbante Fan Noli në Lidhjen e Kombeve 40 e ca vjet më vonë po pér çështjen e kufijve të Shqipërisë. «Ne ia njo him meritat Greqisë — thoshte P. Vasa, — megjithëse madhështia e saj e kaluar nuk ka nevojë pér votën tonë pér t'iu imponuar admirimit të brezave që vijnë... Kushdo që merr penën në dorë nuk mund të injorojë atë që njerëzimi, shkencat e artet i detyrojnë racës greke, kësaj race me energji të mëdha që dikur mbushi me lavdinë e saj botën imbarë» Por, — shtonte pas kësaj P. Vasa, — «ky nderim i sinqertë që i bëjmë Greqisë nuk duhet të mbysë dashurinë tonë pér Shqipërinë. Është mëmëdheu ynë dhe ne duam ta shohim në lumturi të plotë... Më mirë ta qanim të vdekur se sa ta shohim të copëtuar midis fqinjëve tanë».

V

Është tamimë një arritje e rëndësishme e historiografisë së re shqiptare përpunimi i një tabloje të plotë të veprimitarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me dy aspektet e saj kryesore të lidhura ngushtë: problemin territorial dhe atë të autonomisë. Ky aspekt i dytë, i mbajtur pér një kohë të gjatë në errësirë, i nënveftësuar jashtë mase, tanë ka dalë mirë në dritë. Nga kjo historia e Lidhjes së Prizrenit dhe pra e gjithë Lëvizjes sonë kombëtare në çerekun e fundit të shek. XIX, ka fituar një gjërsë që nuk pandehej më parë.

Në veprimitarinë diplomatike të Lidhjes nuk është vështirë

të ndiqet kjo vijë e autonomisë. Ky aspekt i dytë i çështjes shqiptare e është arenëndërkombejtare nëpërmjet problemit të kufijve në Veri dhe në Jug dhe gradualisht fiton peshë pér të dalë më në fund si një problem i veçantë. Si pjesë përbërëse e programit minimum të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, ajo ka vendin e parë në krahasim me qdo variant tjetër pér sa i përket statusit të Shqipërisë. Por nuk është e huaj as ideja e pavarësisë.

Ajo që ndoshta është konsideruar si diçka e «papritur» në memorandumin e Shkodrës drejtuar lordit Bikënsfild është kjo ide e pavarësisë. Shihet qartë nga gjithë fryma e memorandumit se ajo nuk është futur aty pér ndonjë ngatërrim terminologjje (pavarësi në vend të autonomisë), pér ndonjë keqkuptim, por është sugjeruar si e vëtmja zgjidhje e çështjes shqiptare që në këtë fazë. Kjo nuk bën gjë tjetër veçse ia shton rëndësinë, sepse memorandumi i Shkodrës është shprehje e rretheve më të përparuara të Lidhjes, të cilat janë gjithmonë të pranishme, ndonse nuk gjejnë ende shumë hapësirë. Ai nuk ishte një zë i izoluar, një zë «në shkretëtirë», diçka që del jashtë shtratit të Lëvizjes Shqiptare përgjithësisht. Që një vit përpara kësaj, më 1877, pas fillimit të luftës ruso-turke, Abdyl Frashëri në traktativa të fshehta me përfaqësuesit e qeverisë së Athinës, kërkonte përkrahjen e saj pér «planin e krerëve shqiptarë që të merrej shkas nga invadimi i huaj pér të bërë mobilizimin e përgjithshëm të bashkëat-dhetarëve me qëllim që të arrihej në shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia» dhe në shpalljen e pavarësisë.²¹ Një varg rrethanash e shtynë Lëvizjen tonë Kombëtare të qëndronte në kérkesën e autonomisë pér një kohë. Përveç rreziqeve që vinin nga synimet ekspansioniste të rretheve shoviniste të shteteve fqinje, edhe politika evropiane nuk vinte më pak në konsideratë. Dy vijat kryesore në këtë politikë – ajo e «ndërhyrjes» në emër gjoja të shpëtimit të kombeve të shtypura, në fakt pér ndarjen e trashëgimisë së Turqisë, dhe ajo e ruajtjes së statu **kou-së** në emër gjoja të paqes evropiane, në të vërtetë pér përjetësimin e një «ekuilibri» imperialist – gjegj në një pikë takimi, një zgjidhje kompromisi, një «modus vivendi» në «zbatimin e reformave» në gjirin e Perandorisë.

21) E. Kofos, Greece and the Eastern Crisis (1875-1878) Thesaloniki 1975.

Gjithë lëvizjet çlirimtare të Gadishullit kanë aty një shteg dhe njëkohësisht një pengesë. Lëvizja Shqiptare ndjek të njëjtën rrugë dhe cakton si objektiv të sajnë autonominë.

Një çështje tjetër me interes, sidomos në vështrim të zhvillimit që do të ketë çështja shqiptare nga tri dekada më vonë, është mënyra se si konceptohej organizimi i ri i Shqipërisë. Dihet se këtu Lidhja Shqiptare nuk mbeti vetëm në sferën e dëshirave, por me kohë zhvilloi një aksion të gjërë popullore për realizimin në praktikë të autonomisë, i cili çoi në krijimin e një aparati të tavrë, që zëvëndësoi ose dubloi atë të Perandorisë. E megjithatë organizimi i ri i krahinave shqiptare nuk shtrohet vetëm si çështje e brendshme, vetëm në raport me Portën e Lartë. Në memorandumet drejtuar Fuqive referimi te Traktati i Berlinit është gjithnjë më i shpeshtë për të kërkuar zbatimin e reformave të parashikuara nga neni 23 (sipas modelit të «regullores organike» të Kretës të vitit 1868) për të gjitha kombësítë e Turqisë evropiane, pra edhe për Shqipërinë. Kjo bëhet nga delegacioni i kryesuar prej A. Frashërit në maj 1879 në Evropë, kjo përsëritet edhe nga Komiteti i Stambollit në korrik të po atij viti në një memorandum të ri që i dërgohet Portës dhe që shpërndahet në Evropë me anë të komiteteve arbëreshe të Italisë. Nuk është vështirë të kuptohet se qëllimi ka qenë që të arrihej edhe në një farë angazhimi të Evropës për realizimin e kërkesës së autonomisë.

Edhe në këtë rast memorandumi i Shkodrës drejtuar lordit Bikensfilld tërheq vëmëndjen në mënyrë të veçantë. Pavarësisht nga zgjidhja më e avancuar që i jepet aty çështjes shqiptare në formën e pavarësisë, organizimi i ri i krahinave shqiptare mund të veçohet si një problem më vete, mund të merret si i tillë. Trajtimi që i bëhet atij në memorandumin në fjalë paraqet të paktën dy anë. E para, faktori ndërkombëtar parashikohet si një kusht për organizimin e ri të krahinave shqiptare, në kuptimin që nuk duhet lënë vetëm në duart e Turqisë. Ruga e «lidhjes» së Portës, duke e detyruar atë me anë të një traktati ndërkombëtar, nuk mund të shpresohej të jepte gjë, derisa kishte rezultuar e pafrytshme edhe më parë. «As që duhet menduar se rikrijimi i Shqipërisë mund të bëhet duke ia besuar qeverisë turke» — thuhej në memorandum. Si zgjidhja më e mirë propozohet që kjo detyrë t'i lihej «një komisioni ndërkombëtar, i cili do të vepronte në të njëjtën mënyrë si për Bullgarinë, siç do të vepron-

te ndoshta për Kretën dhe krahinat që do t'i jepen Greqisë.»

Mirëpo, përvëç kësaj, dhe kjo ishte pikërisht ana e dytë, memorandumi përmban edhe një paralajmërim në adresë të Fuqive: «ato nuk duhet të bien në gabim që t'u imponojnë shqiptarëve një qeveri jokombëtarë» të organizuar nga jashjtë. Ato nuk duhej të bënин këtu, në Shqipëri as aq sa kishin bërë në rastin e Greqisë e të Bullgarisë. Shqiptarët, — theksohej në memorandum, — janë një komb i vetëm për nga raca, gjuha, traditat, historia dhe për nga të gjitha elementet e identitetit kombëtar. Pra Shqipëria duhej të organizohej si një e tërë e vetme, nën një qeveri të vetme «një qeveri që të jetë kombëtarë, e dalë nga gjiri i vendit». Rëndësia e kësaj do të kapet më mirë po të bëhet një kapërcim në periudhën e mëvonshme të viteve 1912-1914, kur angazhimi i Fuqive të Mëdha imperialiste në çështjen e organizimit të Shtetit Shqiptar nëpërmjet princit të huaj dhe Komisionit Ndérkombëtar të Kontrollit, mori formën e ndërhyrjes brutale dhe të një ipoteke të rëndë mbi pavarësinë shqiptare.

Për «garancinë evropiane» bëhej fjalë edhe më 1879, por vetëm si një mjet për të mbrojtur pavarësinë shqiptare nga shumë rreziqe «sipas modelit të Zvicerës e të Belgjikës», që të bën të mendosh se ajo që kërkohet ishte «asnjanësia e përhershme e garantuar prej Fuqive të Mëdha».

VI

Veprimtaria diplomatike e Lidhjes Shqiptare nuk siguroi dot përkrahjen ndérkombëtare si një faktor për realizimin e programit të saj. Asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk e llogariste ende çështjen shqiptare si një element të mundshëm të politikës së saj në Ballkan. Kjo shpjegon përsë asnjëra prej tyre nuk mori anën shqiptare as në çështjen e kufijve, as në atë të autonomisë.

Duke bërë fjalë për përpjekjet e Lidhjes pranë Fuqive të Mëdha për të fituar një mbështetje për programin e vet, E. Brandi i shkruante Jani Vretos në vjeshtë 1878: «Por a na e japid vallë? Jo! Sepse sot atdheu ynë është nxjerrë pjesë pjesë në ankand nga Fuqitë e Mëdha në Berlin»²²

22) Letër dërguar Jani Vretos nga Minia (Egjipti i sipërm) dit. 15/27 tetor 1878. AQH i RPS të Shqipërisë, Fondi J. Vreto, D. 8.

Lidhja nuk gjeti mbështetje as në ndonjë aleancë me shtetet fqinjë për përpjekje të përbashkëta kundër Turqisë. Nga ana e Veriut dyert kanë qenë krejt të mbyllura dhe kjo sigurisht lidhet me lakmitë teritoriale që nxiti në qarget shoviniste të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë, lufta ruso-turke. Mendohej se tokat shqiptare në Veri e Veri-lindje duhej të ishin një pre i lehtë dhe një shpërblim i natyrshëm i fitores së shteteve sllave.

Ndryshe përsëri ishte me Greqinë ku zbritja e Rusej në fushën e armëve në vitin 1877, shërbeu si një shkëndijë pér ndezjen e debatit të vjetër midis dy rrymave kryesore në qarget politike greke — njëra pér hyrjen e menjë-hershme në luftë dhe tjetra (fanariste) pér ta «trashëguar pa-qësisht» Perandorinë Otomane. Kjo bëri që Athina të kalonte nga lëkundja më lëkundje pa vendosur dot pér një zgjidhje. Në këto kushte vihet re një rritje e interesit të qarqeve drejtuese greke pér kontakte me përfaqësuesit e Lëvizjes Shqiptare. Dokumentat zyrtare të ministrisë së jashtme të Athinës, që kanë parë tanë dritën në disa botime greke, tregojnë se si që në vitin 1877, pas fitores ruse në Plevna, u dërgua në Stamboll një emisar i posaçëm, Skuludis, pér të zhvilluar bisedime me A. Frashërin pér një bashkëpunim ushtaral greko-shqiptar. Por projekti i vjetër i shtetit unik greko-shqiptar si dhe synimet e haptë mbi «Epirin» nuk mund të jepnin një bazë të pranueshme pér kërret shqiptarë. Në shkurt 1878 bisedimet u rifilluan në Korfuz, por dokumentat greke bëjnë fjalë tanë pér dyshimet që ushqente Athina kundrejt shqiptarëve, që kërkonin përkrahje ushtarake dhe financiare. Me këtë rast ministri i jash-tëm Kumunduros i shkruante Skudulis-it: «Unë mendoj se është e rrezikshme të bashkëpunojmë pér të krijuar një fuqi armiqësore në krahun tonë.» «Shqiptarët, — vazhdonte Kumunduros, — kanë shpresë të krijojnë kombësinë e tyre (shtetin — nationality), por nuk i kanë mjetet e mundësítë prandaj kërkojnë t'ua japim ne».²³

Në këtë mënyrë gjatë krisës lindore shtetet fqinje, që kishin mjaft divergjencia midis tyre, dolën si një bllok në synimet pér të copëtuar tokat shqiptare.

Lidhja Shqiptare u ndodh në këtë mënyrë vetëm pér vetëm përballë pushtuesit turk. Bashkëpunimi fillestar mbi

23) E. Kofos, vep. cit.

bazën e interesave që u puqën në çështjen e ruajtjes së integritetit territorial të Perandorisë, dalngadalë humbi përbajtjen e tij dhe armiqësia e hapët shpërtheu edhe njëherë midis shqiptarëve dhe Turqisë. Më në fund Fuqitë e Mëdha i dhanë një dorë Portës së Lartë për të ndëshkuar sfidën e shqiptarëve ndaj vendimeve të «koncertit evropian» dhe Lidhja Shqiptare ra në goditjet e kombinuara të Evropës dhe të Turqisë. Mësimi kryesor që populli shqiptar nxorri nga historia ishte që luftën për shpëtim ta çonte përparrë me forcat e tij.

Megjithatë aksioni diplomatik i Lidhjes bëri një shërbim të madhi. Me Lidhjen e Prizrenit çështja shqiptare do li në një dritë të re jo vetëm në kuadrin e brendshëm të Perandorisë otomane, por edhe në planin ndërkombëtar. Për herë të parë Lëvizja Kombëtare Shqiptare hedh themel për një politikë të jashtme të saj, si një sferë e rëndësishme e veprimitarisë së gjithanshme për realizimin e objektivave të afërtë e të perspektivës. Në qoftë se nuk arriti të siguronte një pikëmbështetje në planin ndërkombëtar, ajo me gjithatë e vuri diplomacinë e Fuqive të Mëdha ballë për ballë me problemin shqiptar. Ajo bëri kështu pagëzimin e zjarrit edhe në këtë fushë të rëndësishme të përpjekjeve politike. Jani Vretoja që në atë kohë vinte në dukje dinjitetin me të cilin u përballua kjo provë e parë. «Vëllezrit tanë, — thoshte ai, — duke iu referuar sidomos misionit të Abdyl Frashërit në Evropë në pranverë 1879, — ndonëse dolën për herë të parë në fushën politike.... janë sjellë në mënyrë shumë të arsyeshme e të urtë, pa i bërë kujt ndonjë padrejtësi, pa mashtruar njeri.... dhe pa i bërë lajka askujt. Ura ta e bekimi i kombit qofshin me ta....»²⁴

Diplomacia evropiane nuk mund të mos e shquante ekzistencën e një çështjeje shqiptare në horizontin e politikës ballkanike si një realitet objektiv. Sigurisht jemi akoma larg shqyrtimit në themel dhe zgjidhjes së saj. Madje pas likuidimit të çështjes së kufijve dhe shtypjes së Lidhjes, ajo e humbet mprehtësinë dhe ngutësinë. Por tanimë ajo ka dalë. Asnjëri nuk mund t'i kthejë krahët, ta injorojë. Këtej e tutje Shqipëria dhe shqiptarët si një komb më veh-

24) Letër e J. Vretoos drejtuar Jani Koto Hoxhit nga Stambollit dt. 25-IV-1879. AQH i RPSSH, Fondi S. Dine, D. 6 nga vëllimi Letërkëmbimet e Rilindjes 1825-1881.

te, me një fat historik të vetin, do të përbëjnë sipas shprehjes së diplomatëve të kohës «një element të pandarë të kombinacioneve politike» në Ballkan dhe në Evropë. Duke prefiguruuar në thelb të gjitha problemet dhe detyrat e mëdha që shtroheshin në shkallë ndërkombëtare përpjara Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, me shkëputjen e plotë nga Turqia dhe shpalljen e pavarësisë si pikësynim përfundimtar, Lidhja Shqiptare e Prizrenit shënoi fillimin e historisë diplomatike të shtetit shqiptar të kohës së re. Është edhe kjo historia e një lufte të gjatë e të vështirë, në të cilën pa dyshim kapitulli i padrejtësive në dëm të kombit tonë peshon rëndë, por ku dy ngjarje të mëdha, fitorja e Pavarësisë dhe fitorja më e madhe e kurorëzuese e Revolucionit popullor, të arriitura në kundërshtim me një mori faktorësh pengues të brendshëm e ndërkombëtarë, shkëlqejnë me forcë të veçantë dhe përbëjnë provën më bindëse të vitalitetit të Popullit shqiptar, të aftësive të tij përtërësese.

ALFRED UÇI

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT SI FAKTOR KULTUROR NË RILINDJEN KOMBËTARE

Lidhja Shqiptare e themeluar në Prizren është një nga lëvizjet më të rëndësishme shoqërore në historinë e kombit tonë, që la gjurmë të pashlyeshme dhe që ndikoi fuqimisht mbi gjithë anët e jetës së tij. Studimet tona historike kanë ndriçuar gjithësesi përbajtjen e saj si një lëvizje e madhe politiko-ushtarake e popullit shqiptar, por ato më pak i kanë kushtuar vëmendje aspektit kulturor të kësaj lëvizjeje. Për këtë arsyе në referatin tonë do të përpinqemi të karakterizojmë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit si një faktor kulturor në Rilindjen Kombëtare dhe do të vëmë në dukje gërshetimin e veprimitarisë politiko-ushtarake me atë kulturore që spikati në të dhe që përbën një veçori qenësore të gjithë historisë së lëvizjes së popullit tonë për qirimin kombëtar. «Populli ynë, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — nuk e ka ndarë kurrë «dyfekun me gjalmë» nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën nga puna. Pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjakë në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri, pavarësi, tokë, të drejta e përparrim».¹

Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk ishte një ngjarje e rastit, por përbënte një hallkë me rëndësi të veçantë në vargun e atyre proceseve ekonomike, sociale, politike, ideologjike dhe kulturore, që u afkumuluan dhjetra e dhjetra vite para saj dhe kurorëzim i të cilave u bë ajo. Qysh në vitet 20-30 të shek. 19 betejat e pareshtura të popullit tonë për liri kundër zgjedhës osmane i shoqëruan hap pas hapi edhe përpjekjet për

1) E. Hoxha, *Raporte e Fjalime 1972-1973* Tiranë 1974, f. 429.

kulturë e ideologji kombëtare, që i dhanë nismën Rilindjes Kombëtare, e cila u përvijua dhe u ngrit në një shkallë më të lartë gjatë dhe pas Lidhjes së Prizrenit.

Eshtë e vërtetë se problemet politike, ushtarake dhe diplomatike patën përparësi në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit megjithatë ajo jo vetëm nuk i la pas dore problemet e kulturës, por luajti një rol të shquar edhe në këtë fushë. Gati gjithë ideologët e saj e theksonin se, krahas veprimitarisë politiko-ushtarake, Lidhja duhej të merrte kuptimin edhe të një faktori kulturore.

Roli kulturor i Lidhjes Shqiptare u shfaq në shumë drejtime e mënyra, duke zgjidhur imediatish disa probleme të ngutshme të lëvizjes për kulturë kombëtare, por edhe duke ushtruar ndikim më të largët mbi zhvillimin e kulturës së epokës së Rilindjes në përgjithësi. Ajo i dha një shptytje të madhe dhe një vrull të ri lëvizjes kulturore, e ngriti atë në një shkallë më të lartë.

Roli i Lidhjes Shqiptare në planin kulturor qëndron, para së gjithash, në hartimin prej saj të programit të zhvillimit të kulturës kombëtare, që ishte pjesë organike, e pandarë e programit të autonomisë territoriale administrative. Qysh në dokumentet më të para zyrtare të Lidhjes Shqiptare theksohej se kombi shqiptar kishte krijuar e ruajtur gjatë historisë së tij një kulturë me veçori të qarta kombëtare. Së këtejmi argumentohej domosdoshmëria historike e mbrojtjes së individualitetit dhe originalitetit të kulturës së popullit tonë. «Shqipëria nuk mund t'i bashkohet Greqisë; — thuhet në Memorandum e 13 qershorit 1878, — ndryshime të thella kombësie, gjuhe, dokesh dhe kulture e bëjnë të pamundur bashkimin; Shqipëria nuk do të durojë kurrë sundimin sillav, qoftë kur vjen nga kufijtë e Bullgarisë, qoftë kur vjen nga kufijtë e Malit të Zi. Shqipëria nuk do të jetë kurrë turke dhe këtë e provojnë katër shekuj e ca luftë për të ruajtur të parakur karakterin, traditat dhe fizionominë kombëtare. Feja e saj mund të ketë lëvizur pjesërisht nga ortodoksia te islamizmi dhe nga ky te katolicizmi, por qofshim ortodoksë, myslimanë ose katolikë, shqiptarët nuk e kanë mohuar kurrë Atdheun e tyre dhe, duke i qëndruar me këmbëngulje besnikë krenarisë për prejardhjen e tyre, kanë mbetur kurdoherë dhe kudo shqiptarë».²

2) *Akte të Rilindjes Kombëtare shqiptare 1878-1912*, bot. 1978, f. 24-25.

Programi kulturor që parashtrroi dhe mbrojti Lidhja Shqiptare parashikonte, së pari, njohjen zyrtare të gjuhës shqipe në përdorim të përgjithshëm brenda kufijve territorialë të shtrirjes së kombit, në sistemin administrativ, në kulturë dhe në gjithë sistemin ekzistues arsimor. Së dyti, programi kulturor i Lidhjes Shqiptare parashikonte krijimin e shkollave kombëtare shqiptare nga cikli i ulët dhe i mesëm deri në ciklet e larta dhe shpenzimin e një pjese të të ardhurave që grumbullohen nga vjelja e taksave brenda vendit në dobi të mbajtjes dhe përparimit të arsimit kombëtar. Së terti, programi i saj i jepte rëndësi mbrojtjes së njësisë së kulturës kombëtare, duke e vënë atë mbi ndasitë fetare e krahimore. Së katërti, në programin e Lidhjes Shqiptare theksohej se autonomia territoriale e politike duhej të shërbente si një mbështetje për një progres të gjithanshëm material dhe shpirtëror të kombit, për tu zhvilluar në rrugën e qytetërimit modern.

Me këtë përbajtje programi kulturor i Lidhjes së Prizrenit, si pjesë e pandarë e programit të saj të autonomisë politike territoriale, ndikoi fuqishëm në gjithë drejtimet e luftës për zhvillimin e kulturës kombëtare. Fakti që Lidhja Shqiptare nuk pati mundësi të verë në jetë këtë program, nuk e mohon aspak rëndësinë e tij si për atë kohë, ashtu edhe në të gjithë përpjekjet e mëpastajme për zhvillimin e kulturës kombëtare.

Në kohën kur ushtroi veprimtarinë e saj Lidhja Shqiptare, me përkrahjen e drejtpërdrejtë ose të tertiortë të saj u krijua një qendër e vetme kombëtare e drejtimit dhe e organizimit të lëvizjes për kulturë kombëtare. Një rol të veçantë luajti në këtë mes Komiteti i Stambollit për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare, i cili ishte jo vetëm një vatër e fryshtëzimit dhe e organizimit të Lidhjes Shqiptare, por edhe një shtab i vërtetë që drejtonte luftën për realizimin e programit kulturor të saj. Me iniciativën e tij nga fillimi i vitit 1879 u rikrijua Komisioni për hartimin e alfabetit të gjuhës shqipe, kurse më 12 tetor 1879 u themelua «Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip», që i dha një karakter më të organizuar e më të ndërgjegjshëm lëvizjes kulturore kombëtare.

Shoqëria e shkronjave nuk varej organizativisht e drejt-përdrejt nga organet e Lidhjes Shqiptare, por qëllimet themelore të tyre ishin të përbashkëta. Vetë Sami Frashëri e pat vënë në dukje këtë gjë në letrën që i dërgonte De Radës më 1881. «Pun'e vëllazërisë së shqiptarëve dhe e bashkimit e e

ngjalljes së Shqipërisë është punë e Lidhjes, që e ka zënë punënë shëndoshë edhe po vete gjithnjë mbarë; — shkruante ai — pun' e të ngjallurit të gjuhës shqipe, edhe të bashkuarit të dialekteve t'asaj, e të ndriturit të kombit tonë, që është një pun' e vejturë e e shenjtëruarë, është pun' e Shoqërisë sonë».³ Veprintaria e Shoqërisë dhe e Lidhjes Shqiptare, u shkri e u gërshetua në një mënyrë të tillë sa që shpesh është me të vërtet e pamundur t'i ndash e të përcaktosh se ç'u bë prej njerës dhe ç'u bë prej tjetër. Nuk është e rastit, që ideologët e frysmezuesit e Lidhjes Shqiptare — Sami Frashëri e Pashko Vasa, Abdyl Frashëri e Jani Vreto etj. qëndronin një-kohësish në krye të Komitetit të Stambollit dhe të Shoqërisë së shkronjave dhe bashkërenditnin veprintarinë e tyre me atë të Lidhjes së Prizrenit. Shoqëria e shkronjave dhe anëtarët e saj propaganduan platformën e Lidhjes Shqiptare dhe qëllimet e vërteta të saj, e mbrojtën atë duke hedhur poshtë shpifjet dhe gjenjeshtrat që përhapnin armiqtë e çështjes shqiptare, mbështetën veprimet e Lidhjes, përdorën argumente të ndryshme historike e politike, sociologjike dhe juridike, etnografike e antropologjike në të mirë të programit të Lidhjes.

Edhe pas mposhtjes së Lidhjes Shqiptare qendra kombëtare e drejtimit të lëvizjes kulturore vazhdoi të ekzistojë. Ajo ndikoi që lëvizja kulturore të zgjerohet edhe më tej në kolonitë shqiptare të vendeve të tjera dhe brenda vendit. Me iniciativën e saj u organizuan Degët e Shoqërisë së shkronjave në Bukuresht e në Konstancë të Rumanisë, në Aleksandri (Egjipt), në Sofie etj. Në shembullin e tyre më vonë dhe brenda vendit u krijuan shoqëri e klube kulturore në Shkodër, Prizren, Korçë, Berat e gjetkë.

Një nga problemet më të rëndësishme për krijimin e kulturës së re kombëtare, në shtruarjen dhe zgjidhjen e të cilët Lidhja Shqiptare dha një kontribut të shquar, ishte çështja e gjuhës shqipe që u bë strumbullari i gjithë luftës për kulturë kombëtare.

Interesimin për gjuhën shqipe e ndeshim shumë kohë para Lidhjes Shqiptare, mirëpo shumica e këtyre përpjekjeve nuk i nënshtronshin drejtpërdrejt qëllimit të zhvillimit të kulturës kombëtare; madje në disa raste ky interesim ishte në

3) *Buletin për shkencat shoqërore*, 1954, nr. 2, f. 115.

kundërshtim të hapët me këto qëllime, lindët në funksion të përhapjes së arsimit dhe kulturës së huaj ose fetare. Një varg linguistësh të huaj i kishte tërhequr gjuha shqipe kryesish si objekt hulumtimesh shkencore, si një fenomen i veçantë origjinal, linguistik. Ndryshe nga kjo tendencë, ideologët e Lidhjes Shqiptare Sami dhe Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vretua, Hasan Tahsimi etj. ashtu si pararendësit e tyre Veqilharxhi, Jubani kanë meritën se e shqyrtuan dhe e vlerësuan shqipen nga një kënd vështrimi i ri, si provën më bindëse të ekzistencës së kombit shqiptar, si mjetin më të rëndësishëm për të ndërtuar dhe zhvilluar kulturën kombëtare.

Në gjuhën shqipe rilindasit panë armën më të fuqishme që e shquante dhe që e kishte ruajtur kombin. Humbja e gjuhës për ta ishte e barabartë me humbjen e kombit. Gjuha shqipe, që i jepej shqiptarit me qumështin e nënës, ishte për rilindasit «xhevahiri i origjinës sonë», «e vëtmja përcuese e ideve të vërteta e të drejta të bashkëkombasve», «rojtarja besnikje, vigjilente e kombit», që e bënte të pamposhtur përballë pushtuesve të huaj. Rilindasit zbuluan fuqinë, bukurimë dhe madhështinë e kësaj gjuhe. Merita e tyre historike është se e afirmuan gjuhën shqipe si gjuhë kulture.

Gjuhën shqipe e pengonte seriozisht të përdorej për zhvillimin e shkencës, të artit dhe të kulturës kombëtare munugesë e një alfabeti unik. Ndonëse para Lidhjes Shqiptare ishin bërë shumë përpjekje për të krijuar alfabetin e gjuhës shqipe, në prag të saj ishte krijuar një gjendje kaotike nga përdorimi i shumë alfabeteve të ndryshme që sillte çorganizim dhe përcarje. Për këtë arsyesh që çështja e alfabetit mori në prag të Lidhjes Shqiptare një mprehtësi të veçantë, u bë vatër e diskutimeve ideologjike dhe një nga preokupacionet kryesore politike të lëvizjes kulturore. «Fjala e shkruar, — ka thënë shoku Enver, duke pasur parasysh këtë periudhë, — do të ishte si rrip transmisioni i rëndësishëm për tek masat, nëpër të cilin do të rridhnin si përrua idetë çlirimtare dhe zjarri i pasuar i njerëzve më të përparuar të kohës. Ajo do të shpërndante errësirën e të mbillte diturinë, do të zgjonte e do të kaliste ndjenjat kombëtare në zemrat e shqiptarëve, do t'i edukonte, do t'i lidhte e bashkonte më fort masat, do t'i hidhë ato në luftë për liri».⁴ Miratimi i alfabetit në qershor të 1879

4) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 6.

tregon rëndësinë që pati Lidhja e Prizrenit, fryma patriotike e së cilës i shtyu patriotët të linin mënjanë përçarjet e të bashkoheshin, duke e pranuar alfabetin e Stambollit si të vëmin që duhej të përdorej kudo e nga të gjithë.

Ideologët e Lidhjes Shqiptare sollën dhe mbrojtën një kuptim të ri pér rrugët e mjetet e përhapjes së kulturës. Mbi të gjitha këto mjete ata vinin arsimin kombëtar, shkollat. Nën nxitjen e drejtpërdrejtë të Lidhjes Shqiptare lufta pér kulturë kombëtare e përfshiu si pjesë të pandarë të saj luftën pér arsim kombëtar, pér shkollë kombëtare, që të përdorte si gjuhë mësimi gjuhën shqipe, pér shkollën laike, që të mos ishte nën ndikimin e klerit të prapambetur, obskuratorist e reaksionar pér një shkollë demokratike, popullore, e cila t'i kishte portat të hapura jo vetëm pér një pakicë, por pér gjithë bijtë e bijat e popullit. Programi i avancuar arsimor kombëtar i Lidhjes e shndërroi çështjen e shkollës në një vatër tjetër të luftës politike dhe ideologjike. Siç u shkrua me gjak abetarja e parë shqipe, me gjak u çelën dhe u mbajtën hapur edhe portat e shkollës shqipe. Përmes vështirësish të panumërtë e sakrificash u ngrit lëvizja pér arsim kombëtar dhe më 1887 u bë e mundur të çelej shkolla e parë shqipe, që përbënë te ërkësën kryesore të programit arsimor të Lidhjes së Prizrenit.

Arsimi nuk ishte vetëm shkolla, por edhe gjithë mjetet e tjera, që ndihmonin në përhapjen e diturisë, të shkençës dhe të kulturës kombëtare, botimet shkollore dhe jo-shkollore, gazetat, revistar, klubet, shoqëritë kulturore. Me ndihmën e tyre iu dha një impuls i fuqishëm gjithë jetës kulturore, që e pasuroi shpirtërisht kombin. Në kohën e Lidhjes Shqiptare morën hov të pamasë botimet shqiptare, dolën në drithë vepra monumentale të kulturës sonë kombëtare si «Bleta Shqiptare» e Th. Mitkos, «Alfabetarja e Stambollit», «E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët» e P. Vasës, «Apollogjia», «Për të vërtetën» dhe «Për gjithëçishten» të J. Vretos, «Gramatika e gjuhës shqipe» e S. Frashërit etj. Alfabetarja e Stambollit u shtyp në mijëra kopje. Në këto vite, mund të themi, vërshoi botimi i veprave të rëndësishme shkencore shqiptare me probleme historike, gjuhësore, etnografiike, folklorike, letrare etj. Një përhapje të madhe patën gazetat dhe revistar periodike. Ngjarjet e viteve 1879-1880 i përcollti gazeta «Zëri i Shqipërisë» e A. Kulluriotit, që botohej në Athinë dhe që u vu menjëherë në mbrojtje të Lidhjes Shqiptare. Drejtpërdrejt me të lidhet botimi në

Stamboll edhe i revistës «Drita» — «Dituria» (1884-1885). Gazetat dhe revistat shqiptare të kohës u bënë tribuna të vërteta të mendimit shqiptar, të luftës për çlirimin kombëtar.

Nga fundi i shek. 19 përmes përpjekjeve e një lufte të gjatë plot sakrifica kultura e re dhe e zhvilluar kombëtare s'ishte më një aspiratë, por përfaqësonë një realitet. Duke hedhur vështrimin prapa pas 20 e ca vjet përpjekjesh, Samiu dhe Naimi më 1899 në një letër që i dërgonin një miku të tyre konstatonin me gëzim se fara e mbjellë në ditët e Lidhjes Shqiptare kishte dhënë frutat: «Armiqt e kombit tonë donin të na gënjenin që prej kohe se gjuha shqipe është një gjuhë e prishur trashanike, nuk shkruhet e nuk mund të shkruhet; s'ka gramatikë, shkencat nuk mësohen me atë etj. Por në fund panë, — shkruajnë Naimi e Samiu, — se shqipja u bë, u shkrua, e u krijuat alfabeti i saj. U hartua gramma-tika. U shtypën librat e shkencës. U përkthyen poezi të bukurë prej çdo gjuhe të huaj. Me një fjalë, u kuptua se ç'gjuhë e përsosur dhe e rrëgullt është shqipja. Thonin se shkrimet e juaja s'i pranon kurkush. Por panë se muslimanë, kristianë e ortodoksë, të gjithë i pranuan. Shqipja filloi të shkruhet e të këndohet, anë e kënd Shqipërisë. Shkrimet e saja u pérhapën. U çelën shkolla».⁵

* * *

Lidhja Shqiptare ishte një faktor me rreze të gjatë veprimi në kohë. Kjo gjë duket sidomos në rolin që luajti ajo për kristalizimin e platformës ideologjike, që u vu në themel të kulturës së Rilindjes Kombëtare dhe që përcaktoi parametrat themelorë të kësaj kulture. Formulimi i kësaj platforme ideologjike të Rilindjes ka qenë një proces i gjatë, që kishte nisur shumë kohë para Lidhjes së Prizrenit, ka qenë një proces i dhimbshëm kérkimësh e gabimesh, arritjesh e iluzionesh. Është e vërtetë se forcat më të përparuara të kombit qysh në vitet 40-60 të shek. 19 kishin bërë të vetat idetë e përparuara të Veqilharxhit, të Jubanit, Pashko Vasës, por nuk ishin të pakta edhe ato forca shoqërore të kombit që në këtë kohë ushqenin mosbesim e mëdyshje, që kishin iluzione dhe lëkundje për forcën e lëvizjes nacionalçirimitare shqiptare dhe perspektivat e saj. Lidhja Shqiptare ishte ajo

5) *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, bot. 1972, f. 280.

sokëllimë e fuqishme që i zgjoi e i vuri në lëvizje gjithë forcat e kombit edhe ato që dremitnin dhe e çlroi një pjesë të tyre nga iluzionet. mëdyshjet dhe luhatjet. Ajo ndihmoi të formulohej një platformë e qartë, me të vërtetë revolucionare, që frymëzoi dhe i orientoi ideologjikisht gjithë përpjekjet për kulturën kombëtare deri në fitoren e pavarësisë së vendit.

Në themel të kësaj platforme ideologët e Lidhjes Shqiptare — S. Frashëri, P. Vasa, J. Vretua, Hasan Tasimi, Koto Hoxhi etj. — vunë një koncept të ri për kulturën. Për ta kultura ishte, para së gjithash, një vizion i ri, më i përparuar mbi botën, një mënyrë e re e konceptimit të jetës, një kuptim i ri i historisë dhe i perspektivave të saj. Ajo ishte një lëvizje e fuqishme intelektuale për rivlerësimin e të gjitha vlerave, që e pasuroi botën shpirtërore të shqiptarit me frymën e saj kritike ndaj çdo paragjykimi, që rrëzoi idhuj e mite të vjetër dhe formuloi kërkesa për vlera të reja kulturore. Kultura për rilindasit ishte një ideal i ri shoqëror, politik, moral, që bartte me vete projektin e madh të krijimit të një realiteti të ri, projektin e Shqipërisë së pavarur e të lirë.

Ideologët e Lidhjes Shqiptare e kuptionin rëndësinë e dijeve për kulturën. Ata ishin partizanë të flaktë të iluminizmit dhe besonin në forcën e dijeve. Progresi, qytetërimi, sipas tyre, nuk mund të përfytyrohen pa dije. Thelbin e këtij koncepti iluminist mbi kulturën e shprehu N. Frashëri me moton e tij të famshme: «Dhe drit' e diturisë, përpara do na shpjerë!». Mirëpo kultura, për ideologët e Lidhjes së Prizrenit, nuk ishte vetëm një depozitë dijesh, por në radhë të parë ishte aftësi për qëndrime aktive, krijuese në histori, në gjithë fushat e jetës, materiale e shpirtërore. Akti dhe veprimi më i rëndësishëm i popullit tonë, si forcë kulturore për rilindasit, ishte vetë lufta e tij për liri e pavarësi, qëndresa e tij e pamposhtur, kundërshtimi i shtypjes dhe i robërisë.

Shpirti i gjallë i kulturës së re u bë nacionalizmi shqiptar, idea e shqiptarizmës, e formuluar nga P. Vasa në «marsejezën» shqiptare «Mori Shqypëni, e mjera Shqypëni», që tingëlloi e fuqishme dhe krenare në rrjeshtat e luftëtarëve të Lidhjes së Prizrenit qysh në orët e para të saj:

«Conju, o Shqypëtarë, prej gjumi conju,
të gjithë si vllazën në një besë shtrengonju,
dhe mos shikoni kisha e xhamia,
fe e shqypëtarit ashtë Shqypëtarija.»

Idea e shqiptarizmës në kohën e Lidhjes Shqiptare përbënte aktin e parë dhe më të rëndësishëm të emancipimit të madh të kulturës së Rilindjes, që fitoi frymë kombëtarë. Ajo mposhti karakterin abstrakt të lëvizjes iluministe dhe ia nënë-shtroi gjithë përpjekjet për kulturë luftës për çlirimin kombëtar. Idea e shqiptarizmës u bë vatra ku përqëndroheshin dhe prej nga rrezatoheshin gjithë erërat e reja, gjithë drejtimet e reja ideologjike, që përhapi dhe përkrahu Lidhja Shqiptare.

Lufta për kulturë, që u zhvillua në kohën e Lidhjes Shqiptare në suazën dhe nën ndikimin e saj, ishte para së gjithash luftë për kulturë kombëtare, për një sistem dijesh, vlerash dhe veprimesh që cimentonin unitetin e jetës materiale dhe shpirtërore të kombit shqiptar, që i ruanin atij vetë-qenien e origjinalitetin, që e ndihmonin të ekzistojë i pavarur dhe i lirë. Në krye të hierarkisë së vlerave kultura e re kombëtare vuri pavarësinë, lirinë dhe përparimin e Atdheut.

Kultura kombëtare e Rilindjes ishte një akt madhor historik i emancipimit të kombit shqiptar, që tashmë kishte në duart e tij një pasqyrë, ku shihte në radhë të parë veten e tij, por edhe gjithë ç'ndodhë dhe ç'ekzistonte përreth. Kultura është gjithmonë një akt vetnjohjeje i njeriut, i popujve dhe i njerëzimit. Pa kulturën kombëtare të Rilindjes shqiptari i shek. 19 nuk do të kishte mundur ta dallonte veten si komb të formuar, nga gjithë të tjerët, të kuptonte gjendjen dhe rreziqet që i kanoseshin, të kuptonte ku të mbësh-tetej dhe përsë t'luftonte. Kultura kombëtare e Rilindjes ishte një zbulim i madh. Ajo zbuloi botën shqiptare me gjithë madhështinë dhe tragjizmin e historisë së saj, ajo zbuloi një të kaluar sa të lavdishme e heroike aq edhe të dhimbshme e të përvuajtur, ajo zbuloi ekzistencën në mjerim dhe prapambetje të popullit, por edhe aftësitë e një populli, që qëndronte i pamposhtur, i papërkulur përballë rrebesheve dhe furtunave më të rënda të historisë, ajo zbuloi jetën, traditat, zakonet, psikologjinë e një populli luftëtar e punëtor, trim e guxiimtar, me shpresë e besim në një të ardhshme të ndritur. Kultura kombëtare e Rilindjes prapa emërtimeve «arnaut», «kaur», «toskë», «gégë», «mysliman», «lab», «korçar», «mirditas», që përdörnin të huajtë, zbuloi shqiptarin dhe u dha një emër të përbashkët, emrin e Shqipërisë, trojeve, ku nga kohët parahistorike kishin jetuar brez pas brezi gjyshrit e stërgjyshrit e tyre. Kjo kulturë ishte faktor zgjimi i vetëdijes kombëtare e i përgjegjësisë sociale përfatet e kombit; ajo i

dha një kuptim krejt të ri jetës së shqiptarit, i kultivoi krenarinë kombëtare, i dhuroi dinjitetin e përkatësisë kombëtare, së cilës Naimi i këndoi:

Ti Shqipëri më ep ndërë, më ep emrin shqipëtar,
Zemrën ti ma gatove, plot me dëshirë e me zjarr!

Kultura kombëtare e Rilindjes sillte me vete sihariqin e madh të daljes në arenën e historisë botërore të një kombi të ri, të kombit shqiptar dhe shprehte para botës aspiratat dhe idealet e tij përliri dhe pavarësi.

Pavarësia përkulturën nuk është thjesht një ornament që e zbuluron, as vetëm një ideal, por është edhe një *kusht esencial* për zhvillimin e saj. Regjimi otoman e kishte nxjerrë kulturën tonë kombëtare jashtë ligjit, ajo bënte jetë të nëndheshme ilegaliteti, ndeshej në çdo hap me pasojet e robërisë dhe me atmosferën imbytëse të obskurantizmit anadollak. Duke i zgjuar ndjenjat kombëtare shqiptarit, kultura kombëtare e bënte atë t'i rëndohej edhe më shtypja, t'i bëhej më e paduruar robëria, të ndjente thellë zymtësinë e palirisë. Ja përsë lufta përkulturë kombëtare nuk mund të mos gërshtohej e të mos shkrihej me veprimitarinë e Lidhjes Shqiptare, me luftën e saj përtë vënë në jetë programin e autonomisë territoriale, politike, madje, edhe të pavarësisë së plotë, në suazën e së cilës kultura kombëtare do të gjente kushtet më të përshtatshme përlirim e saj të lirë.

Një akt tjeter i madh emancipimi i kulturës sonë kombëtare të Rilindjes ishte shkëputja e saj nga ndikimet, që i sillnin ato kultura ose, më mirë të themi, ato «antikultura» që pretendonin për role dhe hegemoni zonale apo botërore dhe që përbënë një kërcënim të madh përkulturën dhe përvetë ekzistencën e kombit tonë. Kjo nuk ishte një betejë më e lehtë se ato që zhvilloi Lidhja Shqiptare kundër ushtrive pushtuese.

Kulturës sonë të re kombëtare i duhej para së gjithash të ngrihej kundër presionit shkombëtarizues të kulturës së pushtuesve osmanë, që përligjte prapambetjen kulturore e injorancën, që turbullonte mendjet me hashashin e fanatizmit dhe obskurantizmit, që përpinqej ta mbante kulturën shqiptare larg korenenteve të reja përparimtare të kulturës botërore. Kulturës sonë kombëtare i duhej të ngrihej edhe kundër së ashtuquajturës «kulturë neobizantine», që binte erë temjan nga misticizmi kristian dhe prapa së cilës qëndronin sidomos synimet ekspansioniste të megalidesë, të Fanarit, por

edhe përpjekjet pér hegjemoni në botën ortodokse të Ruse-së, qëllime këto që maskoheshin me parullën e «rindërtimit të Bizancit të ri», e «mbrojtjes nga barbaria e hordhive osmane dhe nga islamizimi». Kulturës sonë të re kombëtare i duhej të luftonte edhe me presionin e kulturës katolike të Perëndimit, me kultprotektoratin e saj, në mbrojtje të së cilës qëndronin herë Vatikani, armik i betuar i lirisë, pavarësisë e progresit, kështjellë e vjetër e Mesjetës dhe e feudalistit, dhe herë Austro-Hungaria.

Rreziku që i vinte kombit tonë nga ndikimet e këtyre kulturave ishte i madh sepse në perandorinë osmane ato njiheshin zyrtarisht, propagandoheshin lirisht, gjithë privilegjet e mundshme dhe ishin në një aleancë të vërtetë me Portën në përpjekjet e përbashkëta pér shkombëtarizimin e popullit tonë. Ato përbënин një rrezik të madh gjithashtu sepse mbështeteshin në tradita të laشتë, në fanatizmin fetar, në fuqinë e shteteve që i përkrahnin. Ato dispononin mjete të shumta materiale, financiare e shpirtërore, e kishin mbuluar vendin me një rjetë të organizuar institucionesh — kisha e xhami, shkolla, shtypshkronja, gazeta, revista etj. E megjithë këtë, ideologët e Lidhjes Shqiptare guxuan të ngriheshin kundër «shkëlqimit» dhe «madhështisë» së rreme të këtyre kulturave, kundër mykut dhe vjetërsirave të tyre, duke u bërë një sfidë të madhe. Kjo ishtë një luftë e vështirë, sepse ndikimet e këtyre kulturave ishin ende të fuqishme në shtresa të caktuara të prapambetura të popullsisë, madje ajo ishte e vështirë sepse bëhej edhe brenda vetes, të shqiptar që nuk ishte çliruar ende nga këto ndikime. Kultura e re e Rilindjes kishte vitalitet t'u kundërqëndronte forcave kulturore, reaksionare, sepse i kishte rrënjet thellë në tabanin kombëtar, në popull.

Kultura jonë e re nuk iu kundërvu «Orientit», pér t'u bëre «oksidentale» dhe nuk shikoi nga Evropa që të bëhej një amalgamë apo një shartim artificial i të dyjave, por pér të qënë e pér t'u rritur si kulturë origjinale shqiptare. Me karakterin e saj kombëtar kultura jonë e Rilindjes i mbyllte portat pér korrentet ideologjike shkombëtarizuese dhe në të njëjtën kohë ajo shenonte edhe një hapje; më të madhen hapje që kishte parë kultura jonë deri atëhere, ndaj vlerash të kulturës përparimtare botërore, që mund ta pasuronin. Ideologët e Lidhjes Shqiptare kishin respekt pér vlerat përparimtare të çdo kulture, ndonëse ata ishin aq të thellë sa të dallonin jo vetëm frymën e vjetër të tre kulturave që pér-

mëndëm, por gjithashtu, se Evropa e çerekut të fundit të shekullit 19 nuk ishte më ajo e kohës së Rilindjes dhe e iluminizmit, e 1789 dhe 1848, por ishte një Evropë, e trembura nga Komuna e Parizit, një Evropë që kishte marrë në epokën e imperializmit rrugën e pushtimeve të pangopura koloniale.

Koha e Rilindjes u bë koha kur kombi ynë vendosi e hyri në lidhje intensive me kulturën përparimtare botërore, kur përfitoi më shumë se çdo herë tjetër nga thesaret e saj, nga ajo e Perëndimit, por edhe e Lindjes, nga antikiteti i lashtë dhe nga ajo e Rilindjes evropiane, nga kultura e klasicizmit, iluminizmit dhe romantizmit, nga kultura demokratike e vendeve të tjera. Në ato ditë, kur qëndronin në llogore luftëtarët e Lidhjes Shqiptare, ideologët e saj gjenin kohë dhe e quanin të dobishme të përkthenin Iliadën e Homerit dhe dialogët e Platonit, fabulat e La Fontenit dhe poezitë e Hugoit etj. Përmes veprave të rilindasve tanë erdhë në Shqipëri fjala demokratike dhe emri i Bekonit dhe i Dekartit, i Spinozës dhe i Lajbnicit, i Shilerit dhe i Gëtes, i Volterit dhe i Rusoit, i Bajronit dhe i Firdusiut etj. Kësaj hapjeje të madhe kultura jonë kombëtare, ndonëse e re e brishtë dhe e paplotësuar në të gjitha hallkat e saj, nuk i trembej sepse e mbronte karakteri i saj kombëtar në përbajtje e në formë, e mbrontë frëma e shqiptarizmës. Me origjinalitetin e saj kombëtar, ajo mësonte të merrte ç'i hyrte në punë nga thesaret e kulturës botërore dhe njëkohësisht përfshihej si pjesëtare aktive në sërfrën e kulturës përparimtare botërore.

Në vorbullën e ngjarjeve të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kultura e rë kombëtare bëri një hap të rëndësi shëm në rrugën e emancipimit të saj nga fetë, nga botëkuptimi fetar, duke përforcuar një përmasë tjetër të saj dalluese, karakterin laik, mbifetar. Në shekullin 19 kombi ynë u ndodh i ndarë në tri besime të ndryshme, që përfaqësonin edhe tri kultura të ndryshme fetare. Historikisht tek mjافت kombe, lufta për kombësinë ka përkuar me luftën për fe, kurse tek ne përkundrazi, lufta për kombësi e pavarësi objektivisht e nënkuptonë si një komponente të saj luftën kundër ndasive, përçarjes e fanatizmit fetar, kundër klerikalizmit, meqenëse fetë ishin vegla në duart e pushtuesve të huaj ose të shtetëve shoviniste. Ngjarjet e kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit provuan edhe njëherë se ç'rezik përfaqësonë përfatet e kombit përçarja që sillnin fetë. Prandaj ideologët më të përparuar të Lidhjes qysh në fillim e bënë idenë e shqiptarizmës

atë bosht që mund t'i bashkonte shqiptarët pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare dhe që i jepte kulturës së re kombëtare karakter laik mbifetar, civil. Nuk është e rastit që konceptit të kulturave fetare ata i kundërvunë konceptin e qytetërimit, i cili nënkuptonte pavarësinë e lirinë e kombit, zhvillimin e kulturës kombëtare, të progresit teknik e shkencor, të industrisë, dijeve dhe artit.

Këtë karakter iluminist e laik si tendencë të kulturës së re kombëtare nuk e mohon aspak fakti që ideologët e Rilindjes shqiptare nuk qëndronin në pozitat e ateizmit, nuk e mohojnë as bektashizmi i Naimit, as lëshimet e tjera që ata u bënë besimtarëve. Madhështia e vërtetë e tyre qëndron pikërisht në faktin se ata ishin për një kulturë që ndihmonte për të imposhtur fanatizmin dhe intolerancën fetare. Duke qenë realistë, ideologët e Lidhjes Shqiptare e kuptionin se fetë vazhdonin të kishin ndikim mbi një masë të caktuar shqiptarësh, në mendjet e zemrat e të cilëve ata kërkonin të mbillnin idenë e shqiptarizmës. Prandaj në kushtet konkrete shqërore me karakter tranzitor të shek. 19 gjëjmë burimin e antinomisë midis iluminizmit luftarak, që i jepte karakter laik, mbifetar kulturës së Rilindjes dhe tolerancës fetare. Ne i njohim mirë kufizimet historike të botëkuptimit të rilindasve, por s'mund të kërkojmë prej tyre të pamundurën. Është e vërtetë se ata nuk ndërtuan edhe nuk mbrojtën një filozofë materialiste, por ata kanë meritën se i dhanë botëkuptimit të tyre ato tipare origjinale, ato nuanca, që e vunë atë tërësisht në shërbim të luftës për çlirimin e Atdheut. Me trajtën deiste që i dhanë botëkuptimit të tyre dualist, Jani Vretua dhe mendimtarë të tjerë të Rilindjes u limin hapësirë të gjerrë iluminizmit e shkencave, antiklerikalizmit dhe shqiptarizmës, ashtu si panteizmi i Naim Frashërit dhe i De Radës ishte një rrugë për t'i afuar gjithë shqiptarët, besimtarë e jo të tillë, me idealet e çlirimt kombetar.

*

* * *

Në të gjitha dokumentet zyrtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është shprehur shqetësimi për prapambetjen e theksuar kulturore të vendit dhe është theksuar nevoja e krijimit të një kulture të zhvilluar refleksive. Kultura e vërtetë fillon edhe aty ku nis interesimi dhe studimi i historisë së

kulturës. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit u zgjua dhe u forcua si kurrë ndonjëherë tjetër interesimi i shqiptarëve për traditat kulturore të së kaluarës, por në mungesë të një kulture refleksive të zhvilluar, rilindasit vëmendjen e përqëndruan në traditat e pasura e të lashta të kulturës popullore. Ideologët e Lidhjes ishin të vetëdijshëm se kultura popullore, ndonëse nuk e kishte nivelin e kulturës refleksive, përbante një varg epërsish, që e bënin pikënisje dhe pikëmbështetje për të krijuar dhe zhvilluar kulturën refleksive kombëtare. Kjo gjë e rriti interesimin e tyre për të zbuluar, njohur e grumbulluar pasuritë e kulturës popullore. Duke rrëmihur në hambarët e saj, ata gjetën thesare të vërteta, vlera të mrekullueshme e të pavdekshme, që i përfshinë në «Rapsodi të një poeme shqiptare» (1866) të De Radës, «Përbledhje këngësh popullore dhe rapsodi shqiptare» (1871) të Z. Jubanit, «Bleta Shqiptare», e Th. Mitkos (1878), «Valët e detit» (1908) e S. Dines, pa të cilat, trashëgimi kulturor i popullit tonë do të kishte një zbrazësi të ndjeshme. Në qëndrimin e ideologëve të Lidhjes Shqiptare të bie në sy respekti i tyre i pakufishëm ndaj të gjitha vlerave materiale e shpirtërore, që pat krijuar populli ynë në të kaluarën. Ata kishin një koncept të gjerë për kulturën popullore, në të cilën përfshinin jo vetëm gjuhën e krijmtarinë artistike, por edhe vlera të tjera — zakonet e traditat, virtytet morale dhe urtësinë popullore, legjendat e këngët historike, fjalët e urta dhe vallet, trimërinë, besën, mikpritjen, arkitekturën popullore etj.

Rilindasit e vlerësuan lart kulturën popullore, sepse, së pari, ajo e zbulonte popullin tonë si një forcë kulturore krijuese, zbulonte talentin dhe dashurinë e tij për kulturë, aspiratën dhe aftësinë e tij për të ecur në rrugën e progresit e të qytetërimit.

Së dyti, kulturën popullore rilindasit e vlerësuan si dëshminë më të rëndësishme të lashtësisë, autohtonisë, vazhdimësisë dhe origjinalitetit të ekzistencës, të historisë dhe të jetës së popullit, të kombit tonë. Kultura popullore ishte për rilindasit shprehja më e drejtpërdrejtë dhe më e plotë e vetëqënies së pavarur të popullit shqiptar dhe një instrument i fuqishëm i afirmimit dhe i konsolidimit të kësaj vetëqënieje. Duke ruajtur e zhvilluar kulturën popullore, populli ynë kishte ruajtur veten si popull e si komb, kishte ruajtur gjithë ato cilësi që e shquatin nga popujt dhe kombet e tjera. «Në folklorin, — sipas Th. Mitkos, — duket fisi, karakteri, adetet

e zakonet e racës shqiptare»⁶. «Në këngët dhe në përrallat e vjetra të një populli, — shkruan S. Dinha, — ruhen zakonet, gjuha dhe historija e vet...»⁷. Rilindasit besonin se me origjinalitetin e saj kultura popullore shqiptare kishte qënë një nga armët kryesore të rezistencës së popullit përballë pushtuesve të huaj. Kultura popullore ishte një nga llogoret, istikamet kryesore të qëndresës shqiptare në çdo kohë.

Së treti, rilindasit çmonin në kulturën popullore fryshtën e saj kombëtare e demokratike, e vlerësonin atë si bartëse të vetme të idealeve demokratike, patriotike e revolucionare të masave punonjëse, që përbënforcën themelore të kombit në luftën e tij për liri e pavarësi.

Së katërti, rilindasit e vlerësonin kulturën popullore si një mjet të edukimit patriotik, si një mjet të bashkimit të popullit. De Rada thosh se folklori «do të bashkojë shqiptarët» dhe «do t'i bëjë të rrëmbejnë edhe njëherë shpatat luftarake në duart e tyre...»⁸.

Se ç'vlera të paçmueshme të kulturës refleksive kombëtare mund të krijoeshin, duke u mbështetur në kulturën popullore, e dëshmoi qartë krijimi i letërsisë së re artistike shqiptare të Rilindjes. Është e vërtetë se qysh para Lidhjes së Prizrenit kishte pasur përpjekje për krijimin e artit e të letërsisë së kultivuar kombëtare, por vetëm me Lidhjen Shqiptare letërsia shqipe e kultivuar hyri në periudhën e saj moderne. Në suazën e Lidhjes lindi nevoja për një art që t'i fryshtonte e t'i hidhte luftëtarët në betejat e saj, të armatosur me vetëdije të lartë kombëtare. Nuk është e rastit që atë kohë doli kënga madhore kombëtare «Moj Shqypni, e mjera Shqypni». Ngjarjet e kohës së Lidhjes së Prizrenit, betejat e saj u bënë burim fryshtimi për poetët e artistët e kohës dhe për ata që erdhën më vonë, që rrokën temën e luftës së qirimit kombëtar dhe që e bënë moto kryesore të krijimtarisë së tyre letrare.

Letërsia artistike e Rilindjes shënoi një etapë më të lartë, sepse mishëroi një koncept të ri e më të përparuar mbi artin, sepse fitoi një karakter të drejtpërdrejtë tendencioz kombëtar, duke u bërë zëdhënës i idealeve të qirimit kombëtar. Ndryshtë nga shumë krijime të letërsisë së mëparshme shqipe, që

6) Th. Mitko, *Bleta shqiptare* 1924, f. 11.

7) S. Dine, *Valët e detit*, 1908, f. 1-2.

8) Çështje të folklorit, Shkodër 1973, f. 41.

karakterizoheshin nga kufizime të rëndësishme, duke qënë të ndërtuara sipas modeleve të huaja ose me një gjuhë dialekto dhe fjalë të huaja, me brendi fetare ose të zhveshura nga idealet kombëtare, letërsia dhe arti i Rilindjes trajtuan kryesisht një tematikë me motive patriotike. Tema e luftës çlirimtare, e patriotizmit popullor aktiv, e lartësimit të traditave patriotike të lashta dhe e kultivimit të urrejtjes për gjithë armiqjtë e lirisë dhe të Atdheut u bë tema më e preferuar e letrarëve të Rilindjes. Kjo letërsi u zhvillua si art thellësisht i angazhuar dhe me tendenciozitet të theksuar politik. Letërsia e re e Rilindjes shërbeu si një pasqyrë e jetës kombëtare, zbuloi karakterin shqiptar, veçoritë e konstitucionit psikik kombëtar, të virtuteve dhe zakoneve të tij.

Letërsia artistike, që i bëri jehonë Lidhjes Shqiptare, shënoi një shkallë më të lartë zhvillimi, gjithashtu, me karakterin e saj thellësisht popullor. Ajo u bë zëdhënëse besnikë e aspiratave dhe e idealeve social-estetike të popullit, ajo ishte një letërsi që iu drejtua masave të gjera, një letërsi e afërt për to dhe e kuptueshme prej tyre. Këto cilësi ajo i fitoi si me përbajtjen e saj patriotike, ashtu edhe me formën e saj, që i përqasej natyrës dhe origjinalitetit të gjuhës shqipe. Letërsia e Rilindjes thithi për herë të parë përvojën pozitive të krijimtarisë popullore, u mbështet fuqimisht në atë. Përvoja estetike e folklorit forcoi origjinalitetin dhe frymën e saj populllore. Letërsia e Rilindjes fitoi karakter popullor sepse vuri në qendër të saj popullin dhe e paraqiti si subjekt të një historie të lavdishme. Fryma popullore e kësaj letërsie bëri të mundur që ajo të ushtronte një ndikim të madh e të shumanshëm në popull, të depërtonte në shtresat më të ndryshme të kombit, të kalonte gojë mië gojë, ashtu si folklori dhe të vinte e gjallë dhe vepruese deri në ditët tona.

Misionin e saj historik shoqëror letërsia e Rilindjes e plotësoi, sepse krijoi vlera të përsosura artistike. Potenciali i fuqishëm estetik i kësaj letërsie u shpreh në zgjerimin e horizontit tematik e gjinor të saj, në forcën e madhe ekspressive, në themelët e shëndosha estetike. Duke përfituar nga arti klasik përparimtar botëror, letërsia jonë e Rilindjes, me karakterin e saj kombëtar, fitoi një fizionomi të saj origjinale edhe në planin metodologjik krijues, pa u bërë një përshtatje e thjeshtë e parimeve të klasicizmit, romantizmit ose metodave të tjera krijuese që ishin në qarkullim. Ajo arriti majë të atilla, të cilat për herë të parë i dhanë vend letërsisë shqiptare në letërsinë botërore. Këtu s'është fjalë vetëm për Milosaon.

që u mirëprit qysh atëherë nga një numër i madh letrarësh më autoritet të vendeve evropiane, por edhe për veprat e Naimit, të Çajupit etj. që janë përkthyer në gjuhë të tjera dhe që vazhdojnë të pëlqehen edhe sot e kësaj dite.

* * *

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë historike të Lidhjes Shqiptare ka qenë roli i madh e i drejtpermëdhetje i saj në krijimin e kulturës politike kombëtare, e cila i priu gjithë kulturës së Rilindjes dhe u dha gjithë pjesëve të saj një karakter të theksuar tendencioz politik. Studimet tonë, që kanë nxjerrë në pah shumë vlera të kulturës kombëtare të Rilindjes, nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur njoftues së vlerave të kulturës politike kombëtare të kësaj epoke, sepse shpesh veprimtaria kulturore barazohet vetëm me veprimtarinë iluministe arsimore, shkencore e artistike, kurse prej saj përfjashtohet veprimtaria politike. Mirëpo që mund të ketë edhe politika **vlerë kulturore**, që ka kuptim të flitet për **kulturë politike**, si pjesë e pandarë e kulturës së përgjithshme të një kombi ose klase, këtë e tre-gon më së miri edhe veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Prandaj do të ishte e njëanshme të karakterizonim veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare dhe të mos përfillnim kontributin e saj të shquar në krijimin e kulturës së re politike të popullit tonë, vlerat e së cilës rilindasit i përfshinin në konceptin e qytetërimit dhe i konsideronin si një nga mjetet e domosdoshme të luftës përliri, pavarësi e progresi.

Kultura politike, që u përpunua nën ndikimin e Lidhjes së Prizrenit, pati në themel të saj një konceptim të ri të problemeve të jetës politike të kombit dhe një qëndrim të ri të masave të gjera ndaj politikës. Kultura politike e Rilindjes u shpreh para së gjithash në formulimin dhe në luftën për realizimin e një politike **shqiptare**. Vetë Lidhja Shqiptare dhe veprimtaria e saj politike ishin mishërimi më i gjallë dhe akti më i rëndësishëm i politikës shqiptare nga koha e Skënderbeut dhe deri në pragun e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912.

Deri në prag të Lidhjes së Prizrenit politika konsiderohej

si një çështje e kombeve të tjera, si e drejtë ekskluzive e pushtuesve, e Portës, e fuqive të mëdha, e Evropës, e diplomacisë së huaj. Zgjedha e robëria e kishin mënjanuar de jure e de facto popullin shqiptar si subjekt të politikës brenda perandorisë otomane dhe në arenën ndërkombe të, kurse Lidhja e Prizrenit tregoi se politikë mund dhe duhej të bën edhe shqiptarët. Politika shqiptare, si veprimtari që shprehë dhe mbronte interesat kombëtare, që afirmonte ekzistencën dhe të drejtat e kombit shqiptar, u bë me të vërtetë faktor i rëndësishëm i emancipimit të përgjithshëm ideologjik, politik e kulturor të popullit tonë.

Veprimitaria e Lidhjes Shqiptare, si kulturë politike, u shpreh edhe në aktivizimin e gjerë të masave në veprimitarinë e saj politike, në politikën shqiptare. Populli ynë kishte marrë pjesë edhe në të kaluarën në luftëra e lëvizje politike, në kryengritje të armatosura, por gjatë Lidhjes Shqiptare veprimitaria politike e popullit shqiptar u ngrit në një nivel më të lartë që u karakterizua nga pjesëmarrja e gjerë e masave në të, nga ndërgjegjja e lartë e tyre patriotike, nga shkrirja e luftës së armatosur me luftën diplomatike. Në suazën e Lidhjes populli krijoi organet e tij të vetëqeverisjes kombëtare dhe hyri në rrugën e veprimit si forcë e organizuar shtetërore, si subjekt i pushtetit të ri shtetëror. Gjatë Lidhjes Shqiptare Shqipëria doli dhe veproi aktivisht në arenën diplomatike ndërkombe të. Ideologët e Lidhjes Shqiptare e theksonin se ajo s'ishte krijim artificial i një elite, i një parësie, por i kishte rrënjet thelli në masat, ishte një organizim politik i vetë masave. Ata që shpallën Lidhjen Shqiptare, — shkruante Pashko Vasa, «nuk ishin as krerë, as njerëz me influencë. Ata folën në emër të popullit shqiptar, sepse ishin vetë populli... dhe pasi e shpallë u zhdukën, hynë përsëri në gjirin e popullit prej të cilit kishin dalë».⁹⁾

Në luftën e Lidhjes Shqiptare për të zbatuar politikën shqiptare u formua dhe u rrit një plejadë e tërë politikanësh të shquar shqiptarë, që luajtën një rol të madh, politikanë të devotshëm për çështjen shqiptare dhe me prestigj e autoritet të madh si tek masat, ashtu edhe në arenën ndërkombe të.

9) Akte të Rilindjes kombëtare shqiptare 1878-1912. f. 67.

Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Ismail Qemali, Jani Vreto, Zija Prishtina, Sulejman Vokshi, Iliaz Dibra etj.

Një nga vlerat kryesore të kulturës politike të Rilindjes Kombëtare ishte edhe **mendimi i ri, i përparuar politik me karakter kombëtar**, që u shpreh në dokumentet kryesore zyrtare e jozyrtare të Lidhjes Shqiptare dhe në një varg traktatesh politike si «E vërteta mbi Shqipërinë e shqiptarët» (1878) e P. Vasës, «Apologjia» (1878) e J. Vretos, «Shqipëria ç'ka qënnë, ç'është e ç'do të jetë» (1899) e S. Frashërit dhe në një mori artikujsh politikë të Abdyl Frashërit, Thimi Mitkos, Th. Krejt, Th. Brandit, A. Kulluriotit, Shahin Kolonjës etj.

Mendimi politik i Lidhjes Shqiptare dhe i Rilindjes luajti një rol shumë të rëndësishëm në formimin e ndërgjegjes kombëtare, në të cilën solli ideale dhe koncepte të reja politike si konceptet e «atdheut», «lirisë», «barazisë», «drejtësisë», «pavarësisë», «interesit kombëtar», autonomisë etj. Mendimi politik i Rilindjes i dhuroi ndërgjegjes së kombit një varg të téré idesh të reja se «Perandoria otomane ishte një i vdekur që duhej varrosur sa më parë», se «shpëtimi i Shqipërisë ishte një dorë të shqiptarëve», se «ngjallja e Turqisë është vdekja e Shqipërisë», se «nuk kemi nevojë për princëra e mbretër, që të na pinë gjakun» dhe sa e sa të vërteta të tjera, që tingëlluan në kohën e Lidhjes Shqiptare dhe më vonë si sihariqe të mëdha për kombin.

Mendimi i përparuar politik i Rilindjes i zbuloi dhe i bëri të njobura **interesat e veçanta të kombit shqiptar** dhe i shpalli ato si kriter themelor të vlerësimit të gjithë ngjarjeve dhe veprimeve politike të kohës brenda vendit, në perandorinë otomane dhe në arenën ndërkombëtare.

Mendimi politik rilindas u përf tua drejtpërdrejt nga përvoja historike e popullit tonë, e luftërave të tij në kohën e Skënderbeut e më vonë, nga përvoja tragjike e synimeve për autonomi të Ali pashë Tepelenës dhe Bushatllinje, e kryengritjeve fshatare të periudhës së Tanzimatit dhe sidomos e Lidhjes së Prizrenit. Që këtej ai provoi konkluzionin se shqiptarët s'kishin nga e prisin shpëtimin veçse nga vetja e tyre, se një komb që pret shpëtimin nga të huajtë, s'mund të meritonte veç skllavëri.

Një meritë e rëndësishme historike e mendimit politik rilindas ishte se ai zbuloi natyrën kolonizuese, ekspansioniste

të politikës së Evropës imperialiste të cerekut të fundit të shekullit XIX, që ishte e angazhuar e tëra në luftën për rindarjen e sferave të influencës dhe për pushtime koloniale. Mendimi i përparuar politik rilindas i ndihmoi shqiptarët që të mos u besonin politikës dhe kombinacioneve diplomatike që bëhen shin nga Evropa imperialiste në kurriz të Shqipërisë. Sami Frashëri, duke demaskuar thelbin shovinist të politikës së fuqive imperialiste dhe të shteteve fqinje, theksonte: «Secili shikon të fitonjë vetë e të hajë shoknë. Kombet janë si peshqit që hanë njëri tjetrin. **Mjerë kush është i dobët?**»¹⁰

Duke njojur interesin kombëtar dhe duke e vendosur në themel të politikës shqiptare, mendimi politik i rilindasve një-kohësish distancohej nga shovinizmi dhe nacionalizmi reaksionar borgjez. «Ne dëshirojmë nxehësisht të jetojmë në paqe me të gjithë fqinjët tanë, Malin e Zi dhe Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë, — thuhej në proklamatën e 30 majit të 1878 të Komitetit Qendror për të mbrojtur të drejtat e kombit shqiptar. Ne nuk duam dhe nuk kërkojmë asgjë prej tyre, por jemi krejtësisht të vendosur të mbrojmë me këmbëngulje çdo gjë që është e jona. T'u lihen shqiptarëve tokat shqipëtare»¹¹ «Nuk jemi eksklusivistë, — shpalaj në një deklaratë tjetër të Lidhjes. — Duam vendin tonë, por duam aq dhe ndoshta më shumë të vërtetën dhe drejtësinë».

Mendimi i përparuar politik rilindas ka meritën se formuli **idenë e autonomisë politike teritoriale, madje, edhe të pavarësisë** së plotë, siç e shprehu S. Frashëri më 1881 në letrën që i dërgonte De Radës. Duke e përgjithësuar përvojën e organizimit shtetëror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mendimi politik rilindas argumentoi se si duhej të ishte e organizuar autonomia politike dhe shteti i ardhshëm i pavarur shqiptar në mënyrë që ky, nga njëra anë, të siguronte tërësinë teritoriale, mbrojtjen e interesave kombëtare dhe zhvillimin e vendit në rrugën e progresit dhe, nga ana tjetër, të siguronte aktivizimin e vetë popullit në drejtimin shtetëror e politik të kombit, të siguronte liritë dhe të drejtat demokratike në

10) S. Frashëri, **Shqipëria q'ka qenë, q'është e ç'do të bëhetë?** Bot. 1962, f. 47.

11) **Akte të Rilindjes Kombëtare shqiptare, 1878-1912,** Bot. 1978, f. 19.

një shtet të organizuar në trajtën e një republike parlamentare, pa mbretër e princa.

Më në fund, një meritë tjetër e mendimit politik rilindas është se ai përligji teorikisht, politikisht dhe juridikisht të drejtët e shqiptarëve për të kundërshtuar edhe me armë politikën e fuqive të mëdha dhe çdo politikë tjetër që synonte të merrete nëpër këmbë interesat kombëtare. Njohja e së drejtës për t'u mbrojtur me armë u konkretizua edhe në organizimin ushtarak të forcave të armatosura të Lidhjes Shqiptare, që luajtën një rol të rëndësishëm në kundërshtimin e planeve ekspansioniste të shteteve fqinje, të fuqive të mëdha dhe të Portës.

Ideologët e Lidhjes së Prizrenit ishin të gjithë iluministë konsekuentë dhe besonin në forcën e dijes, por ata ishin edhe politikanë demokratë e revolucionarë, që u jepnин rëndësi në luftën për çlirimin kombëtar në radhë të parë mjeteve dhe metodave të luftës politike. Duke përgjithësuar përvojën e Lidhjes dhe duke nxjerrë prej saj mësimë Sami Frashëri thoshte se «të drejtat tonë duhet t'i kërkojmë me fjalë, por ta kemi edhe pushkën plot». Lufta me armë e popullit kundër pushtuesve ishte me të vërtetë veprim i një force kulturore, që mbronte vlerat më të çmuara të kulturës — lirinë dhe pa-varësinë e Atdheut.

Fryma kryengritëse e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit iu komunikua gjithë kulturës kombëtare shqiptare, kësaj kulture rebele, që u rrit pa lejë qarkullimi, burgjeve dhe bodrumeve, maleve dhe shpellave, syrgjyneve dhe llogoreve. Kjo kulturë nuk doli nga akademira dhe seminare, mejtepe e oborre, por u krijua me ndihmat e barinjve e bujqve, me punën vëtmohuese të mësuesve pa grada shkencore dhe pa rrrogë, të mallkuar nga kisha e xhamia. Kjo kulturë rebele mbante të gjallë në popull frymën kryengritëse, i ndriçonte rrugën përrpara dhe i printe në luftën e tij për liri. Ajo ishte kulturë e një kombi të ri, që tashmë kishte ndier e provuar forcën e tij, që ishte kalitur në disfata e në fitore dhe që kishte fituar përmes tyre besimin e palëkundur në ngadhnjimin e passhmangshëm të çështjes së tij të drejtë. Këtë besim e shprehu ideologu i Lidhjes Shqiptare Sami Frashëri kur tha: «Kush të na dalë përrpara e të na ndalojë në këtë udhë të shenjtëruarë, ta shtyjmë, ta rrëzojmë, ta shkelim e të shkojmë tutje,

e përsëriti P. N. Luarasi kur shpalli: «Edhe 99 herë të rrëzo-hemi, përsëri duhet të ngrihem!». Optimizmi historik, që barti me vete kultura kombëtare e Rilindjes, e ushqeu popullin në gjithë peripecitë dhe luftërat e mëvonshme; këtë optimizëm e sjell ajo deri në ditët tona, duke na i shtuar forcat dhe duke na përkrahur për të ecur përpara në rrugën e lavdishme të socializmit nën udhëheqjen e Partisë.

Pasqyra e Lëndës

Faqe

Njëqindvjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit — një datë e shënuar e historisë së lavdishme të popullit shqiptar.
(Kryeartikull i gazetës «Zëri i Popullit» i datës 5 mars 1978). 5

Mehmet Shehu Fjala e mbajtur me rastin e varrimit të eshtrave të Abdyl e Naim Frashërit.	13
Ramiz Alia Fjala e mbajtur në mbledhjen solemne kushtuar 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.	25
Aleks Buda Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjet e saj historike.	51
Stefanaq Pollo Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin dhe bashkimin kombëtar.	79
Arben Puto Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit në vitet e krizës lindore.	103
Alfred Ugi Lidhja Shqiptare e Prizrenit si faktor kulturor në Rilindjen Kombëtare.	129